

**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT  
DEPARTAMENTI I ELEKTRONIKËS DHE TELEKOMUNIKACIONIT**

**LEDION LIÇO**

**PËR MARRJEN E GRADËS**

**“DOKTOR”**

**NË “TEKNOLOGJITË E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT”**

**DREJTIMI “TELEKOMUNIKACION DHE INXHINIERI INFORMACIONI”**

**DISERTACION**

**IMPLEMENTIMI DHE OPTIMIZIMI I TEKNIKAVE TË  
DATA MINING NË SISTEMET E INTELIGJENCËS SË  
BIZNESIT RETAIL NË SHQIPËRI**

**Udhëheqës Shkencor**

**Prof. Asoc. INDRIT ENESI**

**TIRANË, 2021**

**IMPLEMENTIMI DHE OPTIMIZIMI I TEKNIKAVE TË DATA MINING NË  
SISTEMET E INTELIGJENCËS SË BIZNESIT RETAIL NË SHQIPËRI**

**Disertacioni**

i paraqitur në Universitetin Politeknik të Tiranës

për marrjen e gradës

“Doktor”

në

“Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit”

Drejtimi Telekomunikacion dhe Inxhinieri Informacioni

nga

z. Ledion Liço

TIRANË, 2021

JURIA PËR VLERËSIMIN E DISERTACIONIT PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE  
“DOKTOR”

Miratuar

Me vendimin e Këshillit të Profesorëve të FTI-së Nr: 13, datë: 09.07.2021.

Kryetari i Jurisë:	Prof. Dr. Elma ZANAJ
Anëtar i Jurisë:	Prof. Asoc. Aleksandër BIBERAJ
Anëtar i Jurisë (Oponent) :	Prof. Asoc. Algenti LALA
Anëtar i Jurisë:	Prof. Dr. Fatmir HOXHA
Anëtar i Jurisë (Oponent) :	Prof. Asoc. Ana KTONA

Dekan i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit

Prof. Dr. Elinda MEÇE

Dedikuar nënës time që më mbështeti në çdo  
hap të rrugëtimit tim!

## ***FALENDERIME!***

Së pari, dua të shpreh mirënjohjen time më të sinqertë, për udhëheqësin tim, Prof. Asoc Indrit Enesi i cili me këmbënguljen dhe kontributin maksimal, bëri të mundur që ky punim të përfundohej me sukses. Puna e vazhdueshme me të, ka qënë tejmase e vlefshme për zhvillimin tim akademik.

Së dyti, dua të falenderoj të gjithë pedagogët e nderuar të Departamentit të Elektronikës dhe Telekomunikacionit në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, për besimin e treguar ndaj meje dhe ndihmën shumë të vlefshme, që në kohën kur isha student e deri më sot. Eksperienca e marrë nga ky staf shumë i kualifikuar dhe profesional ka qënë thelbesore në rrugëtimin tim akademik dhe profesional.

Së fundmi, falenderoj familjen time që ka qënë pranë meje në çdo hap dhe më kanë mbështetur gjithmonë.

## ABSTRAKTI

Teknikat e Data Mining (DM) dhe Machine Learning (ML) janë zhvilluar shumë në vitet e fundit. Shumica e kërkimeve në fushën e shkencave kompjuterike janë fokusuar në këto 2 fusha. Njëkohësisht, biznesi retail dhe veçanërisht e-commerce është zhvilluar me hapa galopantë dhe për rrjedhojë është rritur nevoja për analiza shumë-dimensionale të të dhënave të klientëve dhe për parashikim e sjelljes së tyre. Sistemet e inteligjencës në biznes (BI) i ofrojnë biznesit analiza multidimensionale të të dhënave të tyre. Kombinimi i këtyre sistemeve me teknikat e DM dhe ML, i jep biznesit, gjithashtu mundësinë të parashikojë sjelljen konsumatore. Megjithatë krijimi i një modeli të përshtatshëm që nxjerr informacion të vlefshëm dhe të saktë nga bazat e mëdha të të dhënave të biznesit ngelet një problem. Një tjetër sfidë është të krijosh një model parashikues, duke qënë se atributet e të dhënave janë në rendin e qindrave apo mijërave dhe zgjedhja e attributeve më të vlefshëm, që na japin saktësinë maksimale në parashikim është e vështirë. Përzgjedhja e algoritmit më të mirë parashikues, është gjithashtu një detyrë tepër komplekse.

Objektivi kryesor i këtij punimi është zgjidhja e problemeve të sipër përmendura. Ne do të ndërtojmë modele që ndërthurin teknikat DM dhe ML me sistemet BI për ti ofruar biznesit një mekanizëm të plotë për të analizuar dhe parashikuar sjelljen e klientëve të tyre.

Studimi ynë do të ndahet në tre pjesë kryesore:

Ne pjesën e parë, ne do të agregojmë në shumë dimesione, të dhënat reale të marra nga një qendër tregtare në Tiranë, Shqipëri. Më pas do të ndërtojmë disa modele klasterizimi dhe do të analizojmë performancën e tyre në bazën tonë të të dhënave. Si përfundim, do të rekomandojmë modelin më të mirë që mund të përdoret për segmentimin e të dhënave të klientit, në qendrat tregtare në varesi të karakteristikave të tyre.

Ne pjesën e dytë, do të propozojmë 3 modele klasifikues me qëllimin e parashikimit të klasës së klientit në fund të vitit duke u nisur nga të dhënat e tre-mujorit të parë. Klasa e klientit është një numër që i alokohet klientit, bazuar në shpenzimet e tij vjetore. Modelet do të bazohen në algoritmat, Support Vector Machines (SVM), K-Nearest Neighbours (KNN) dhe në rrjetat neurale. Modelet do të trajnohen në të dhënat e tre-mujorit të parë të 2020 dhe do të testohen duke krahasuar klasën e parashikuar me klasën reale. Performanca e modeleve do të vlerësohet bazuar në metrikën e përqindjes së saktësisë në parashikim.

Ne pjesën e tretë të studimit tonë, do të analizojmë modelet e serive kohore dhe do të propozojmë një version të modifikuar të modelit Prophet për të parashikuar shitjet ditore në qendrën tregtare. Modeli bazë dhe modeli i modifikuar Prophet do të trajnohen dhe testohen në të dhënat e shitjeve nga 2011-2019, të qendrës tregtare dhe performanca e tyre do të vlerësohet në bazë të mesatares së gabimit absolut në parashikim (MAE). Modeli i modifikuar do të aplikohet në bazën e të dhënave dhe do të kryhet parashikimi për 6 mujorin në vazhdim të shitjeve. Performanca e modelit do të vlerësohet duke u bazuar në mesataren e gabimit absolut në përqindje (MAPE).

## ABSTRACT

Data Mining (DM) and Machine Learning (ML) have been evolving rapidly in the last years. Most of the Computer Science Communities have been focusing their research on these topics. Along with them, Retail and E-commerce is growing at the same pace and the need for customer analytics and behaviour prediction has become critical. Business Intelligence BI systems are particularly used to supply the retail business with multidimensional analysis of their data. Combining BI systems with DM and ML techniques, enables them to also predict their customer's behaviour. Although, building the right model that extracts valuable and accurate information from large customers' transactional databases remains a problem. Another challenge is creating a prediction model as the attributes of the data are in hundreds or thousands and finding the most valuable predictors is not easy. Utilizing the best segmentation and prediction algorithms is also a complex task.

The main purpose of our study is addressing these problems. We will create models based on DM and ML, in conjunction with BI to offer a complete mechanism for the businesses operating in retail, to analyse and predict their customer behaviour. Our study can be divided in three main sections:

In the first, we will first aggregate the data from a real department store in Albania, in multiple dimensions. Then we will build several clustering models and analyse their performance on this real data. We will conclude, in what is the best model that can be used for department stores based on their characteristics.

In the second part of the study, we will propose 3 classification models with the aim to predict the customer label at the end of the year based on quarterly data. The models will be based on Support Vector Machines (SVM), K-Nearest Neighbours (KNN) and neural networks algorithms. The customer label is a number allocated to each customer based on their annual expenses. Or models will be trained and tested in our dataset. Their performance will be evaluated on accuracy percentage metric.

In the third part of our study, we will analyse time series models and particularly propose a modified Prophet model to predict daily sales in the department stores. The base prophet model and the modified one will be evaluated based on prediction MAE (Mean Absolute Error). The modified model will be trained and tested in the sales of the department store from 2011-2019 and its performance will be evaluated bases on prediction MAPE (Mean Absolute Percentage Error).

## PËRMBAJTJA

<b>Abstrakti</b>	<b>vi</b>
<b>Abstract</b>	<b>vii</b>
<b>LISTA E TABELAVE</b>	<b>xi</b>
<b>LISTA E FIGURAVE</b>	<b>xii</b>
<b>LISTA E SIMBOLEVE DHE SHKURTIMEVE</b>	<b>xiv</b>
<b>HYRJE</b>	<b>1</b>
<b>MOTIVIMI</b>	<b>5</b>
<b>KAPITULLI 1</b>	<b>6</b>
<b>1. SISTEMET E INTELIGJENCËS NË BIZNES</b>	<b>6</b>
1.1 Hyrje	6
1.2 Evolimi i sistemeve BI	6
1.3 Përkufizimi i një sistemi BI	6
1.4 Sistemet BI	7
1.5 Arkitektura BI	7
1.5.1 Komponentet e një sistemi BI	9
1.6 Karakteristikat kryesore të një sistemi BI	11
1.7 Drejtuesit e një implementimi BI	11
1.8 Faktorët përcaktues në implementimin e sistemeve BI	14
1.9 Lidhjet midis sistemeve të inteligjencës së biznesit dhe magazinave të të dhënave	15
1.10 Benefitet e implemetimit të një sistemi BI	16
1.11 Konkluzione	17
<b>KAPITULLI 2</b>	<b>18</b>
<b>2. MAGAZINAT E TË DHËNAVE DHE TEKNOLOGJIA E KUBAVE TË TË DHËNAVE</b>	<b>18</b>
2.1 Hyrje	18
2.2 Përcaktimi i një Data Warehouse	18
2.3 Një krahasim midis bazave të të dhënave për procesim transaksionesh dhe ato që ndihmojnë në vendim-marrje	19
2.4 Teknologjia e kubave të të dhënave	19
2.5 Serveri OLAP	20
2.6 Metadata	20
2.7 Drill-down	20
2.8 Data mining	21
2.9 OLAP dhe Data Warehousing	21
2.10 Arkitektura e kubave	25
2.11 Kubat relacionar të të dhënave	26
2.12 Performanca	29



2.12.1	<i>Grupimet</i>	29
2.12.2	<i>Indeksi bitmap</i>	29
2.12.3	<i>Copëzimi</i>	31
<b>2.13</b>	<b>Konkluzione</b>	<b>32</b>
<b>KAPITULLI 3</b>		<b>33</b>
<b>3.</b>	<b>TEKNIKAT E DATA MINING</b>	<b>33</b>
<b>3.1</b>	<b>Hyrje</b>	<b>33</b>
<b>3.2</b>	<b>Modeli përshkrues</b>	<b>35</b>
3.2.1	<i>Ndarja në grupe</i>	35
3.2.2	<i>Asocimi</i>	35
3.2.3	<i>Ekstraktimi i veçorive</i>	36
<b>3.3</b>	<b>Modeli parashikues</b>	<b>37</b>
3.3.1	<i>Klasifikimi</i>	37
3.3.2	<i>Regresi</i>	38
3.3.3	<i>Seritë kohore</i>	39
3.3.4	<i>Identifikimi i anomalive të të dhënave</i>	39
<b>3.4</b>	<b>Teknikat data mining që përdoren në sistemet e inteligjencës së biznesit BI</b>	<b>40</b>
<b>3.5</b>	<b>Hapat e DATA-MINING</b>	<b>42</b>
3.5.1	<i>Cilësia e të dhënave</i>	42
3.5.2	<i>Hapat kryesore për paraprosesimin e të dhënave</i>	43
<b>3.6</b>	<b>Konkluzione</b>	<b>46</b>
<b>KAPITULLI 4</b>		<b>47</b>
<b>4.</b>	<b>TEKNIKAT DM TË MARRA NË SHQYRTIM</b>	<b>47</b>
<b>4.1</b>	<b>Metoda e Ndarjes/Particionimit në Klastera</b>	<b>47</b>
4.1.1	<i>Algoritmi K-Means</i>	47
4.1.2	<i>Algoritmi k-Medoids</i>	50
<b>4.2</b>	<b>Metoda hierkike e klasterizimit</b>	<b>53</b>
4.2.1	<i>Metoda hierkike grumbulluese vs ndarëse</i>	54
4.2.2	<i>Përlllogaritja e distances në metodat algoritmike</i>	55
4.2.3	<i>Algoritmi BIRCH</i>	57
4.2.4	<i>Metoda Chameleon</i>	60
<b>4.3</b>	<b>Teknikat e Klasifikimit</b>	<b>61</b>
4.3.1	<i>Konceptet Themelore</i>	62
<b>4.4</b>	<b>Rrjetat neurale</b>	<b>63</b>
4.4.1	<i>Neuroni artificial: Funksionet e aktivizimit</i>	63
4.4.2	<i>Derivatet e funksioneve të aktivizimit</i>	67
4.4.3	<i>Regresi</i>	68
4.4.4	<i>Klasifikimi</i>	69
4.4.5	<i>Funksionet e gabimit</i>	71
4.4.6	<i>Trajnimi i rrjetave neurale me një shtresë të ndërmjetme</i>	72
4.4.7	<i>Trajnimi i MLPs të thella</i>	81
<b>4.5</b>	<b>Support Vector Machines SVM</b>	<b>84</b>
4.5.1	<i>SVM për më shumë se 2 klasa</i>	84
4.5.2	<i>SVM me funksionin Bërthamë: Rasti jo-linear</i>	85
<b>4.6</b>	<b>Klasifikuesi i K fqinjëve më të afërt (KNN)</b>	<b>88</b>
<b>4.7</b>	<b>Algoritmi Prophet</b>	<b>89</b>

4.7.1	<i>Modeli i Trendit</i>	89
4.7.2	<i>Modeli i sezonalitetit</i>	90
4.7.3	<i>Ditët Festive</i>	91
4.7.4	<i>Metrikat e gabimit</i>	91
<b>4.1</b>	<b>Konkluzione</b>	<b>92</b>
<b>KAPITULLI 5</b>		<b>93</b>
<b>5.</b>	<b>PUNA EKSPERIMENTALE</b>	<b>93</b>
<b>5.1</b>	<b>Teknikat e Klasterizimit</b>	<b>93</b>
5.1.1	<i>Eksplorimi i bazës së të dhënave</i>	93
5.1.2	<i>Para-proçesimi i të dhënave</i>	94
5.1.3	<i>Korrelimi midis attributeve</i>	95
5.1.4	<i>Klasterizimi me K-Means</i>	96
5.1.5	<i>Klasterizimi me K-Medoids</i>	97
5.1.6	<i>Klasterizimi me DBSCAN</i>	98
5.1.7	<i>Algoritmi Hierarkik Aglomerativ</i>	99
5.1.8	<i>Rezultate të Klasterizimit</i>	100
<b>5.2</b>	<b>Modelet e klasifikimit</b>	<b>101</b>
5.2.1	<i>Eksplorimi i bazës së të dhënave</i>	101
5.2.2	<i>Para-proçesimi i të dhënave</i>	102
5.2.3	<i>Modeli KNN</i>	103
5.2.4	<i>Support Vector Machines</i>	104
5.2.5	<i>Eksplorimi i të dhënave dhe para-proçesimi</i>	105
5.2.6	<i>Modeli SVM</i>	105
5.2.7	<i>Rrjetat Neurale</i>	107
<b>5.3</b>	<b>Analiza e serive kohore</b>	<b>110</b>
5.3.1	<i>Modeli Prophet</i>	110
5.3.2	<i>Eksplorimi i të dhënave</i>	110
5.3.3	<i>Aplikimi i modelit standart dhe të modifikuar</i>	112
<b>5.4</b>	<b>Konkluzione</b>	<b>116</b>
<b>KAPITULLI 6</b>		<b>117</b>
<b>6.</b>	<b>REZULTATET E PUNIMIT DHE PUNA NË TË ARDHMEN</b>	<b>117</b>
<b>6.1</b>	<b>Rezultatet e punimit</b>	<b>117</b>
<b>6.2</b>	<b>Puna në të ardhmen</b>	<b>119</b>
<b>Referencat</b>		<b>120</b>
<b>Aneks 1</b>	<b>122</b>	

**LISTA E TABELAVE**

Tabela 2-1 Shembulli i tabelës së shitjeve për disa produkte të kompanisë .....	26
Tabela 2-2 Shembull i tabelës pivot.....	27
Tabela 2-3 Rezultatet e operatorit të kubit në agregimin e operatorit shumë, kur aplikohet në Tabelën 2.1.....	27
Tabela 2-4 Rezultatet e operatorit rollup kur aplikohet në Tabelën 2.1. ....	28
Tabela 2-5 Shembull i indeksimit bitmap. ....	30
Tabela 2-6 Shembull i indeksimit bit-sliced. ....	31
Tabela 3-1 Algoritme të Klasterizimit .....	35
Tabela 3-2 Shembull transaksionesh .....	36
Table 5-1 Përmbledhëse e datasetit dhe 5 rreshtat e parë .....	94
Tabela 5-2 Performanca në kohë e modeleve të klasterizimit .....	100
Tabela 5-3: Përmbledhëse e datasetit dhe 5 rreshtat e parë .....	102
Tabela 5-4 Saktësia pas Cross Validation.....	104
Tabela 5-5 Saktësia në varësi të normalizimit të të dhënave .....	105
Tabela 5-6 Cross-Validation në SVM.....	105
Tabela 5-7 Parametrat e modelit NN .....	107
Tabela 5-8 5 rreshtat e parë te bazës së të dhënave .....	111
Tabela 5-9 5 rreshtat e parë të databazës së festave.....	111
Tabela 5-10 Modeli i modifikuar Prophet .....	112

## LISTA E FIGURAVE

Figura 1-1 Arkitektura klasike e BI .....	8
Figura 1-2 Arkitektura teknike e një BI.....	9
Figura 1-3 Data warehouse të ngarkuara nga sistemet burim.....	10
Figura 1-4 Arsyet që të çojnë drejt inteligjencës në biznes .....	13
Figura 1-5 Vlerat e BI kundrejt kohës dhe kostos .....	14
Figura 2-1 Drill-down .....	21
Figura 2-2 Shembull i skemës yll. Çelësat e jashtëm janë shënuar me <fk> .....	22
Figura 2-3 Shëmbulli se si Figura 2.2 mund të organizohet si skema snowflake. Çelësat e jashtëm janë shënuar me <fk> .....	23
Figura 2-4 Grafi përshkruan se si operacioni group by mund të llogaritet duke përdorur operacionin group by të mëparshëm në vend të burimit të të dhënave.....	29
Figura 3-1 Modeli DM përshkruet (i pasupervizuar) dhe modeli DM parashikues (i supervizuar).....	34
Figura 3-2 Arkitektura OLAM.....	41
Figura 3-3 Hapat e paraprocesimit të të dhënave.....	45
Figura 4-1 Klasterizimi i një seti objektësh që përdorin algoritmin k-means; (b) azhurnimi e qendrave të klasterave dhe rivendosja e objekteve në përputhje me gjendjet (mesatarja e secilit klaster shënohet me +).....	48
Figura 4-2 Katër rastet e funksionit të kostos për klasterizimin k-medoids .....	51
Figura 4-3 Klasterizimi agglomerative dhe hierarkik në objektet {a, b, c, d, e} .....	54
Figura 4-4 Paraqitja Dendogram për klaster-izimin hierarkik për objektet data {a, b, c, d, e} .....	55
Figura 4-5 Klasterizimi linkage .....	57
Figura 4-6 Struktura CF – pemë .....	59
Figura 4-7 Kameleon: Klasterizim hierarkik i bazuar në k-fqinjët më të afërt dhe modelimi dinamik .....	60
Figura 4-8 Neuron artificial: Mbledhja dhe Aktivizimi.....	64
Figura 4-9 Funksionet e aktivizimit të neuroneve; ilustrimi i efektit të bias-it. ....	66
Figura 4-10 Softmax (netkversus netj) .....	67
Figura 4-11 Regresi linear dhe logjistik përmes rrjetave neurale.....	69
Figura 4-12 Rrjetet neurale për regresin logjistik multiklasor: Të dhënat e përbërësve kryesorë të Iris. Pikat e multiklasifikimit janë treguar në ngjyrë gri të errët. Pikat në klasën $c_1$ dhe $c_2$ tregohen të zhvendosura në lidhje me klasën bazë $c_3$ vetëm për ilustrim. ....	71
Figura 4-13 Perceptron i thellë me shumë shtresa, me h shtresa të fshehura. ....	74
Figura 4-14 Plani ndarës në 2D .....	84
Figura 5-1 Korrelimi midis attributeve .....	95
Figura 5-2 Metoda Elbow .....	96
Figura 5-3 Klasterat e klienteve K-Means .....	97
Figura 5-4 Klasterat e klienteve K-Medeoids.....	98
Figura 5-5: DBSCAN Min_pts=7 eps=0.3 .....	98
Figura 5-6 DBSCAN Min_pts=7 ,eps=2 .....	99
Figura 5-7 DBSCAN Min_pts=7 ,eps=0.05 .....	99
Figura 5-8 Dendogrami i të dhënave .....	100
Figura 5-9 Rezultatet e ndarjes në klastera.....	101
Figura 5-10 Ndarja e klientëve në klasa .....	101
Figura 5-11: Saktësia për numer te ndryshem fqinjesh .....	103
Figura 5-12 Matrica e Saktësisë.....	104
Figura 5-13 Matrica e saktësisë për SVM.....	106

Figura 5-14 Saktësia për tipe të ndryshme bërthamash .....	106
Figura 5-15 Humbja Cross Entropy për numër të ndryshëm nyjesh në shtresën e ndërmjetme .....	108
Figura 5-16 Saktësia për numër të ndryshëm nyjesh në shtresën e ndërmjetme .....	108
Figura 5-17 Humbja për funksione të ndryshme aktivizimi .....	109
Figure 5-18 Saktësia për funksione të ndryshme aktivizimi.....	109
Figure 5-19 Ecuria e shitjeve në vitet 2011-2019 .....	112
Figura 5-20 Parashikimi i shitjeve me anë të modelit të modifikuar Prophet .....	113
Figure 5-21 Krahasimi i modeleve për 6 mujorin e dytë të vitit 2019.....	113
Figura 5-22 Vlerat e MAPE pas Cross Validation.....	114
Figura 5-23 Trendet në shitje për qendrën tregtare.....	115

## LISTA E SIMBOLEVE DHE SHKURTIMEVE

**RDBMS** – Sistemet e menaxhimit të bazave të të dhënave relacionale (Relational Database Management Systems)

**KDD** - Zbulimi i Informacionit në Bazat e të Dhënave (Knowledge Discovery in Databases)

**DM** - Data Mining

**ERP**- Sistmet e Planifikimit të Burimeve të Ndërmarrjeve (Enterprise Resource Planning)

**ML** - Machine Learning

**BI** - Sistemet e Inteligjencës në biznes

**ETL** - Mjetet e nxjerrjes, transformimit dhe ngarkimit të të dhënave (Extract, Transform, and Load)

**CRM** - Sistemet e menaxhimit të marrëdhënies me klientin (Customer relationship management)

**NN** - Rrjetat Neurale

**KNN** - K Nearest Neighbours

**SVM** - Support Vector Machines

**DW** - Magazinë të dhënash (Data Warehouse)

**OLAP** - Sistemet e përpunimit analitik në kohë reale (Online Analytical Processing)

**OLTP** - Sistemet e procesimit transaksional në kohë reale (Online Transactional Processing)

**MAE** - Gabimi Absolut Mesatar (Mean Absloute Error)

**MAPE** - Gabimi Absolut Mesatar në përqindje (Mean Absolute Percentage Error)

**ROLAP** – Sistemet relacionare të përpunimit analitik në kohë reale (Relational Online Analytical Processing)

**MOLAP** - Sistemet multidimensionalë të përpunimit analitik në kohë reale (Multidimensional Online Analytical Processing)

**HOLAP** - Sistemet hibride të përpunimit analitik në kohë reale (Hybrid Online Analytical Processing)

**TID** - Numri i transaksionit (Transacation ID)

**POS** - Pikë Shitje (Point of Sale)

**PAM** - Particionim rreth të mesmes (Partition Around Medoids)

**BIRCH** - Klasterizimi hierarkik multifazë duke përdorur pemët e klasterizimit (Multiphase Hierarchical Clustering Using Clustering Feature Trees)

**ReLU** - Njësia Lineare e Korrigjuar (Rectified Linear Unit)

**MLP** - Algoritmi Perceptron më shumë shtresa (Multilayer Perceptron)

**SSE** – Shuma e gabimeve në katror (Sum of Squared Errors)

## HYRJJE

Vitet e fundit mund të themi me bindje të plotë që kryefjala e çdo biznesi dhe industrie janë të dhënat. Me zhvillimin dhe përparimet e teknologjisë sasia e të dhënave që prodhohen çdo ditë nga kompanitë është shumë e madhe. Problemi i vërtetë qëndron në tërheqjen e informacionit sa më të saktë dhe të lexueshëm në gjuhën e biznesit, nga këto sasi të mëdha të dhënash. Një tjetër sfidë është parashikimi i ecurisë së biznesit bazuar në këtë informacion. Teknikat kryesore në realizimin e këtij procesi janë Data mining (DM) dhe Machine Learning ML.

Data mining (DM) është pikërisht procesi i identifikimit dhe ekstraktimit të informacionit të nevojshëm. Kjo teknikë ka për qëllim të zbulojë automatikisht njohuritë që mund të përftohen nga këto depozitorë të mëdhenj të dhënash dhe që nuk janë lehtësisht të dallueshme përmes teknikave të tjera rutinë të eksplorimit ose përpunimit të të dhënave.

Nga ana tjetër Machine Learning (ML) e përdor këtë informacion për të trajnuar makinën për të kryer parashikime për të ardhmen. Një përkufizim i ML do të ishte: Një program kompjuterik mëson nga ekperiencia E, në lidhje me një detyrë T dhe disa indikatorë performance P, nëse performanca e tij për detyrën T, e matur nga P rritet me rritjen e E (Tom M. Mitchell).

Machine Learning dhe Data Mining janë fusha të cilat ndërlidhen me njëra tjetrën dhe nuk është shumë e thjeshtë të bësh një ndarje të qartë. Data Mining përdor teknikat ML për të analizuar të dhënat dhe nga ana tjetër ML përdor informacionin e ekstraktuar nga DM për të trajnuar makinën. Nje ndarje intuitive qëndron në faktin që DM është më së shumti një proces i pambikëqyrrur (përshkrimor), ndërsa ML është një proces i mbikëqyrrur (parashikues). Për thjeshtësi gjatë këtij studimi do ta quajmë DM si kategorinë e madhe ku bëjnë pjesë teknikat përshkrimore dhe parashikuese. Duhet të kemi të qartë se teknikat parashikuese janë në thelb teknika ML.

Teknikat më të përdorura të DM dhe ML në aplikimet e ndryshme në biznes janë:

- Klasifikimi
- Asocimi
- Ndarja në klastera
- Teknikat e Regresit
- Rrjetat neurale
- Support Vector Machines (SVM)
- Algoritmet gjenetikë
- Detektimi i anomalive
- Ekstraktimi i karakteristikave
- Analizat e serive kohore



Biznesi Retail është një ndër bizneset me përhapjen më të madhe në Shqipëri. Në vitet e fundit, blerjet janë përqendruar me së shumti nëpër qendra tregtare ku shumë dyqane të kategorive të ndryshme operojnë në të njëjtin ambient. Kjo menyrë tregtie e kombinuar me e-commerce është aktualisht predominuese në Shqipëri edhe në botë. Ky ndryshim në menyrën e operimit në retail ka sjellë edhe rritjen e përdorimit të kartave të klientit, si menyrë për të krijuar një marrëdhënie më të ngushtë midis biznesit dhe klientit. Në këtë mënyrë, biznesi ka në dorë një informacion të detajuar të klientit, gjë që mungonte në mënyrën tradicionale të tregtisë. Nga ana tjetër, një biznes ka shumë sisteme të tjera nga të cilat merr të dhëna, siç janë sistemet transakcionale të shitjeve, sistemet e menaxhimit të stokut dhe sistemet ERP, sistemet e menaxhimit të promocioneve, sistemet CRM, sistemet e detektimit të prezencës të cilat mund të integrohen me anë mjeteve të inteligjencës në biznes (BI) dhe ti ofrojnë biznesit një sasi tepër të madhe të dhënash.

Me këtë volum kaq të madh të dhënash pyetja është një: Si mund të përdoren këto të dhëna në menyrë që të rritet cilësia e shërbimit ndaj klientit dhe të maksimizohet fitimi?

Pergjigja e kësaj pyetjeje, na çon para dy sfidave të mëdha. Si mund të ekstraktujmë informacion të vlefshëm nga kjo sasi e madhe të dhënash? A mund ti përdorim këto të dhëna që të parashikojmë ecurinë e biznesit?

Teknikat DM dhe ML i japin përgjigje këtyre dy pyetjeve. Por krijimi i modeleve të duhur nuk është i thjeshtë dhe saktësia e modeleve varet nga shumë faktorë duke u nisur që nga zgjedhja e attributeve të duhur që japin informacionin më të vlefshëm e deri të përdorimi i algoritmeve të duhur. Ndërtimi i modeleve DM dhe ML në Retail është një detyrë që ka nevojë për njohuri të thella të fushës së biznesit në mënyrë që të kuptojmë atributet më të vlefshme të të dhënave por në të njëjtën kohë ka nevojë për njohuri të thella teknike mbi shkencën e të dhënave në menyrë që të implementojmë algoritme me performancë të lartë.

Ky është qëllimi primar i punës tonë, të ofrojmë modele të përmirësuara DM dhe ML me performancë të lartë që mund të përdoren në biznesin retail për të analizuar dhe parashikuar ecurinë e biznesit. Këto modele mund të përdoren në veçanti nga departamenti i shërbimit ndaj klientit për të ofruar një cilësi më të lartë shërbimi, nga departamenti i marketingut për të krijuar fushata të targetuara në baze të profileve të klientëve, nga departamenti i blerjeve për të parashikuar ecurinë dhe shitmërinë e stokut dhe nga menaxhimi për të analizuar në shumë dimensionet ecurinë e biznesit dhe për të parashikuar të ardhmen e tij.

Në këtë punim, do të trajtohen disa prej mënyrave se si DM dhe ML (Machine Learning) integrohet në aplikime të tipit BI (Business Intelligence) dhe do të propozojmë modele të DM dhe ML të cilat do të vlerësohen në një dataset real Retail të një qendre tregtare në Tiranë. Qëllimi parësor i studimit mbetet analiza e aplikimit të sistemeve BI dhe teknikave të Data Mining në sistemet Retail në Shqipëri. Do të merret në konsiderantë në mënyrë të veçantë përdorimi i këtyre sistemeve për bizneset e vogla dhe të mesme që nuk janë pjesë e grupeve të mëdha ndërkombëtare.

Në punim integrohen të dhëna nga sisteme të ndryshme në qendrën tregëtare si: sistemi transakcional i shitjeve, një sistem e-commerce, sisteme CRM dhe ERP për menaxhimin e klientit. Pjesa eksperimentale do të ndahet në 3 pjesë kryesore. Në pjesën e parë do të propozohen dhe analizohen modelet grupuese në klastera dhe do të grupohen klientët në klasterat kryesorë. Në pjesën e dytë do të propozojmë dhe analizojmë modelet parashikuese të klasifikimit. Në pjesën e tretë do të propozojmë dhe analizojmë modelet e serive kohore me fokus në algoritmin Prophet dhe një modifikim të tij.

Punimi përbëhet nga pesë kapituj.

**Në kapitullin e parë** përkufizohen dhe studiohen sistemet e inteligjencës në biznes, historiku i tyre dhe karakteristikat kryesore. Arkitekturat e ndryshme të përdorura në sistemet BI dhe komponentet e tyre pasqyrohen dhe shpjegohen me detaje. Jepet lidhja ndërmjet sistemeve BI dhe magazinave të të dhënave si element kritik i tyre. Gjithashtu përshkruhen faktorët kryesorë që duhen marrë parasysh në implementimet e sistemeve BI.

**Në kapitullin e dytë**, analizohen magazinat e të dhënave DW dhe arkitekturat kryesore të tyre, përkatësisht Star dhe Snowflake. Analizohen avantazhet dhe disavantazhet e secilës arkitekturë. Në punim shpjegohet koncepti i kubave të të dhënave dhe arsyet e përdorimit të tyre në sistemet BI. Përshkruhen tre teknologjitë kryesore OLAP (ROLAP, MOLAP, HOLAP) dhe karakteristikat e tyre. Bëhet studimi teorik i performacës së secilës teknikë dhe gjithashtu jepen rekomandime në implementimin e sistemeve OLAP. Diferencat kryesore të sistemeve DW dhe relacionale trajtohen në detaje.

**Në kapitullin e tretë** kryhet një studim i teknikave të Data Mining (DM). Fillimisht analizohen modelet kryesore të DM, përkatesisht: modelit përshkrues dhe modelit parashikues. Algoritmat kryesore të secilit model trajtohen në detaje bashkë me analizat përkatëse. Shpjegohet se si kryhet integrimi i DM me sistemet e inteligjencës në biznes dhe statusi aktual i këtyre integrimiëve. Së fundmi jepen hapat kryesorë që duhet të ndërmerren gjatë implementimit të DM me fokus në paraprocesimin e të dhënave, i cili ka rëndësi kritike.

**Në kapitullin e katërt** analizohen teknikat dhe algoritmat që implementohen dhe modifikohen gjatë pjesës eksperimentale. Fillimisht paraqiten algoritmat e klasterizimit dhe veçanërisht algoritmat K-Means, K-Medoids dhe algoritmat hierarkike. Aparati matematikor i secilit algoritëm analizohet duke u ilustruar me shëmbuj dhe skema. Më pas paraqiten teknikat e klasifikimit. Në këtë pjesë trajtohen nga ana teorike algoritmat KNN (Klasifikuesi i K-fqinjëve më të afërt), algoritmi SVM dhe rrjetat neurale.

Aparati matematikor i secilit algoritëm trajtohet në detaje.

Vlen për tu theksuar punimi fokusohet në rrjetat neurale (NN) duke qënë se besojmë se janë teknikat më premtuese të klasifikimit dhe regresit. Arkitekturat kryesore të rrjetave NN paraqiten në punim dhe fazat e përparme dhe të pas-shpërndarjes analizohen si dhe funksionet e ndryshme të aktivizimit dhe të gabimit që përdoren. Të gjitha këto funksione implementohen në modelin e krijuar në pjesën eksperimentale. Duhet të theksojmë se analiza teorike e teknikave të klasifikimit dhe e rrjetave neurale bazohet thelbësisht në librin *“Data Mining and Machine Learning Fundamental Concepts and Algorithms by Mohammed J. Zaki, Wagner Meira Jr, Cambridge University Press, 2020”* të referuar me numrin 33 duke i besuar cilesisë shumë të lartë të analizës që kryhet në të.

**Në kapitullin e pestë** puna eksperimentale u ndahet në 3 seksione kryesore. Në seksionin e parë implementohen modelet më të rëndësishme të klasterizimit për të kuptuar cili performon më mirë. Rezulton se për bazën tonë të të dhënave, modeli K-Medoids ishte më i përshtatshëm për shkak të pranisë së të dhënave periferike (outliers) me dizavantazhin e kompleksitetit në kohë. Në pjesën e dytë të studimit analizohen modelet e klasifikimit dhe propozohen tre modele të ndryshme të bazuar në KNN (K-Nearest Neighbours), SVM (Support Vector Machines) dhe rrjetat Neurale (NN). Vihet re se rezultatet më të mira i meren në rastin e modelit me SVM, 80.79% saktësi në parashikim por duhet të theksojmë se rezultatet janë të ngjashme. Në pjesën e tretë të studimit analizohen dhe propozohen modele që lidhen me seritë kohore me fokus kryesor në algoritmin Prophet. Propozohen disa ndryshime nga modeli bazë të cilat na dhanë

një përmirësim me 1.4 % të gabimit në parashikim dhe një MAPE<25% për parashikime 3-mujore të shitjeve të qendrës tregtare.

Punimi mbyllet me konkluzionet dhe puna në të ardhmen.

## MOTIVIMI

Përdorimi i mjeteve të inteligjencës në biznes dhe të data mining në Shqipëri është i ulët dhe avantazhet e këtyre teknikave njihen pak. Në veçanti në biznesin e vogël dhe të mesëm retail, këto teknika nuk përdoren ose përdoren shumë pak. Këto teknika do të ishin shumë të dobishme për të analizuar dhe parashikuar sjelljen e klientit në retail, fakt që rrjedhimisht do të rezultonte në rritjen e të ardhurave të biznesit dhe të cilësisë së shërbimit të klientit. Një tjetër sektor që do të përfitonte nga kjo analizë është marketing i cili mund të kryejë fushtata të drejtuara, duke u nisur nga modelet e zbuluara nga DM. Nga ana tjetër parashikimi i shitjeve ndihmon në një menaxhim dhe planifikim më të mirë të stokut.

Një tjetër shtysë për këtë punim ka qënë rritja galopante e sasisë së studimeve në Data Mining dhe Machine Learning në vitet e fundit. Një pjesë e mirë e punimit bazohet edhe te rrjetat neurale të cilat janë në fokus kryesor të studimeve në fushën e ML apo inteligjencës artificiale.

Në studimin tonë do të merret në konsiderantë, në mënyrë të veçantë, përdorimi i këtyre sistemeve në biznesin Retail në Shqipëri për bizneset e vogla dhe të mesme që nuk janë pjesë e grupeve të mëdha ndërkombëtare.

Analiza do të kryhet me të dhëna reale të marra nga sistemet e një qëndre tregtare në Shqipëri. Do të studiohen në veçanti teknikat e ndarjes në klastera, teknika të klasifikimit dhe të serive kohore. Do të vlerësohet efikasiteti dhe faktorët që e ndikojnë atë. Do të propozohen modele të ndryshme të optimizuara për të arritur saktësinë maksimale në parashikim.

## KAPITULLI 1

### 1. SISTEMET E INTELIGJENCËS NË BIZNES

#### 1.1 Hyrje

Në këtë kapitull do të japim një pamje të përgjithshme të sistemeve të inteligjencës në biznes të vazhduar nga një diskutim se nga çfarë përbëhet një sistem BI, karakteristikat e tij kryesore dhe rëndësinë e tij në biznes, lidhja e tij me magazinimin e të dhënave dhe raportimin, arkitekturat tipike të një sistemi BI të ndjekura nga cikli i jetës së një projekti për një sistem BI.

#### 1.2 Evolimi i sistemeve BI

Shumë njerëz në industri mendojnë se termi “Inteligjencë në biznes” u përdor nga “Howard Dresner” i kërkimeve Gartner në 1989, ku ai e quajti BI “një kategori e gjerë software dhe zgjidhjeve për mbledhjen, konsolidimin, analizimin dhe bërja e mundur e aksesit ndaj të dhënave si një mënyre për t’i lënë përdoruesit e një kompanie të marrin vendime më të mirë biznesi” (Gibson *et al*, 2004; Yeoh, 2008).

Gjithsesi sipas Yeoh(2008)[2] termi është përdorur për herë të parë nga “H.P.Luhn” në një editorial të IBM të titulluar “Një sistem inteligjencë në biznes”(Luhn,tetor 1958).

Më poshtë jepet përcaktimi origjinal i Luhn siç është përcaktuar në 1958:

“Biznesi është një grumbull aktiviteteve që kryhen për çdo lloj arsyeje, në shkencë, teknologji, tregti, drejtësi, qeveri, mbrojtje e të tjera. Fasiliteti i komunikimit që shërben në drejtimin e një biznesi (në kuptimin e gjerë) mund të përcaktohet si një sistem inteligjence. Nocioni i inteligjencës, gjithashtu përcaktohet këtu, në një kuptim më të përgjithshëm si “aftësia për të kuptuar lidhjet e fakteve të prezantuara në mënyrë të tillë që të drejtojnë veprimet drejt një qëllimi të caktuar”.

Megjithatë është pranuar gjerësisht se Howard Dresner ishte i pari që e familjarizoi botën me termin “Inteligjence në Biznes” kur ai e përdori BI si një mënyrë për të përshkruar “konceptet dhe metodat për të përmirësuar vendim-marrjen në biznes duke përdorur në sistemet e suportit që bazohen në fakte”.

#### 1.3 Përkufizimi i një sistemi BI

Inteligjenca në biznes ose BI si dhe terma të tjerë në këtë fushë nuk kanë një përkufizim standard siç kanë shumë terma shkencore. Megjithatë, shumica e literaturës BI kanë ardhur nga bota e biznesit, industria IT dhe shitës të ndryshëm (Jagielska *et al* 2003; Yeoh, 2008).

Më poshtë po rendisim disa përcaktime [1]:

Davenport (2007): “BI është një set teknologjish dhe procesesh që përdorin të dhënat për të kuptuar dhe analizuar performancën e një organizate”.

Platon A/S (2009) [7] termi BI mbulon “përdorimi i informacionit për të thelluar njohuritë në biznes. Pra shërben për të themeluar një bazë më të mirë për vendim-marrësit duke bërë të mundur informacionin në formën e duhur, në cilësinë e duhur dhe në kohën e duhur”

Elizabeth Vitt (2002): termi BI “përdoret nga shumë shitës të produkteve software për të karakterizuar një gamë të gjerë teknologjish, platformash software, aplikacione specifike dhe procese”. Megjithëse është pothuajse e qartë shumë njerëz e kanë parë dhe shprehur BI në mënyra të ndryshme dhe kuptime të ndryshme.

## 1.4 Sistemet BI

Sipas Olszak & Ziembra (2007)[1], sistemet e inteligjencës në biznes ofrojnë një propozim që mbulon nevojat e organizatave kontemporane. Çështjet kryesore që mbulojnë këto sisteme përfshijnë eksplorimin inteligjent, integrimin, agregimin dhe analizën multidimensionale të të dhënave që vijnë nga burime të ndryshme informacioni. Sistemet standarde BI kombinojnë të dhëna nga sistemet e brendshme të informacionit të një organizate dhe integrojnë të dhënat që vijnë nga sisteme specifike për shëmbull statistika financiare dhe baza të dhënash të ndryshme. Sisteme të tilla shërbejnë për të ofruar informacion të përshtatshëm, të besueshëm dhe të azhornuar për aspekte të ndryshme të aktiviteteve të një sipërmarrjeje.

Siç e thekson NAV(2007), kur implementohet një sistem BI të jep mundësinë për të aksesuar, përdorur dhe ndarë të dhënat në një mënyrë eficiente dhe në këtë mënyrë ndihmon në rritjen e performancës së një biznesi.

Kapacitet e sistemeve BI i bëjnë të mundur një punonjësi:

- Të rendisë operacionet e përditshme me strategjitë dhe objektivat e përgjithshme të kompanisë
- Të identifikojë dhe kuptojë lidhjen midis proceseve të biznesit dhe impaktit të tyre në performancë
- Aksesin ndaj informacionit sipas roleve të ndryshme të përdoruesve dhe përgjegjësive
- Analiza e të dhënave nga dokumentat në një mënyrë të thjeshtë
- Përfton një vështrim kontekstual në mekanizmat e biznesit
- Monitoron indikatorët kryesorë në një biznes që nevojiten për ta zhvilluar një kompani që janë:
  1. Statusi aktual dhe trendi i propocioneve kryesore financiare
  2. Efektiviteti dhe përfutueshmëria e kanaleve të shitjes
  3. Metrikat e operacioneve kryesore

Pra inteligjenca në biznes ndihmon kompanite të kenë një pamje të kuptueshme dhe të integruar të biznesit të tyre dhe ta bëjnë më të lehtë dhe më të thjeshtë vendim-marrjen.

## 1.5 Arkitektura BI

Për David Loshin (2008) [3], objektivi i analizës së informacionit në biznes ishte dhe akoma është aftësia për të vlerësuar nëse kompania operon në mënyrë eficiente dhe rrjedhimisht kërkimi i mundësive për shfrytëzuar njohuritë. Ky nocion i menaxhimit të performancës dhe

përmirësimit nëpërmjet raportimit dhe analizave ka evoluar në atë që shpesh quhet inteligjenca në biznes. Megjithatë shumë prezantime, raportime dhe produkte virtualizimi ndihmojnë në komunikimin e rezultatit të kësaj analize, inteligjenca në biznes mbetet në mënyrë të pandarë i lidhur me infrastrukturën teknike dhe DW [2].

Sfidat taktike për të përcaktuar një plan pune për një sistem të inteligjencës së biznesit përfshijnë koleksionimin e të dhënave nga sisteme të ndryshme të shpërndara dhe duke i konsoliduar ata në një model të centralizuar dhe organizimi i të dhënave për të furnizuar aplikacionet fundore për të drejtuar analizat e biznesit dhe raportet.




Figura 1-1 Arkitektura klasike e BI

Siç shihet në figurën 1-1 më BI ka nevojë për konektorë të dhënash për të marrë të dhënat nga burimet, mjete integrimi për të asimiluar dhe konsoliduar të dhënat, servera dhe memorie për të hostuar magazinën e të dhënave dhe sistemin e saj të meaxhimit, të gjitha aplikacionet që furnizojnë me të dhëna dhe ato fundore që përdoren për raportim dhe analiza dimensionale (David Loshin,2008) [3].

Në figurën 1.2 paraqiten të gjitha komponentet teknike të një sistemi BI që nga burimet e informacionit, mjetet për ekstraktimin, transformimin dhe hedhjen e të dhënave, llojet e memorieve që përdoren për të ruajtur të dhënat, shtresa semantike dhe llojet e raporteve dhe aplikimeve që i përdorin këto të dhëna.

Megjithëse burimet e informacionit mund të jenë të shumëllojshme, pjesa e përdoruesve përbëhet nga përdoruesit fundore, analistët e biznesit dhe administratorët.




Figura 1-2 Arkitektura teknike e një BI

### 1.5.1 Komponentet e një sistemi BI

1. **Sistemet burim:** Konsiston në të gjitha të dhënat që mund t'i nevojiten një kompanie për analizat. Këto të dhëna mund të jenë të dhëna nga një bazë të dhënash burim, të dhëna të jashtme nga partnerët në format xml, të dhëna të marra nga website i kompanisë, një lidhje nga një server aplikacioni, të dhëna nga dokumenta në excel dhe burime të ndryshme (kJube 2002).
2. **Mjetet ETL:** ETL është procesi i marrjes së të dhënave, më së shumti nga lloje të ndryshme sistemesh, transformimi i tyre në një strukturë që është më e përshtatshme për raportim dhe analiza dhe futja e tyre në bazën e të dhënave. Figura 1.3 paraqet hapat e përfshira në këtë proces.

Në figurën 1.3 mund të shohim disa burime të ndryshme si sistemet e planifikimit të burimeve në një ndërmarrje ERP (Enterprise resource planning), sistemet e menaxhimit të klientëve CRM (Customer relationship management) dhe sistemet e linjave të biznesit LOB (Line of business).



Gjithashtu mund të ketë dhe lloje të tjera sistemesh ose dhe dokumenta të formateve të ndryshme që mund të integrohen nëpërmjet proceseve ETL në një magazinë të dhënash DW.




Figura 1-3 Data warehouse të ngarkuara nga sistemet burim

3. **Cilesia e të dhënave:** Sipas Passiones Nederland B.V (2009), sot ETL bën më shumë se për sa njihet. Ajo mbulon gjithashtu profilizimin e të dhënave, kontrolli i cilësisë së të dhënave, monitorimin dhe fshirjen, integrimin e të dhënave në kohë reale në një arkitekturë të orientuar nga shërbimi (SOA) dhe menaxhimi i Metadata-ve.
4. **Data Mining:** Për Kurt Thearling (2009), Data Mining, ekstraktimi i informacionit të fshehur parashikues nga baza të dhënash të mëdha është një teknologji e re me potencial të lartë për ti ndihmuar kompanitë të fokusohen në informacionin më të rëndësishëm në magazinat e tyre të të dhënave. Mjetet e data mining parashikojnë trendet dhe sjelljet e të ardhmes që e lejojnë një biznes të marrë vendime proaktive, të drejtuara nga njohuria. Analizat prospektive të automatizuara të ofruara nga data mining shkojnë përtej analizës së të dhënave historike që janë tipike në sistemet DSS. Mjetet data mining mund t'u përgjigjen pyetjeve të biznesit që mund të konsumojnë shumë kohë për tu zgjidhur.
5. **Organizimi i të dhënave:** Në procesin e magazinimit të të dhënave, pjesa e organizimit të të dhënave përbëhet nga një server aplikacioni dhe nga magazina e të dhënave (depo) e rezultateve të aktiviteteve të përthithjes, transformimit dhe futjes të të dhënave. Serveri i aplikacionit të organizimit të të dhënave ruan dhe transformon në mënyrë provizore të dhënat e marra nga burimet e të dhënave OLTP.
6. **Depot e të dhënave operacionale (ODS):** Sipas Immon (1998), një ODS është një strukturë e integruar, e orientuar drejt subjektit, jo e qëndrueshme (duke përfshirë përditësimet) e ndërtuar për tu shërbyer përdoruesve operacionale kur ata bëjnë procesime të integruara me performancë të lartë. Esenca e një ODS është bërja e mundur e procesimit të integruar dhe kolektiv në kohë reale. Një ODS suporton azhurnimin online. Një ODS është e integruar nëpërmjet shumë aplikacioneve. Në të njëjtën kohë një ODS suporton procesimin në ndihmë të vendim-marrjes.
7. **Magazina e të dhënave multidimensionale:** Siç e thekson kJube (2002), magazina e të dhënave multidimensionale është zemra e një mjedisi të inteligjencës në biznes. Në

themel ajo është një bazë të dhënash e madhe që mban të gjitha të dhënat që duhen për menaxhimin e performancës. Teknikat e modelimit që përdoren për të ndërtuar këtë bazë të dhënash janë kritike për funksionimin e një zgjidhjeje BI. Karakteristikë tipike e një magazine të dhënash multidimensionale është përmbajtja e të dhënave jo të ndryshueshme, të integruara dhe atomike. Duhet një njohuri të mira mbi teknikat e modelimit multidimensional për të kuptuar më mirë këto magazina të dhënash.

8. **Data Mart:** Një data Mart është një version më i vogël i një DW që kryesisht mban të dhëna të lidhura me një fushë funksionale të kompanisë me një shtrirje të limituar në një mënyrë tjetër. Mund të jetë një hap i nevojshëm drejt një magazine të dhënash.
9. **OLAP:** Sipas Rai&Storey (2001), procesimi analitik në kohë reale OLAP siç njihet është një teknologji për aksesin ad hoc në kohë reale të të dhënave dhe analizave.
10. **Shtresa Semantike:** Sipas Vezzosi (2009) [9], shtresa Semantike redukton kohën për sistemet e inteligjencës në biznes. Ajo ofron një akses të sigurtë të të dhënave me terma të thjeshtë biznesi. Mund të hapë akses për çdo klient ose përdorues apo çdo lloj të dhëne. Shtresat semantike shërbejnë si ndërmjetëse midis shtresës së prezantimit, e cila normalisht është ndërfaqja e përdoruesit për të gjithë përdoruesit fundor, analistët e biznesit dhe administratorët dhe zona e ruajtjes të të dhënave.
11. **Pikë e vetme e aksesit të informacionit:** Një zgjidhje BI mund të gjenerojë lloje të ndryshme outputesh. Këto outpute mund të përmbajnë tage, komente, interpretime që janë në formë të shumëfishta dhe duhet të ruhen në një hapsirë ku mund të lidhet me raportet dhe konsumojnë hapsira memorie të mëdha. Prandaj këshillohet të përdoret një pikë e vetme aksesi nëpërmjet një portali, ku është e mundur të lidhësh një përdorues biznesi, qëllimi i raportit dhe opsionet e aksesit.

## 1.6 Karakteristikat kryesore të një sistemi BI

Përgjithësisht karakteristikat i referohen tipareve të një entiteti të caktuar. Karakteristikat kryesore të një sistemi BI i referohen avantazheve që përfitohen kur implementohet një sistem BI.

Siç referon Dr.Saadia Asif (2009)[4], më poshtë renditen karakteristikat e një sistemi BI:

- Të dhëna të integruara nga burime të ndryshme
- Të dhëna të qëndrueshme përgjatë sistemeve të korporatës
- Të dhëna aktuale dhe historike
- Të dhëna të anlizuara përgjatë dimensioneve dhe hierarkive
- Dërgesa të shpejta të analizave

## 1.7 Drejtuesit e një implementimi BI

Sot menaxherët nuk bazohen më në instiktet e tyre për të marrë vendime të rëndësishme. Sistemet e inteligjencës së biznesit kanë filluar të përhapen dhe po luajnë një rol kyç në vendim-marrje.

“Sistemet BI kanë krijuar një reputacion dhe njihen si burime që dërgojnë raporte që askush nuk i lexon. Nuk duhet të jetë kështu. Dhe nuk duhet të lejohet që të jetë kështu.” (Grunman 2007)[5].

Grunman gjithashtu thekson se shumë organizata, duke e konsideruar BI si një set teknologjish ndërtojnë sisteme shumë komplekse që dështojnë në plotësimin e kërkesave të përdoruesve të tyre, ndërkohë që ajo që vërtetë është e nevojshme është një konceptim më i mirë i të dhënave dhe kërkesave të biznesit.

Si për Grunman(2007), Biznesi i përdor sistemet BI:

- Në 74 % të kompanive, menaxherët e konsiderojnë BI si një prioritet kyç. Ndër këta 48% drejtohen nga niveli ekzekutiv dhe 30% nga menaxhimi në linjën e biznesit.
- 74 % të kompanive e shohin BI si një fushë shumë prioritare në 3 deri në 5 vitet e ardhshme dhe 66% në vitin e ardhshëm.
- 61% e të pyeturve thonë se analistët e biznesit po luajnë një rol më strategjik në korporatat e tyre, 39% e këtyre korporatave planifikojnë të punësojnë më shumë analistë biznesi vitin e ardhshëm.

Gruman (2007) gjithashtu përmend si përdoret BI:

- Analizat parashikuese kanë një rol thelbësor në sistemet BI me 62 % të të anketuarve që i përdorin këto sisteme në këtë mënyrë ose planifikojnë ta bëjnë brenda një viti. Departamentet e shitjeve (56%), financat (54%), marketing (54%), logjistika (35%) dhe shërbimet ndaj klientit (35%) i përdorin më shumë sistemet e inteligjencës në biznes.
- Kapacitet më të rëndësishme të sistemeve BI janë renditja, filtrimi (60%) vlerësimi dhe optimizimi i vendim-marrjes (45%).
- 36% e të anketuarve kanë besim në saktësinë dhe rëndësinë e raporteve. Vetëm 10% nuk kanë besim në këto raporte.
- 54% e të anketuarve do të merrnin në konsideratë zëvendësimin e raporteve të gjeneruar nga BI me teknologjinë e kërkimit që i lejon përdoruesit të marrin rezultatet e tyre.

Por 43% e të anketuarve thonë se kompanitë e tyre nuk e kanë ekspertizën e duhur për ta bërë këtë.

Pse bota e biznesit është orientuar drejt sistemeve BI dhe kush janë forcat drejtuese të tyre, pse janë këto sisteme të nevojshëm dhe për çfarë qëllimesh.

Të gjitha këto ilustrohen në figurën 1.4.

Në këtë figurë tregohen disa nga nevojat e departamenteve të ndryshme të një ndërmarrje për një sistem BI.




Figura 1-4 Arsyet që të çojnë drejt inteligjencës në biznes

Për NAV (2007) [6], e ndihmon në drejtimin e biznesit në një performancë më të mirë duke ju mundësuar të gjithë vendim-marrësve, kryesisht duke fuqizuar të gjithë punonjësit brenda një organizate të marrin vendime më të mira. Ka tre lloj vendimesh që një korporate merr:

- Vendime strategjike - këto janë vendimet më të rëndësishme që korporatat marrin (psh a duhet ta blejmë një partner, a duhet të hyjmë në një treg të ri). Vlera e këtyre vendimeve është e madhe por sasia e vogël.
- Vendime teknike - kjo është pjesa ku janë implementuar gjithnjë sistemet BI. Këtu një menaxher produkti vendos çfarë politikash uljesh duhet të ndjekë ose të vendosë mbi çmimin e një produkti të ri.
- Vendime operative - këto janë vendime biznesi të marra në vazhdimësi (zakonisht të bëra nga njerëz që nuk kanë dëgjuar ndonjëherë për sistemet BI) dhe kanë një impakt më të vogël në biznes. Gjithsesi në përgjithësi, shumë vendime operacionale marrin një vlerë shumë të madhe dhe mund të çojnë në një biznes më të mirë.

Për Platon A/S (2009)[7], drejtimet kryesore për një korporatë që të vendosë për implementimin e një sistemi BI duhet të jenë kërkesat ligjore dhe jo teknologjia ose iniciativa e IT.

Implementimi i sistemeve BI duhet të bëhet në bashkpunim të ngushtë me fushat e biznesit. Figura 1.5 ilustron vlerën e biznesit të sistemeve BI kundrejt kostos dhe kohës.




Figura 1-5 Vlerat e BI kundrejt kohës dhe kostos

## 1.8 Faktorët përcaktues në implementimin e sistemeve BI

Ka një numër faktorësh të cilët mund të ndikojnë në procesin e vendim-marrjes gjatë implementimit të një sistemi BI. Më poshtë kemi një listë të kategorizuar të faktorëve të cilët afektojnë procesin e vendim-marrjes të ndjekur nga aspektet e mëposhtëm:

### 1. Mjetet e raportimit dhe analizës:

- Veçoritë dhe funksionaliteti
- Përshkallëzimi dhe zbatimi
- Përdorimi dhe menaxhimi
- Aftësia për ta përshtatur

### 2. Bazat e të dhënave

- Përshkallëzimi dhe performanca
- Vlefshmëria dhe menaxhimi
- Siguria dhe përshtatje

- Aftësia për të rishkruar

### 3.Mjetet ETL

- Aftësia për të lexuar çdo burim
- Efiçenca dhe prodhueshmëria
- Suporti për platformat e përziera

### 4.Kostot e përfshira

- Kostot e hardware
- Kostot e software
- Kostot e brëndshme të implementimit
- Kostot e jashtme të implementimit
- Trajnimet e brëndshme
- Mirëmbajtja në vazhdimësi

### 5.Benefitet

- Të kursen kohë dhe efiçenca operacionale
- Kosto më të ulëta operacionale
- Shërbim më i mirë për përdoruesin
- Kosto më e ulët operimi
- Vendim-marrja operacionale dhe strategjike përmirësohet
- Një komunikim më i mirë midis punonjësve
- Një ndarje më e mirë e njohurive

## 1.9 Lidhjet midis sistemeve të inteligjencës së biznesit dhe magazinave të të dhënave

Shumë njerëz e ngatërrojnë fjalën BI (Business Intelligence) me atë të DW (DataWarehouse). Le të bëjmë një ekzaminim të lidhjes midis këtyre dy termave.

Sipas Platon A/S (2009) [7] termi Magazine Data (DW) mbulon menaxhimin e të dhënave ndërsa termi Inteligjencë në Biznes (BI) fokusohet në përdorimin e të dhënave. Qëllimi i një DW është të bëjë të mundur të dhëna të integruara, të qëndrueshme, të strukturuar, korrekte dhe në kohë për çdo sistem ose përdorues që kërkon informacion. Të dhënat ekstrahohen nga sistemet operacionale dhe integrohen në mjedisin e DW në mënyrë që ti ofrojë një ndërmarrjeje një perspektive më të gjerë dhe një version të të vërtetës. Ndërsa termi inteligjencë në biznes mbulon përdorimin e informacionit për të drejtuar vendim-marrjen e tij. Praktikisht është një mënyrë për të ofruar një bazë më të mirë për vendim-marrësit duke ofruar informacion në formën e duhur, në cilësinë e duhur dhe në kohën e duhur.

Siç dikton Dr.Saadia Asif (2009)[4] ”BI përdoret për shfrytëzimin e të dhënave ndërsa magazinat e të dhënave përdoren për integrimin e tyre” dhe thekson se ato nuk mund të përdoren në vend të njëra-tjetrës.

Më poshtë po paraqesim disa pikëvështrime të Moss (2003):

Sipas Larissa Moss, BI i referohet mundësisë për të siguruar një pamje 360° të biznesit dhe është një strukturë e disiplinave midis organizatave dhe një arkitekturë për ndërtimin dhe menaxhimin e një sërë aplikacionesh dhe bazash të dhënash operationale që suportojnë vendim-marrjen dhe i sigurojnë komunitet të biznesit akses të thjeshtë si dhe vendim-marrje të kujdesshme. Një mjet për të prodhuar inteligjencën në biznes është magazinimi i të dhënave; një tjetër mjet është CRM e kështu me radhë. Me pak fjalë magazinimi i të dhënave është një komponent dhe mjet për prodhimin e inteligjencës në biznes.

Adrienne Tannenbaumi referohet BI si një mënyrë për përdorimin e të dhënave ekzistuese/informacionit/njohurive në një korporatë. Në përgjithësi, shumica e të dhënave janë të ndryshme dhe intergohen në mënyrë sporadike (me një magazinë të vetme të dhënash). Në një strukturë BI e gjitha kjo bëhet pjesë e një sistemi më të madh dhe bëhet e mundur me anë të një kërkimi të vetëm. Dokumentimi, rregullat e biznesit, kriteret e kërkimit dhe raportet ekzistues janë shëmbuj të gjërave që mund të aksesohen nga një vënd i vetëm, në mënyrë tipike nëpërmjet termave të kërkimit të lidhura dhe të organizuara.

Sipas Scott Howard, BI i referohet sistemeve dhe teknologjive që i ofrojnë vendim-marrësve mënyrat për të ekstraktuar informacion të personalizuar dhe kuptimplotë për biznesin dhe industrinë e tyre, jo në mënyrë tipike vetëm nga sistemet e brendshme. Kjo përfshin mjetet për suportin e avancuar ndaj vendim-marrjes dhe baza të dhënash në të cilat mbështeten këto mjete. DW janë këto baza të dhënash. Nëse kombinohen me mjetet e suportit që duhen për ndërtimin dhe ruajtjen e bazës së të dhënave, sic është pastrimi, ekstraktimi, transformimi dhe ngarkimi i të dhënave, marrim atë që shumë e quajnë magazinimi i të dhënave.

Mendoni për magazinën e të dhënave si zyra e pasme dhe inteligjencën në biznes si të gjithë biznesin duke përfshirë dhe zyrën e pasme.

Clay Rehn thekson se magazinimi i të dhënave erdhi nga termat “suport në vendim-marrje” dhe “raportim menaxherial” shumë vite më parë. BI kërkoi të përmblihte më shumë procese që përfshinin magazinimin e të dhënave. Shumë shitës përdorin termin BI për të përshkruar shërbimet e tyre, për të treguar se ata ofrojnë më shumë shërbime dhe jo vetëm magazinim të dhënash.

## 1.10 Benefitet e implemetimit të një sistemi BI

Sipas Dr.Saadia Asif (2009)[4] implementimi i një sistemi BI mund të ofrojë:

### 1.Shtimi i të ardhurave

- Npërmjet përftimit të klientëve të rinj
- Rritja e shitjeve ndaj klientëve ekzistues

### 2.Reduktimi i kostove operative

- Rishpërndarja e burimeve në kanalet me kosto të ulët
- Kosto më të ulëta operative
- Shtimi i ofertave për produkte dhe përmirësimi i shërbimit ndaj klientit

### 3.Avantazhe kompetitive

- Një pjesë më e madhe e mendimeve dhe portofolit të klientëve duke identifikuar nevojat kryesore dhe mundësitë për shërbime.

Sipas Schiff (2009)[8] implementimi i një sistemi BI në një organizatë ndihmon për:

- Rritjen e efijensës dhe efikasitetit të organizatës
- Ndihmon organizatën në vendim-marrje
- Lejon përdoruesit e biznesit të analizojnë dhe kuptojnë më mirë planet dhe rezultatet e organizatës
- Paralajmëron organizatën për çështje potenciale kur ndodhin rethana të jashtëzakonshme-siç janë rënia e shitjeve me 20% nën parashikimet ose inventari që bie nën një vlerë kufi.
- 

### **1.11 Konkluzione**

Ne këtë kapitull u përkufizuan dhe studiuuan sistemet e inteligjencës në biznes, historiku i tyre dhe karakteristikat kryesore. Arkitekturat e ndryshme të përdorura në sistemet BI dhe komponentet e tyre u pasqyruan dhe shpjeguan në detaje. U shpjegua lidhja midis sistemeve BI dhe magazinave të të dhënave si element kritik i tyre. Gjithashtu u përshkruan faktorët kryesorë që duhen marrë parasysh në implementimet e sistemeve BI.



## KAPITULLI 2

### 2. MAGAZINAT E TË DHËNAVE DHE TEKNOLOGJIA E KUBAVE TË TË DHËNAVE

#### 2.1 Hyrje

Në një sistem bazë të dhënash të një korporate të gjerë është e vështirë analizimi i të dhënave sepse ato janë të ruajtura në formate dhe vënde të ndryshme. Për të zgjidhur problemin e integritimit të sistemeve të sipërmarrjes, data warehouse përdoren si një sistem i integruar.

#### 2.2 Përcaktimi i një Data Warehouse

Gjatë viteve të fundit institucionet po përdorin magazinimin e të dhënave për të përmirësuar fluksin e informacionit dhe suportin në vendim-marrje. Një DW mund të jetë një aset i vlefshëm që ofron akses të thjeshtë të të dhënave për analiza dhe raporte. Fatkeqësisht, ndërtimi dhe mirëmbajtja e një DW efektiv përmban disa sfida. Sot shumë organizata po mundohen të ndërtojnë një DW që përmbush kërkesat e biznesit të tyre.

Han dhe Kamber e përcaktojnë DW si një magazinë informacioni të marrë nga disa burime, të ruajtura në një skemë të unifikuar që zakonisht është e vendosur në një site të vetëm. Pra dhe në sistemet retail të gjitha të dhënat për shitjen, stokun, klientët, shitëset, artikujt, furnitorët do të ruhen në një vënd të vetëm.

Sipas Inmom “një DW është një koleksion të dhënash i integruar, i orientuar drejt subjektit, që ndryshon në kohë e cila vjen në ndihmë të procesit të marrjes së vendimeve të menaxhimit [9].

“Një DW është një magazinë e ndarë e të dhënave të marra nga një ose më shumë baza të dhënash produkti për të dhënë një burim autoritar për support ndaj vendim-marrjes. Ajo mund të konsiderohet një sistem që ndihmon në vendim-marrje. Raportimi i të dhënave është një tjetër aspekt i rëndësishëm i magazinimit të të dhënave sepse output kryesor i sistemeve DW janë query-it me formatim minimal ose raportet formale.

Veçoritë e DW mund të përmbledhen si më poshtë [10-12].

**I orientuar drejt subjektit:** DW projektohen për të ndihmuar dikë të analizojë të dhënat. Zakonisht këto lloj të dhënash nuk janë të përshtatshme për vendim-marrësit për tu përdorur. Vendim-marrësit kanë nevojë për të dhëna të orientuara drejt subjektit. Nëse do të duam të dimë për shitjet e një kategorie artikujsh të caktuar, do të ndërtohet një DW që do të përqëndrohet te shitjet. Duke përdorur këtë DW ne mund ti përgjigjemi pyetjes: Sa shitje ka pasur kjo kategori artikujsh vitin që shkoi? Aftësia për të përcaktuar një DW sipas subjektit (psh shitjet) e bën DW në këtë rast të orientuar drejt subjektit.

**E integruar:** Integrimi lidhet me orientimin drejt subjektit. DW duhet të vendosë të dhëna nga burime të ndara (siç janë dokumentat excel, bazat e të dhënave relacionale) në një format konsistent. Ato duhet të zgjidhin disa probleme siç janë konfliktet e emrit dhe paqëndrueshmërisë midis njësive të matjes. Kur arrihet ky qëllim thuhet se janë të integruara.

**Të qëndrueshme:** Të qëndrueshme do të thotë se të dhënat që futen në DW nuk duhet të ndryshojnë. Nuk ka azhornim të të dhënave si në një bazë të dhënash (OLTP) dhe nuk nevojiten mekanizmat e procesimit të transaksioneve dhe të rikuperimit. DW i duhen vetëm dy veprime në aksesimin e të dhënave: futja e të dhënave dhe aksesimi i tyre. Kjo është logjike sepse qëllimi i një magazine të dhënash është që të bëjë të mundur analizimin e veprimeve që kanë ndodhur. Kjo është arsyeja pse nuk janë të nevojshme mekanizmat e procesimit të transaksioneve, të rikuperimit dhe kontrollit të të dhënave.

**Variabël në kohë:** Në mënyrë që të zbulohen trendet në një biznes, analizuesve u nevojiten sasi të mëdha të dhënash. Kjo është e kundërt me sistemet OLTP ku për shkak të performancës kërkohet që të dhënat historike të kalohen në një arkiv. Një DW fokusohet në ndryshimin përgjatë elementit të kohës.

### 2.3 Një krahasim midis bazave të të dhënave për procesim transaksionesh dhe ato që ndihmojnë në vendim-marrje

Ka dy lloje kryesore të sistemeve të bazave të të dhënave: Sistemet operacionale dhe sistemet analitike që përfshijnë DW. Këto sisteme ndryshojnë në mënyrën se si i përdorin të dhënat. Sistemet operacionale quhen sisteme të procesimit të transaksioneve në kohë reale dhe janë të ndërtuara për futjen e të dhënave në kohë reale dhe modifikimin e tyre. Një transaksion hyrje produktesh, një kartë klienti mund të modifikohet dhe fshihet në çdo kohë. Zakonisht transaksionet përcaktohen më parë dhe kanë nevojë për një bazë të dhënash për të bërë të mundur aksesimin e shpejtë. Sistemet analitike janë projektuar për të ndihmuar korporatën në vendim-marrje. Një DW azhornohe periodikisht dhe zgjidhjet e saj ofrojnë mundësinë për të bërë query, analiza trendi dhe raporte.

### 2.4 Teknologjia e kubave të të dhënave

Principi i kubave të të dhënave shpjegohet jo vetëm nga ana se si ata janë dizenuar por edhe se për çfarë ata përdoren. Gjithashtu shpjegohet marrëdhënia ndërmjet kubave të të dhënave, DW dhe bazës së të dhënave relacionale.

Një nga pikat më të forta të bazës së të dhënave OLTP është se ata mund të kryejnë sasi të mëdha transaksionesh të vogla, duke e mbajtur bazën e të dhënave në dispozicion dhe të dhënat janë të qëndrueshme gjatë gjitha kohës.

Normalizimi ndihmon në ruajtjen e të dhënave të qëndrueshme, por ajo gjithashtu paraqet një shkallë më të lartë të kompleksitetit të bazës së të dhënave, e cila shkakton baza të dhënash të mëdha për të kryer operacionet e përbëra të bashkimit. Në kontekstin e biznesit është e dëshirueshme që të ketë historik të të dhënave që mbulojnë transaksionet e kryera prej vitesh, e cila rezulton në një sasi të madhe rekordesh të bazës së të dhënave për t'u analizuar.

Nuk është shumë e vështirë të kuptojmë se problemet e performancës do të lindin kur të kryhet përpunimi analitik që kërkon bashkimin e bazave të të dhënave komplekse. Një çështje tjetër që ka të bëjë me analizën OLTP është se ajo kërkon queries mjaft komplekse, ato të bëra posaçërisht për çdo kërkesë, në mënyrë që të marrim rezultatet e dëshiruara.

## 2.5 Serveri OLAP

Një server OLAP është një mjet me kapacitete të larta përpunuese dhe përdoruesish të dhënash i dizenuar veçanërisht për të suportuar dhe operuar në struktura të dhënash multidimensionale. Një strukturë multidimensionale është caktuar në këtë mënyrë që çdo artikull të dhënash të vendoset dhe bashkangjitet bazuar në ndërprerjen e përbërësve të dimensioneve që e përcaktojnë atë artikull. Dizenjimi i serverit dhe struktura janë optimizuar për marrjen e informacionit në veprim të shpejtë në çdo drejtim, gjithashtu edhe për kalkulime dhe transformime të shpejta dhe fleksibël të të dhënave të papërpunuara bazuar në marrëdhënien e formuluar. Serveri OLAP mund të organizojë gjithashtu dhe informacionet multidimensionale të procesuar për të shpërndarë konsistencë dhe përgjigje të shpejta të vendosura nga përdoruesit fundorë, ose ai mund të popullojë strukturën e të dhënave në kohë reale nga databaza relacionale ose të tjera, ose një zgjedhje e të dyjave.

## 2.6 Metadata

Metadata është ai lloj informacioni që përshkruan të dhënat e ruajtura në një databazë dhe përfshin informacione si:

- Një përshkrim i tabelave dhe fushave në një data warehouse, duke përfshirë tipet e të dhënave dhe rangun e vlerave të lejuara.
- Një përshkrim të njëjtë të tabelave dhe fushave në databazën burim, me një planifikim të fushave nga burimi në warehouse.
- Një përshkrim se si të dhënat janë transformuar, duke përfshirë formulimin, formatimin, shndërrimin korrent dhe grumbullimin në kohë.
- Çdo informacion tjetër që nevojitet për të suportuar dhe menaxhuar operacionet e data warehouse.

## 2.7 Drill-down

Drill-down mund të përcaktohet si kapaciteti për të shfletuar në informacion, duke ndjekuar një strukturë hierarkike. Në Figurën 2.1 tregohet një e tillë e thjeshtë.




Figura 2-1 Drill-down

## 2.8 Data mining

Data mining është procesi i ekstraktimit të informacionit nga të dhëna të vlefshme, të përdorshme, të panjohur më parë e të krahasueshme dhe përdorimi i tyre për të hartuar vendime biznesi [10].

## 2.9 OLAP dhe Data Warehousing

Në mënyrë që të zgjidhen çështjet e mësipërme, koncepti i përpunimit analitik Online (OLAP) u propozua dhe u diskutua gjerësisht ndër vite dhe shumë artikuj janë shkruar mbi këtë temë. OLTP është përdorur shpesh për të trajtuar sasi të mëdha të transaksioneve të shkurtra dhe të përsëritura në një rrjedhë të vazhdueshme, të tilla si transaksione bankare apo rekordet. Sistemet e bazave të të dhënave janë të projektuar për të mbajtur të dhëna të qëndrueshme dhe për të maksimizuar shpejtesinë e transaksioneve [13].

Bazat e të dhënave OLAP nga ana tjetër përdoren për të ruajtur historikun e të dhënave për një periudhë të gjatë të kohe, shpesh të mbledhura nga burime të dhënave të ndryshme dhe me madhësinë e një baze të dhënash tipike OLAP është shpesh herë më e madhe në amplitudë se ajo e një baze të dhënash të zakonshme OLTP.

Bazat e të dhënave OLAP nuk azhurnohen vazhdimisht, por mund të ngarkohen në një bazë të rregullt çdo natë, çdo fundjavë, ose dhe në fund të muajit. Kjo çon në transaksione më të pakta dhe koha e përgjigjes së query është më e rëndësishme se transaksioni pasi querying është përdorimi kryesor i një baze të dhënash OLAP.

Thelbi i teknologjisë OLAP janë kubat e të dhënave, të cilët janë modele bazash të dhënash shumë dimensionale. Modeli përbëhet nga dimensione dhe parametra numerike të cilave u referohemi si masa. Masat janë të dhëna numerike të tilla si të ardhurat, shpenzimet, shitjet and buxheti. Ata varen nga dimensionet, të cilat përdoren për të grupuar të dhëna të ngjashme me

grupin nga operatori në bazat e të dhënave relacionale. Dimensione tipike janë koha, vendi dhe produkti dhe janë të organizuara shpesh në hierarki. Një hierarki është një strukturë që përcakton nivelet e përshkallëzimit të një dimensionit dhe lidhjet midis këtyre niveleve. Dimensionit kohë për shembull mund të ketë orën si nivelin e parë më lart, hierarkia mund të përmbajë ditë, muaj dhe vite. Kur një kub kërkohet për një matje, e cila shtrihet nga një ose shumë dimensione mund të zgjidhet për të filtruar të dhënat. Kubat e të dhënave bazohen në data warehouse, i cili është një qendër e të dhënave që ngarkohen me të dhëna nga burime të shumta. Data warehouse prirën të jenë shumë të mëdha në përmasa dhe procesi i projektimit është një detyrë mjaft komplekse dhe kërkon kohë. Disa kompani mund të vendosin të kenë një bazë të dhënash në një vend, i cili është një depo e të dhënave e kufizuar në departamente. Data warehouse implementohen zakonisht si një bazë e të dhënave relacionale me tabela, të cilat grupohen në dy kategori: tabela dimensionit dhe tabela fakti. Një tabelë dimension është një tabelë që përmban të dhëna që përcaktojnë një dimension. Dimensionit kohë për shembull mund të përmbajë datat, emrat e ditëve të javës, numrat e javëve, emrat e muajve, numrat e muajit dhe vitit.




Figura 2-2 Shembull i skemës yll. Çelësat e jashtëm janë shënuar me <fk>

Një tabelë fakt përmban masat, që janë të dhënat të agregueshme që mund të numërohen, mbliidhen, shumëzohen, etj. Tabelat fakt gjithashtu përmbajnë referencat (çelësat e huaj) për tabelat dimension në kuba kështu që faktet mund të grupohen nga të dhënat dimensionale. Data warehouse në përgjithësi është i strukturuar si një skemë yll apo një skemë flokë dëbore (snowflake). Figura 2.2 ilustron një shembull të një data warehouse me strukturën e skemës yll. Siç shihet në figurë, një skemë yll ka një tabelë fakt në mes dhe të gjitha tabelat dimension i janë referuar kësaj table.

Me pak imagjinatë setup-i mund të mendohet në formë ylli. Në një skemë yll, tabelat dimension nuk kanë referenca në tabelat e tjera dimension. Nëse ata do ta bëjnë këtë, struktura do të quhej një skemë flokë dëbore. Një skemë yll përgjithësisht shkel 3NF duke patur tabela dimension të

bashkuara së bashku, e cila është shkak të humbjes së performancës që 3NF shkakton kur të dhënat janë shumë të mëdha. Në qoftë se për disa arsye është e dëshirueshme të mbahet data warehouse në 3NF mund të përdoret skema e flokë dëbore. Figura 2.3 ilustron një shembull se si Figura 2.2 mund të duket nëse do të jetë e strukturuar si një skemë flokë dëbore




Figura 2-3 Shëmbulli se si Figura 2.2 mund të organizohet si skema snowflake. Çelësat e jashtëm janë shënuar me <fk>

Në 1993, Codd publikoi një artikull për nevojën e shërbimeve OLAP dhe kërkesat për OLAP të përmbledhur në dymbëdhjetë rregulla si më poshtë:

### 1. Pamja konceptuale shumë përmasore

Pamja e përdoruesve fundorë në modelin OLAP duhet të jetë shumë përmasore meqenëse analiza që do të bëhet nga natyra është shumë përmasore. Pamja shumë përmasore jo domosdoshmërisht nënkupton që të dhënat nuk ruhen në shumë përmasa.

### 2. Transparenca

Arkitektura OLAP duhet të jetë transparente, p.sh.faktet si, nëse arkitektura klient-server është pas aplikacionit, ose në cilën shtresë shtrihet funksionaliteti OLAP-it, duhet të jetë transparente për përdoruesin.

### 3. Aksesimi

Mjetet e OLAP duhet të jenë në gjendje të hartojnë skemën e tyre logjike në mbledhjen e të dhënave nga burime të ndryshme, heterogjene, relacionare dhe jo-relacionare të të dhënave. Përdoruesit fundorë duhet të jenë të lidhur me atë nga ku vijnë të dhënat ose se si do të ruhen fizikisht të dhënat, të dhënat duhet të shfaqen me pamje të vetme dhe konsekuente.

#### 4. Raportimi konsekuent i performancës

Kur numri i dimensioneve dhe madhësia e bazës së të dhënave rritet, përdoruesi nuk duhet të vërejë ndonjë raportim të rëndësishëm për degradimin e performancës. Në rastet kur performanca bëhet një çështje, mjetet e OLAP mund të propozojnë strategji alternative të tilla si paraqitjen e informacionit në ndonjë mënyrë tjetër.

#### 5. Arkitektura klient-server

Është e detyrueshme për mjetet e OLAP të jenë në gjendje të veprojnë në një mjedis klient-server pasi shpesh kubat e të dhënave janë depo qendrore të cilat aksesohen në distancë nga aplikimet e klientit.

#### 6. Dimensionaliteti i përgjithshëm

Çdo dimension i të dhënave duhet të jetë ekuivalent me kapacitetet si në strukturë ashtu edhe në operim.

Mund të shtohen karakteristika të tjera për dimensione të veçanta, por struktura themelore duhet të jetë e njëjta për të gjitha dimensionet dhe kështu karakteristikat e tjera duhet të jenë të mundura për çdo dimension.

#### 7. Dynamic Sparse Matrix Handling

Një kub tipik i të dhënave është shumë i rrallë. Prandaj, mjetet e OLAP duhet të trajtojnë matricat në mënyrë dinamike për të shmangur faktin që madhësia e kubit të rritet pa qenë e nevojshme. Nuk është e nevojshme të llogaritet agregimi për çdo qelizë të mundshme në kub në qoftë se vetëm një pjesë e vogël e qelizave në të vërtetë përmbajnë të dhëna.

#### 8. Suporti shumë-përdorues

Mjetet e OLAP duhet të sigurojnë akses të njëkohshëm për të dhënat dhe modelin OLAP, në mënyrë që të ruhet integriteti dhe siguria.

#### 9. Operacionet e pakufizuara ndër-dimensionale

Një mjet i OLAP duhet të jetë në gjendje të bëjë llogaritje dhe operacione të tjera në të gjithë dimensionet pa i kërkuar përdoruesit të përcaktojë në mënyrë eksplicite llogaritjen aktuale. Mjetet duhet të sigurojnë disa gjuhë për përdoruesit për t'i shfrytëzuar ato në mënyrë që të shprehin operacionet e dëshiruara.

#### 10. Manipulimi i të dhënave

Operacionet Drill-down, roll-up dhe të tjera që shtrihen në natyrën hierarkike të dimensionit duhet të kenë akses të lehtë me anë të manipulimit të drejtpërdrejtë të shfaqjes së të dhënave dhe nuk duhet të kërkojnë operacione të panevojshme të ndërfaqes së përdoruesit të tilla si menuja e navigimit.

#### 11. Raportimi fleksibël

Raportimi duhet të jetë fleksibël në kuptimin që rreshtat shtyllat dhe header-at e faqeve në raportin përfundimtar duhet të jenë në gjendje të përmbajnë numrin e dimensioneve nga modeli i të dhënave dhe çdo dimension i zgjedhur duhet të jetë në gjendje të shfaqë anëtarët e saj dhe lidhjet midis tyre.

#### 12. Dimensionet e pakufizuara dhe nivelet e agregimit

Në artikull Codd shprehet se një mjet i rëndësishëm i OLAP duhet të jetë në gjendje të trajtojë së paku pesëmbëdhjetë dhe mundësisht njëzet dimensione brënda të njëjtit model. Ndoshta ky rregull duhet të shtrihet për të lejuar një sasi të pakufizuar dimensionesh, ashtu siç nënkupton emri i rregullit. Në të dyja rastet, është deklaruar se çdo dimension duhet të lejojë për një sasi të pakufizuar përdoruesish nivele të përcaktuara agregimi brenda hierarkisë dimension.

Është e qartë se OLAP nuk duhet të implementohet si një teknologji e re e bazave të të dhënave meqenëse modeli relacionar i bazës së të dhënave është "teknologjia më e përshtatshme për bazat e të dhënave për një ndërmarrje". Gjithashtu theksohet se modeli relacionar kurrë nuk ka për qëllim të ofrojë shërbimet e mjeteve OLAP, por që këto shërbime duhet të shtohen nga mjetet e përdoruesve fundorë që të plotësojnë sistemet RDBMS me analizën e të dhënave në kohë reale.

## 2.10 Arkitektura e kubave

Edhe pse parimet themelore të kubave janë të njëjta, kubat mund të zbatohen në mënyra të ndryshme. Shitës të ndryshëm përkrahin arkitektura të ndryshme dhe disa ofrojnë mundësinë për të zgjedhur një arkitekturë për çdo kub që krijohet. Ka dy arkitektura kryesore që tradicionalisht janë diskutuar në fushën e bazës së të dhënave; *Multidimensionale* OLAP (MOLAP) dhe *Relacionare* OLAP (ROLAP).

MOLAP bazohet mbi filozofinë që kubat janë shumëdimensional në natyrën e tyre, të dhënat duhet të ruhen në mënyrë shumë dimensionale. Kështu, të dhënat kopjohen nga data warehouse në ruajtjen e kubave dhe agregohen sipas kombinimeve të ndryshme të dimensioneve të cilat janë të përlllogaritura dhe të depozituara në kuba sipas një strukture rrjet e bazës së të dhënave. Kjo do të thotë se koha e përgjigjes për query është shumë e shkurtër pasi nuk është e nevojshme të bëhen llogaritje në kohën kur bëhet query. Nga ana tjetër, ngarkimi i kubave është një proces i shtrenjtë për shkak të të gjitha llogaritjeve që duhen bërë dhe për këtë arsye të dhënat e kubave planifikohen të ngarkohen kur ato nuk kanë gjasa që të aksesohen, në intervale të rregullta si një herë në javë, në fundjavë apo çdo natë.

Një problem që duhet të merret parasysh kur punojmë me MOLAP është shpërthimi i të dhënave. Kjo është një dukuri që ndodh kur agregimi i të gjitha kombinimeve e dimensioneve duhet të llogariten dhe ruhen fizikisht. Për çdo dimension që shtohet në kub, numri i agregimeve që do të llogaritet rritet në mënyrë eksponenciale. ROLAP, ashtu siç dhe sugjeron emri, bazohet në modelin relacionar. Ideja kryesore është se është më mirë të lexohen direkt nga data warehouse, sesa të përdorin një tjetër lloj ruajtje për kubat. Ashtu si në rastin me MOLAP, të dhënat mund të agregohen dhe të pre-llogariten në ROLAP gjithashtu, duke përdorur pamjet e materializuara, pra ruajtja e agregimeve fizikisht në tabelat e bazës së të dhënave. Një arkitekturë ROLAP është më fleksibël pasi ajo mund të pre-llogarisë disa nga agregimet, por lë të tjerët të llogariten kur kërkohen. Gjatë viteve, ka pasur një debat të madh në fushën kërkimore nëse OLAP duhet të implementohet si MOLAP apo ROLAP. Debat i është venitur dhe në dekadën e fundit kërkuesit argumentojnë se ROLAP është më superior ndaj MOLAP. Argumentet janë se ROLAP performon pothuajse aq mirë sa MOLAP kur ka pak dimensione dhe kur ka shumë dimensione MOLAP nuk mund t'i trajtojë ato për shkak të shpërthimit të dhënave [17]. Tashmë për rreth 10-20 dimensione numri i llogaritjeve bëhet jashtëzakonisht i madh si pasojë e rritjes eksponenciale. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është fleksibiliteti më i madh i ROLAP; të gjitha agregimet nuk kanë nevojë të llogariten paraprakisht, pasi ata mund të llogariten sipas kërkesave.



Vitet e fundit është propozuar dhe teknologjia HOLAP (Hybrid Online Transaction Processing) e cila është një kombinim i ROLAP dhe MOLAP.

HOLAP lejon ruajtjen e një pjese të të dhënave në një memorie MOLAP dhe një pjesë tjetër të dhënash në një memorie ROLAP duke lejuar një tradeoff të avantazheve të secilës [14].

## 2.11 Kubat relacionar të të dhënave

Një mënyrë për të implementuar kubat relacionare të të dhënave u propozua nga Gray më 1997. Operatori kubit - i cili është një përgjithësim n-dimensional i të njohurit *group by* - dhe operatorët e lidhur ngushtë me *rollup* përshkruhen në detaje. Kubat dhe operatori rollup janë implementuar në disa motorë bazash të të dhënave relacionare për të siguruar përdorimin e të dhënave të kubave. Marrim në konsideratë shembullin në Tabelën 2. Një kompani ka shitur xhinse dhe doreza me dy ngjyra, të zeza dhe blu. Shuma e përgjithshme e artikujve të shitur gjatë vitit 2017 dhe 2018 është përmbledhur për çdo vit si dhe ngjyra gjithashtu. Një menaxher ndoshta do të dëshironte të shikonte shifrat në trajtën e shitjeve totale për një vit, numrin total të xhinseve të shitura gjatë 2017, ose numrin e dorezave blu të shitura gjatë 2018.

Operatori kubit shpreh vendosjen e të dhënave në tabelën pivot në kontekstin e bazës së të dhënave relacionare. Ky operator në thelb është një set i *group by* të vendosura së bashku me një operacion bashkimi.

Tabela 2-1 Shembulli i tabelës së shitjeve për disa produkte të kompanisë

Produkti	Viti	Ngjyra	Shitjet
Xhinsa	2017	Të zeza	231
Xhinsa	2017	Blu	193
Xhinsa	2018	Të zeza	205
Xhinsa	2018	Blu	236
Doreza	2017	Të zeza	198
Doreza	2017	Blu	262
Doreza	2018	Të zeza	168
Doreza	2018	Blu	154

Një mënyrë intuitive për të arranzhuar të dhënat për këtë qëllim është përdorimi i tabelave pivot. Në këto tabela, të dhënat strukturohen sipas etiketave të rreshtave dhe kolonave dhe përmbledhet sipas dimensioneve në mënyrë që të kemi një pamje të qartë tyre.

Tabela 2.2 është shembulli se si Tabela 2.1 duhet të arranxhohet si një tabelë pivot  
Tabela 2-2 Shembull i tabelës pivot.

	2017		2018		2018		Totali përgjithshëm	i
	Të zeza	Blu	Total	Të zeza	Blu	Total		
Xhinsa	231	193	424	205	236	441	865	
Doreza	198	262	460	168	154	322	782	
Totali përgjithshëm	429	455	884	373	390	763	1647	

Ai grupon të dhënat sipas dimensioneve (atributeve) të dhënave, në këtë rast Produkti, Viti dhe Ngjyra dhe agregimet bëhen për të gjitha kombinimet e mundshme të dimensioneve. Tabela 2.3 ilustron të dhënat si rezultat kur operatori kub përdoret në kombinim me operatorin SHUMË.

Tabela 2-3 Rezultatet e operatorit të kubit në agregimin e operatorit shumë, kur aplikohet në Tabelën 2.1.

Produkti	Viti	Ngjyra	Shitjet	Produkti	Viti	Ngjyra	Shitjet
Xhinsa	2017	Të zeza	231	Doreza	2018	ALL	322
Xhinsa	2017	Blu	193	Doreza	2018	Të zeza	366
Xhinsa	2017	ALL	424	Doreza	2018	Blu	416
Xhinsa	2018	Të zeza	205	Doreza	2018	ALL	782
Xhinsa	2018	Blu	236	ALL	2017	Të zeza	429
Xhinsa	2018	ALL	441	ALL	2017	Blu	455
Xhinsa	ALL	Të zeza	436	ALL	2017	ALL	884
Xhinsa	ALL	Blu	429	ALL	2018	Të zeza	373
Xhinsa	ALL	ALL	865	ALL	2018	Blu	390
Doreza	2017	Të zeza	198	ALL	2018	ALL	763
Doreza	2017	Blu	262	ALL	2018	Të zeza	802
Doreza	2017	ALL	460	ALL	2018	Blu	845
Doreza	2018	Të zeza	168	ALL	2018	ALL	1647
Doreza	2018	Blu	154				

Vlerat speciale ALL janë futur për të treguar që rekorde të caktuara përmbajnë agregimin mbi atributet që kanë të njëjtën vlerë. Vlera NULL mund të përdoret në vend të vlerës ALL në mënyrë që të mos manipulohet gjuhën SQL. Operatori kub ka si rezultat shumë agregime, por të gjitha kombinimet e agreguara janë rallë të dëshiruara dhe prandaj u propozua dhe operatori rollup. Ky operator punon në të njëjtën mënyrë si operatori kub por me një ndryshim, agregimet e reja llogariten vetëm nga agregimet e llogaritura deri në atë moment.

Tabela 2-4 ilustron rezultatet që marrim nga operatori rollup. Algoritme të ndryshme janë zhvilluar në mënyrë që të përmirësohet performanca e operatorit të kubit. Të gjithë algoritmet shfrytëzojnë faktin që një agregim përdor operacionin group by (më sipër e quajtmë thjesht group by) në përgjithësi nuk ka nevojë të llogaritet nga relacioni aktual, por mund të llogaritet nga rezultati i një “group by” tjetër. Kështu që vetëm një “group by” duhet të llogaritet nga relacioni, ku njëra quhet granulariteti me i mirë dhe gjithë të tjerat mund të llogariten nga ky rezultat.

Tabela 2-4 Rezultatet e operatorit rollup kur aplikohet në Tabelën 2.1.

Produkti	Viti	Ngjyra	Shitjet	Produkti	Viti	Ngjyra	Shitjet
Xhinsa	2017	Të zeza	231	Doreza	2017	Të zeza	198
Xhinsa	2017	Blu	193	Doreza	2017	Blu	262
Xhinsa	2017	ALL	424	Doreza	2017	ALL	460
Xhinsa	2018	Të zeza	205	Doreza	2018	Të zeza	168
Xhinsa	2018	Blu	236	Doreza	2018	Blu	154
Xhinsa	2018	ALL	441	Doreza	2018	ALL	322
Xhinsa	2018	ALL	865	Doreza	2018	ALL	782
ALL	2018	ALL	1647				

Figura 2.4 ilustron se si rezultatet e “group by” mund të përdoret për të llogaritur agregimet e tjera. A, B, C dhe D janë atributet në relacion dhe çdo nyje në graf përfaqëson setin resultant të group by në atributet e nyjes. Atributi ALL në nyjen e pare tregon që nuk ka group by. Nyjet në fund përmbajnë atributet {A, B, C, D}, që tregon se nyja përfaqëson rezultatet e group by të katërtributeve. Duke përdorur këto rezultate, operacioni group by në {A,B,C}, {A,B,D}, {A,C,D} dhe {B,C,D} mund të llogaritet. Duke u ngjitur më lart në graf, shohim se rezultatet e “group by” në {A,B,C} mund të përdoren për të llogaritur rezultatet e operacionit “group by” në {A,B}, {A,C} dhe {B,C}, etj.




Figura 2-4 Grafi përshkruan se si operacioni group by mund të llogaritet duke përdorur operacionin group by të mëparshëm në vend të burimit të të dhënave

Kjo teknikë përmirëson performancën duke minimizuar diskun I/O por gjithashtu edhe duke minimizuar numrin e agregimeve duke mos agreguar të gjitha kombinimet e mundshme që janë rezultat i operatorit kub. Diferencat ndërmjet algoritmeve qëndrojnë në faktin se përdorin strategji të ndryshme për të zgjedhur se cili rezultat do të përdoret për llogaritjen e rezultateve të rejave, ose se si zgjedhin rrugë të ndryshme në grafën si në Figurën 2.4.

## 2.12 Performanca

Siç e përmendëm dhe më sipër, performanca është një çështje e madhe kur bëhet fjalë për një sasi të madhe të dhënash. Ka metoda që realizojnë përmirësimin e performancës së kubave të të dhënave, si për MOLAP dhe ROLAP.

### 2.12.1 Grupimet

Kur flasim për performancën e bazës së të dhënave, disku I/O është një problem meqenëse aksesimi i diskut shkakton vonesa më të mëdha se sa aksesimi i memories. Një zgjidhje e cila përdoret gjerësisht për minimizimin e aksesimit të diskut është grupimi (clustering). Principi bazë i klastering është organizimi i strukturës së diskut të të dhënave në mënyrë që të bëhet e mundur që rekordet të bëhen query dhe të ruhen fizikisht së bashku. Kjo do të thotë se blloqe të mëdha të dhënash të lexohen njëkohësisht, në vend të aksesimit për çdo rekord ,të cilët mund të jenë të shpërndarë në disk.

### 2.12.2 Indeksimi bitmap

Një mënyrë për të indeksuar bazën e të dhënave relacionare është përdorimi i pemës B+- për kërkimin dhe përdorimin e Row Identifiers (RIDs) në nyjet gjethe, për të specifikuar adresat fizike të diskut ku rreshtat e të dhënave shkruhen. Nëse të dhënat janë vetëm të lexueshme, si në bazën e të dhënave OLAP, performanca e query-it mund të përmirësohet duke përdorur

indeksin bitmap Index. Nëse të dhënat nuk janë vetëm të lexueshme si në rastin tipik të bazës së të dhënave OLTP, indeksi bitmap nuk është një ide e mirë për t’u përdorur pasi kërkon kosto të lartë për operacionet e futjes dhe nxjerrjes [15-16].

Ideja bazë e indeksit bitmap është se për çdo vlerë të mundshme në kolonën që do të indeksohet, bitmap krijohet me një bit për çdo rresht në tabelë. Në një bitmap të caktuar, të gjitha bitet që korrespondojnë me vlerën e përfaqësuar bëhet “1” dhe gjithë bitet e tjera bëhen “0”.

Tabela 2-5 Shembull i indeksimit bitmap.

Produkti	Ngjyra	B <sub>1</sub>	B <sub>2</sub>	B <sub>3</sub>
Xhinsa	Blu	1	0	0
Corape	Të zeza	0	0	1
T-shirt	Të zeza	0	0	1
T-shirt	Blu	1	0	0
Doreza	Të bardha	0	1	1

Tabela 2-5 ilustron idenë e indeksit bitmap; përmban pak produkte dhe ngjyrat e tyre, ku kolona e ngjyrës do të indeksohet. Për çdo ngjyrë të mundshme, krijohet një bitmap B<sub>i</sub> që shënon të gjitha njësitë në relacionin që ka këtë ngjyrë si vlerë, p.sh. të gjitha njësitë me vlerë atributi ‘Blu’ përfaqësohen nga B<sub>1</sub>=‘10010’. Duke patur parasysh se kardinaliteti i kolonës nuk është shumë i madh, p.sh. numri i vlerave të mundshme për atë kolonë nuk është shumë e madhe, mund të kemi dy tipe të ndryshme indeksimi bitmap. E para është që madhësia e kërkuar e diskut për të ruajtur indekset të reduktohet krahasuar me përdorimin e pemës B+- . Në shembujt e mësipërm, tre bitet që kërkohen për çdo vlerë, krahasohen me madhësinë e adresave të diskut kur përdoren RIDs. Përmirësimi i dytë është performanca. Operatorët AND, OR dhe NOT janë shumë të shpejtë dhe përdorimi i tyre bën të mundur ekzekutimin e query-it duke përdorur kushtin WHERE në mënyrë shumë efiçiente. Operacioni i agregimit si SHUMA dhe AVG afektohen gjithashtu nga zgjedhja e indeksit. Pra indeksimi bitmap nuk është mjaft i përdorshëm nëse vlera që do të indeksohet është një integer i cili mund të ketë qindra vlera të mundshme.

Në vend të tij përdorim një variant të quajtur indeksi bit-sliced që mund të përdoret në rastet kur duhet të ruajmë përfitimet nga indekset bitmap. Supozojmë se një kolonë objekt popullohet nga vlera integer të përfaqësuara nga N bite. Indeksi bit-slice përcakton një bitmap për çdo N bite, në vend të një bitmap për çdo vlerë të mundshme.

Tabela 2-6 ilustron idenë; sasia e artikujve të shitur për çdo produkt përfaqësohet nga kodimi binar me kolonën B<sub>3</sub> që përfaqëson bitin me më pak peshë dhe kolona B<sub>1</sub> përfaqëson bitin me më shumë peshë.

Duke lexuar këto kode binare me anë të kolonave të dhëna japin bitmap në indeks, p.sh. B<sub>1</sub> = ‘1100’.

Tabela 2-6 Shembull i indeksimit bit-sliced.

Produkti	Sasia e shitur	B <sub>1</sub>	B <sub>2</sub>	B <sub>3</sub>
Xhinsa	5	1	0	1
Corape	7	1	1	1
T-shirt	3	0	1	1
Doreza	2	0	1	0

Duke përdorur metodën e indeksimit, performanca e query rritet kur bëhen agregimit. Nëse skema relacionare ka kardinalitet të lartë, madhësia e indeksit të bitmap do të rritet më shumë sepse çdo vlerë e mundshme do të sjellë rritje në bitmapin tjetër, me aq bite sa njësi janë në relacion. Në të tilla raste ka teknika kompresimi që reduktojnë madhësinë e bitmap.

Dy skema të zakonshme kompresimi janë kodi byte-aligned bitmap (BBC) dhe kodi word-aligned hybrid (WAH). Kodi BBC bazohet në operacionet në byte dhe kodi WAH është një variant i BBC që bazohet në adresim fjalë. Në thelb, të dyja metodat punojnë duke gjetur sekuenca të vijueshme bitesh që kanë të njëjtën vlerë dhe i zëvendësojnë ato me vlera bitesh dhe një numërues që numëron se sa bite janë në sekuençë. Këto teknika kompresimi në rastin më të keq rezultojnë në indekse po aq sa ato të pemës B+- por shpesh edhe më të vogla. Megjithatë, shumë operacione logjike mund të kryhen pa dekompresuar të dhënat [15-16].

### 2.12.3 Copëzimi

Një teknikë tjetër që rrit performancën e query në OLAP, është vendosja në cache e rezultateve të query të kërkuar por në copëza në vënd të të gjithë rezultatit. Në një mjedis shumëdimensional, kërkesa për query të ndryshme rezulton në dimensione të ndryshme dhe shpesh rezultatet ndërpriten, duke rezultuar në të njëjtin subset. Duke përdorur cache-t e query-it, këto nënsete zakonisht nuk mund të vendosen në cache dhe ripërdoren nëse i gjithë query bëhet përsëri. Përdorimi i copëzave, pjesë më të vogla të secilit query vendoset në cache dhe kur kërkohet një query i ri mjeti i cache-së gjen se cila copëz ekziston në cache dhe i dërgon ato të query bashkë me copëzat e reja të llogaritura që nuk ekzistojnë në cache. Me anë të kësaj teknike, rezultatet e query mund të ripërdoren në mënyrë më eficiente, që do të thotë se të dhënat që kërkohen më shpesh duhet të ruhen në copeza në memorie dhe nuk kanë pse të lexohen nga disku për çdo query.

Optimizimi i mëtejshëm realizohet duke organizuar sistemin me file fundore me anë të copëzave, si dhe duke implementuar suportin për copezat e file-ve në DBMS ose duke lejuar RDBMS ekzistues të indeksojë file-t nga atributet e copëzave që u shtohen tabelave. Kjo është një formë e klastering që tregoi se ishte shumë efiçiente për të dhënat shumëdimensionale.

### 2.13 Konkluzione

Në këtë kapitull, u analizuan magazinat e të dhënave DW dhe arkitekturat kryesore të tyre, përkatësisht Star dhe Snowflake. U listuan avantazhet dhe disavantazhet e secilës arkitekturë. Më pas u shpjegua koncepti i kubave të të dhënave dhe arsyet e përdorimit të tyre në sistemet BI. Pamë dhe 3 teknologjitë kryesore OLAP (ROLAP, MOLAP, HOLAP) dhe karakteristikat e tyre. Kryem një studim teorik të performacës së secilës teknikë dhe gjithashtu dhamë rekomandime në implementimin e sistemeve OLAP. Diferencat kryesore të sistemeve DW dhe relacionale u listuan dhe shpjeguan.

## KAPITULLI 3

### 3. TEKNIKAT E DATA MINING

#### 3.1 Hyrje

Data mining është procesi i nxjerrjes në pah të informacionit të dobishëm dhe më të vlefshëm që mund të përftohet nga analiza e një sasive të madhe të dhënash. Ky proces përdor teknika të ndryshme të përpunimit të të dhënave, teknika statistikore, matematikore, ato të inteligjencës artificiale si dhe të mësimin automatik. Karakteristika kryesore e kësaj teknike është fuqia e saj parashikuese. Kjo veçori vjen si fryt i dizajnit unik duke kombinuar teknika nga mësimi automatik, njohja e sjelljes dhe statistika, me qëllim marrjen e informacionit rreth sjelljeve, koncepteve ose korelacionit midis elementeve (variablove) të ndryshëm nga depozitorët e të dhënave.

Biznesi përmes mënyrave më të zakonshme të raportimit arrin fillimisht të perceptojë disa sjellje të fshehura në indikatorë ose variabla kyç në të dhënat e tij. Pikërisht këto lidhje ose sjellje të fshehura shërbejnë si input për ndërtimin e modeleve DM, të cilët arrijnë të bëjnë më pas parashikime [20] të një saktësie të lartë në lidhje me performancën ose sjelljen e indikatorëve të ekstraktuar fillimisht nga baza e të dhënave.

DM përshkruese dhe ajo e parashikimit janë qasjet më të përdorura në zbulimin e informacionit të fshehur në sasi të mëdha të dhënash [19].

Data Mining është aktualisht një disiplinë e konsoliduar në shkencat kompjuterike. Origjina e kësaj discipline mund të përcaktohet në fundin e viteve 80 kur filloi të lakohet si terminologji fillimisht në rrethin e shkencëtarëve që merreshin me kërkime në këtë fushë.

Ashtu sikurse në fillimet e saj por edhe në ditët e sotme termi data mining lë shumë për të diskutuar. Në terma të përgjithshëm ai mund të shihet si një set mekanizmesh dhe teknikash, të jetësuar në një software, me qëllim ekstraktimin e informacionit të fshehur në një grumbullim të madh të dhënash.

Termi ‘i fshehur’ në këtë përkufizim është shumë i rëndësishëm; SQL, pavarësisht se është një teknikë e sofistikuar e marrjes së të dhënave, nuk është data mining.

Në fillimin e viteve 1990 data mining njihet më së gjeri si një nën proces në një zinxhir të madh procesesh të quajtur, zbulimi i informacionit në bazat e të dhënave (Knowledge Discovery in Databases) ose KDD. Përkufizimi më i përdorur për KDD është ai i cituar nga (Fayyad et al. 1996) si më poshtë:

KDD është procesi jo më pak i rëndësishëm i identifikimit të informacionit të vlefshëm, të përdorshëm dhe të kuptueshëm në lidhje me sjelljen e të dhënave.

Në tërë ciklin e KDD, data mining është një prej nën proceseve. Të tjerë nën procese që formojnë KDD janë përgatitja e të dhënave (ruajtja, kontrolli/pastrimi, para-proçesimi, etj) si dhe analiza/vizualizimi i rezultateve.



Shpesh KDD dhe DM shihen si sinonime të njëri tjetrit, por teknikisht njëri është nën proces i tjetrit. Ekzistojnë dy modele të rëndësishëm në Data Mining: modeli përshkrues dhe modeli parashikues.




Figura 3-1 Modeli DM përshkrues (i pasupervizuar) dhe modeli DM parashikues (i supervizuar)

Modeli përshkrues analizon evente të ndodhura në të shkuarën me qëllim kuptimin e situatës ose pozicionit aktual, për të zgjedhur më pas mënyrën më të mirë për t'ju qasur të ardhmes. Kjo teknikë analizon sjelljen e të dhënave në të shkuarën për të identifikuar faktorët që mund të kenë çuar në sukses ose dështim. Pothuajse të gjithë departamentet që kanë një linjë raportimi direkte pranë menaxhimit, si shitje, marketing, operacione dhe finance, përdorin të gjithë këtë lloj analize pas ndodhjes së faktit.

Modelet përshkruese japin informacion sasior, ato kuantifikojnë relacionet mes të dhënave në mënyrë të atillë që të arrihet të bëhet një klasifikim i klienteve ose produkteve në grupe të caktuara. Ndryshe nga modelet parashikuese të cilat fokusohen në parashikimin e sjelljes së një klienti ose në renditjen e klientëve në varësi të probabilitetit që shfaq secili prej tyre në ndërmarrjen e një veprimi, modelet përshkruese gjejnë marrëdhënie të ndryshme mes klientëve dhe produkteve. Teknika të përdorura nga këto modele janë: Ndarja në klasa, Rregullat e asociimit dhe Ekstraktimi i veçorive.

Modelet parashikuese i kthejnë të dhënat në informacion të dobishëm. Analizat që bëhen përmes këtyre modeleve arrijnë të parashikojnë një ngjarje të mundshme në të ardhmen ose ecurinë e një situatë aktuale. Kjo teknikë njihet ndryshe si të mësuarit e supervizuar. Teknikat e modeleve parashikuese janë të përshtatshme për t'u përdorur kur lind nevoja e parashikimit të një vlere x të vendosur si objektiv. Në fushën e biznesit, këto modele eksplorojnë sjelljet në të dhënat historike dhe ato transaksionale mes faktorëve/variablave të ndryshëm, me qëllim identifikimin e risqeve dhe oportuniteteve të së ardhmes, duke ndikuar kështu në marrjen e vendimeve mbi transaksione ose evente opsional që mund t'i paraqiten menaxhimit.

Modelet parashikuese përfshijnë: Ndarjen në klasa, Identifikimin e anomalive, Regresin dhe Analizën e serive kohore.

## 3.2 Modeli përshkrues

Janë 3 teknikat më të përdorura në modelin përshkrues DM: Ndarja në klasa, Asocimi dhe Ekstraktimi i veçorive.

### 3.2.1 Ndarja në grupe

Ndarja në klasa është një teknikë e rëndësishme në data mining, ajo përfshin procesin e grupimit të të dhënave në një set grupesh në mënyrë që objektet e çdo grupi të kenë të njëjtat karakteristika me objektet e tjerë në grupin në të cilin bëjnë pjesë, por gjithashtu të jenë të dallueshëm nga objektet përbërës që i përkasin një grupi tjetër. Ngjashmëritë dhe veçoritë mes objekteve përcaktohen bazuar në vlerat e attributeve që përshkruajnë objektet. Ky proces grupimi realizohet pa patur asnjë të dhënë fillestare mbi emërtimin ose etiketimin e klasave/grupeve. Një grupim i mirë do ishte ai që do të reflektonte një shkallë të lartë ngjashmërie mes objekteve të një grupi si dhe një shkallë të lartë diversiteti mes dy grupeve. Superioriteti i algoritmit të përdorur për grupimin varet si nga matjet e ngjashmërisë të përdorura nga metoda ashtu dhe nga implementimi. Gjithashtu shkallë e lartë superioriteti tregon dhe aftësia për të zbuluar sa më shumë sjellje të fshehura nga të dhënat në analizë. Metodat e grupimit mund të krahasohen në mënyra të ndryshme duke marrë në shqyrtim kriteret e ndarjes, ndarjen e grupeve, matjen e ngjashmërive dhe hapësirën e grupit. Algoritmat e këtij tipi mund të kategorizohen në algoritme të bazuar në particionim, në ndarjen hierarkike, në algoritmet e bazuar në densitet si dhe ato të bazuar në shpërndarjen e të dhënave.

Tabela 3-1 Algoritme të Klasterizimit

Algoritme të bazuar në particionim	Algoritme të bazuar në ndarjen hierarkike	Algoritme të bazuar në densitet	Algoritme të bazuar në shpërndarjen e të dhënave
K-Means	Agglomerative (BIRCH, CHAMALEON)	DBSCAN	STING
K-Medoids (PAM,CLARA)	Divisive	DENCLUE	CLIQUE

Këto metoda ndryshojnë në (I) procedurat e përdorura për matjen e ngjashmërisë (brenda të njëjtit grup dhe mes grupeve), (II) në përdorimin e vlerave kufi në definimin e grupeve, (III) mënyrën e grupimit, duke i lejuar objektet të jenë në mënyrë strikte pjesë vetëm e një grupi apo mund të bëhen pjesë e grupeve të ndryshme në shkallë të ndryshme dhe në strukturën e algoritmit.

### 3.2.2 Asocimi

Një tjetër teknikë e rëndësishme në data mining është ai i rregullave të asocimit. Kjo teknikë kërkon për lidhjet që mund të ekzistojnë mes variablave.

Një shembull nga biznesi do ishte rasti i një dyqani që mbledh të dhëna mbi shitjet, me ndihmën e kësaj teknike mund të kuptohen cilët janë produktet që blihen në mënyrë frekvente me njëri tjetrin. Ky informacion i përfutur mund të përdoret më tej për arsye marketingu, kjo njihet shpesh si analiza e shportës së tregut.

Sjelljet që mund të zbulohen përmes kësaj teknike të data mining, mund të paraqiten në formën e rregullave të shoqërimit. Tipikisht këto rregulla quhen interesante nëse plotësojnë njëkohësisht një vlerë kufi minimum suporti dhe një minimum vlere kufi konfidence. Këto vlera kufi mund të përcaktohen paraprakisht nga përdoruesi ose nën një gjykim eksperti.

Përkufizim: Le të jetë  $I = \{I_1, I_2, \dots, I_m\}$  një set artikujsh. Le të jetë  $D$ , një set transaksionesh, objekt i studimit, ku çdo transaksion  $T$  është një set elementesh në mënyrë të tillë që:  $T \subseteq I$ . Çdo transaksion është i lidhur me një çelës identifikues të quajtur TID. Le të jetë  $A$ , një set elementesh. Një transaksion  $T$  mund të përmbajë një  $A$  vetëm nëse  $A \subseteq T$ . Një rregull shoqërimi do ishte një implikim i formës  $A \rightarrow B$ , ku  $A \subset I$ ,  $B \subset I$  dhe  $A \cap B = \emptyset$ . Rregulli  $A \rightarrow B$  bazohet në setin e transaksioneve  $D$  me suport  $s$ , ku  $s$  është përqindja e transaksioneve në  $D$  që përmbajnë  $A \cup B$ . Rregulli  $A \rightarrow B$  ka një konfidencë  $c$  në setin e transaksioneve  $D$  nëse  $c$  përcakton frekuencën e elementeve të  $B$ -së që shfaqen në transaksionet që përmbajnë  $A$ . Pra,  $\text{support}(A \rightarrow B) = \text{Prob}\{A \cup B\}$  dhe  $\text{konfidence}(A \rightarrow B) = \text{Prob}\{B/A\}$  [22].

Tabela 3-2 Shembull transaksionesh

TID	Artikuj
1	{Xhinse, T-Shirt, Këpucë, Çokollatë}
2	{Xhinse, Këpucë, Pallto, Syze}
3	{Orë, Çantë, Xhinse, T-Shirt}
4	{Rrip, Xhinse, Këmishë, Këpucë}

Supozojmë se  $A$  përfshin një listë artikujsh si: {Xhinse, T-Shirt} dhe  $B$  një listë artikujsh që përfshin {Këpucë}. Rregulli  $\{Xhinse, T-Shirt\} \rightarrow \{Këpucë\}$  ka një vlerë suport prej  $2/4=0.5$  dhe një vlerë konfidence prej  $2/3=0.67$ . Rregullat që plotësojnë njëkohësisht vlerën minimum të suportit dhe të konfidencës (minconf) quhen rregulla të forta. Disa prej algoritmeve më të njohur të teknikës së asociimit janë: AIS, SETM, Apriori, Aprioritid, Apriorihybrid, FP-Growth. Nga studimet më të fundit është vënë re që algoritmi FP-growth performon më mirë në aspektin e shpejtësisë dhe saktësisë se sa algoritma të tjerë më të vjetër si: AIS, SETM, Apriori, Aprioritid, Apriorihybrid [23].

### 3.2.3 Ekstraktimi i veçorive

Ekstraktimi i veçorive është teknika që krijon karakteristika të reja duke përdorur atributet aktuale të të dhënave. Këto karakteristika të reja paraqesin kombinime të sjelljeve të

rëndësishme që mund të identifikohen nga vlerat e attributeve. Modele të ndërtuara mbi bazën e këtyre karakteristikave të reja mund të jenë të një cilësie të lartë pasi mund ti përshkruajnë në mënyrë më konçize dhe të kuptueshme atributet.

Kjo teknikë në dallim nga selektimi i veçorive, që bën një renditje të attributeve ekzistuese në varësi të fuqisë parashikuese, realizon transformim të këtyre attributeve. Atributet e transformuara ose karakteristikat e reja janë një kombinim linear i attributeve origjinale. Paraqitja e të dhënave në këtë format të ri, përmes karakteristikave të reja, ndihmojnë në kompresimin e datasetit (duke zëvendësuar disa attribute me vlerën e një karakteristike të përfutur), lejon bërjen e parashikimeve (të dhënat me një karakteristike  $x$  kanë gjithashtu edhe vlerat e attributeve nga të cilat ka derivuar kjo karakteristikë) si dhe ndihmon në identifikimin e sjelljeve të fshehura të të dhënave.

Gjithashtu karakteristikat e reja të krijuara mund të shërbejnë si attribute të rinj, duke rritur kështu efikasitetin dhe saktësinë e teknikave të tipit të supervizuar si: klasifikimi, regresi, detektimi anomalive etj.).

Disa prej teknikave më të përdorura të ekstraktimit të veçorive janë: Principal Component Analysis (PCA) dhe Linear Discriminant Analysis (LDA).

PCA është metoda statistikore më e përdorur. Kjo metodë ekstraktton një hapësirë dimensionale më të ulët duke analizuar kovariancën strukturore të observimeve statistikore multivariate.

LDA kryesisht tenton të projektojë datasetet multidimensionale në të dhëna të një hapsire dimensionale më të vogël. Kjo teknikë synon të maksimizojë distancën mes klasave dhe të minimizojë atë midis elementeve të së njëjtës klasë [24].

### 3.3 Modeli parashikues

Janë 4 teknikat më të rëndësishme që përdoren nga modelet DM parashikuese. Konkretisht: Klasifikimi, Regresioni, Serite Kohore dhe Identifikimi i anomalive.

#### 3.3.1 Klasifikimi

Teknikat e klasifikimit në data mining janë në gjendje të procesojnë sasi të mëdha të dhënash. Ato mund të shërbejnë për përcaktimin e klasave kategorike mbi një training dataset dhe bëjnë gjithashtu klasifikimin e të dhënave të reja me të cilat mund të furnizohet seti i të dhënave. Procedura e klasifikimit njihet si metoda e marrjes së vendimeve në situata të reja. Krijimi i një procedure klasifikimi nga një set të dhënash për të cilat njihen paraprakisht klasat kryesore njihet si njohja e sjelljes. Kontekste në të cilat mund të përdoret kjo teknike janë psh. kategorizimi i klientëve individë në një institucion financiar sipas statusit, duke u bazuar në të dhënat e tyre financiare dhe ato personale. Ose diagnostikimi fillestar i një pacienti bazuar në simptomat madhore me qëllim fillimin e trajtimit urgjent gjatë kohës që priten rezultatet e tjera të testimeve. Në fushën e shkencës, në industri ose biznes, shfaqen shpesh situata kritike që kanë nevojë të klasifikohen dhe të merret një vendim në afat të shkurtër kohe. Klasifikimi bazohet në parashikimin e vlerave të mundshme që mund të marrë një variabël i nevojshëm për t'u parashikuar, bazuar në një input fillestar që i jepet modelit. Ky proces realizohet nga algoritmi i klasifikimit duke analizuar vlerat e attributeve të variablave input si dhe ato të variablit të target-uar që duhet të parashikohet. Algoritmi duhet të zbulojë lidhjet mes

atributeve kyç që mund të bëjnë më së miri parashikimin. Me të kuptuar këto relacione, në një dataset të ri ku variabli kyç që nevojitet të parashikohet mungon, me aplikimin e algoritmit në variablat e tjerë, mund të marrim një set të ri të dhënash me variablin target të plotësuar me vlera [25]. Shembull mund të jetë rasti i një set-i të dhënash nga një spital, i cili përmban rekordet e të gjithë klientëve të regjistruar ndonjëherë, duke patur informacion mbi sëmundjet dhe simptomat përkatëse. Në këtë rast sëmundja është variabli që kemi nevojë të parashikojmë ndërsa simptomat janë variablat inputues. Në momentin që inputojmë një set të ri të dhënash mbi pacientët e rinj të shtruar, algoritmi i klasifikimit duhet të jetë në gjendje të bëjë parashikimin rreth sëmundjes nga e cila mund të vuajnë këto pacientë.

Saktësia e parashikimit është elementi që përcakton se sa i mirë ose jo është algoritmi. Raporti i parashikimeve të sakta mbi totalin numrin e parashikimeve jep përqindjen se sa mirë janë bërë parashikimet. Një algoritëm i mirë parashikimi është ai që ka një përqindje saktësie më të lartë se sa vetë observimet finale të variablit parashikues. Në rastin e diagnozës së pacientëve, nëse rreth 80% e pacientëve që kanë vlera të rrahjeve të zemrës mbi 70 dhe janë të moshës mbi 65 vjeç ose kanë vlera të presionit të gjakut mbi 140/70 vuajnë nga sëmundjet kardiovaskulare, algoritmi i parashikimit duhet të ketë një % saktësie minimalisht 80%.

Metodat më të përdorura në ditët e sotme për këtë lloj algoritmi mund të grupohen si më poshtë [8] :

- Pema e marrjes së vendimeve (DT's)
- Support Vector Machine (SVM)
- Algoritmat Gjenetikë (GAs) / Evolutionary Programming (EP)
- Fuzzy Sets
- Rrjetat Neurale
- Rough Sets

### 3.3.2 Regresi

Regresi është një teknike data mining të të mësuarit automatik, që përpiket të përshtasë një ekuacion me një set të dhënash. Është më shumë i përdorur në rastet ku variabli target që duhet të parashikohet është i tipit numerik. Përmes regresit duhet të ndërtojmë një model duke u bazuar në lidhjet mes variablave të paravarur dhe variablit target që duhet të parashikohet, në një situatë ku vlerat e variablave të paravarur disponohen. Tipet kryesore të regresit janë:

- Regresi linear
- Regresi linear me shumë variabla
- Regresi jo linear
- Regresi jo linear me shumë variabla

Forma më e thjeshtë është regresi linear, i cili përdor formulën:  $(y = mx + b)$  dhe përcakton vlerat e duhura për  $m$  dhe  $b$ , në mënyrë që të zbulohen vlerat që mund të marrë  $y$ , bazuar në vlerat input të variablit  $x$ . Koeficientët  $m$  dhe  $b$  quhen koeficientët e regresit,  $m$  përcakton pjerrësinë e kurbës ndërsa  $b$  prerjen. Regresi linear me shumë variabla është një vazhdim i regresit të thjeshtë linear, i cili mundëson parashikimin e vlerave të një variabli target duke u bazuar jo në një por në disa variabla inputues [26]. Zakonisht marrëdhënia mes 2 variablave  $x$  dhe  $y$  nuk mund të përafrohet me një kurbë lineare të drejtë. Në raste si këto përdoret teknika e regresit jo linear e cila në thelb ka një ekuacion më të komplikuar për të përcaktuar funksionin që lidh  $y$  me  $x$ . Ndërsa regresi jo linear me shumë variabla i referohet regresit jo linear kur

kemi më shumë se sa një variabël të pavarur që ndikon në parashikim ( $x_1, x_2, \dots, x_n$ ). Në raste si këto lidhja jo lineare nuk mund të paraqitet në një hapësirë dy dimensionale. Fatkeqësisht, të dhëna të shumta nga jeta reale nuk janë të thjeshta të parashikohen, si shembull përmendim volumin e shitjeve, çmimet e stokut ose % e dështimit të produkteve, kjo për faktin se mund të varen nga lidhjet komplekse mes variablave të ndryshëm parashikues. Në rastet me kompleksitet të kësaj natyre përdoren teknika si: regresi logjistik, pema e marrjes së vendimeve ose rrjetat neurale. Pra të njëjtat teknika mund të përdoren edhe për modelet data mining të tipit regres dhe për ato që bazohen në klasifikim. Algoritmi CART (Classification and Regression Trees) mund të përdoret për të ndërtuar pema klasifikimi që kanë për qëllim klasifikimin e variablave target të tipit kategorik por njëkohësisht dhe për ndërtimin e regreseve që të bëjnë parashikimin e variablave target të tipit të vazhdueshëm. Edhe rrjetat neurale mund të përdoren për ndërtimin e modeleve të të dy llojeve, ato të klasifikimit dhe regresit.

### 3.3.3 Seritë kohore

Seri kohore quhet bashkësia e të dhënave të grumbulluara nga observime të bëra në mënyrë sequenciale në një afat të caktuar kohor. Në çdo moment në kohë mund të monitorohen matjet për një ose disa variabla që mund të jenë subjekte të studimit. Seria kohore rezultat quhet univariate ose multivariate në varësi të variablave të inkuorporuar. Qëllimet kryesore të përdorimit të metodave të serive kohore janë: indeksimi, ndarja në klasa, klasifikimi, gjetja e risive si dhe gjetja e rregullave. Më poshtë jepet një përshkrim i përgjithshëm për secilin prej tyre [27].

*Indeksimi:* Gjetja e serive kohore më të ngjashme në një bazë të dhënash.

*Ndarja në klasa:* Gjetja e grupeve të serive kohore në një dataset në mënyrë të tillë që seritë kohore të një grupi të jenë të ngjashme në karakteristika me njëra tjetrën dhe të ndryshme nga ato të një grupi tjetër.

*Klasifikimi:* Etiketimi i një grupi serish kohore në mënyrë të tillë që të jetë më i ngjashëm me seritë kohore të të njëjtit grup se sa me ato të serive kohore në grupet e tjera.

*Gjetja e risive:* Proçesi i gjetjes së seksioneve brënda një serie kohore që shfaqin sjellje të ndryshme ose të reja nga ato të përgjithshmet që mund të evidentohen nga një model bazë.

*Zbulimi motivit:* Zbulimi i sjelljeve të përsëritura dhe të panjohura më parë në një bazë të dhënash të serive kohore.

*Zbulimi i rregullave:* Gjetja e rregullave që mund të përshkruajnë sjellje të mundshme në një moment specifik në kohë, nga një ose më shumë seri kohore.

Kjo metodë DM është mjaft komplekse dhe problematikat kryesore vijnë nga dimensionet e mëdha të serive kohore si dhe nga vështirësia për të definuar një formë matjeje të ngjashmërisë.

### 3.3.4 Identifikimi i anomalive të të dhënave

Vlera e një atributi të caktuar në një bazë të dhënash do të quhet një outlier nëse ajo ka një devijim të konsiderueshëm nga sjella e rregullt ose vlerat më të zakonshme që gjenden në dataset për këtë atribut. Proçesi i identifikimit të këtyre objekteve në fazat e para të analizës së

të dhënave është shumë i rëndësishëm, në mënyrë që në vazhdim të vendoset edhe mënyra se si këto objekte do të merren në konsideratë ose jo gjatë modelimeve.

Proçesi i identifikimit të anomalive është proçesi i gjetjes së vlerave outlier në një set observimesh. Ky proçes sa vjen dhe kthehet në hallkë të një rëndësie të lartë në tërë zinxhirin e modelimit të të dhënave, duke qenë se sasia e të dhënave është në rritje. Identifikimi i këtyre anomalive mund të jetë tregues i një aksesit të paautorizuar në një sistem, një vjedhje në një kartë krediti ose diagnostikimin e një sëmundjeje. Anomalitë ose parregullsitë në të dhëna mund të jenë të tipit kontekstuale ose kolektive. Anomalitë e tipit kontekstual janë ato ku rekorde të veçantë të set-it të të dhënave devijojnë nga pjesa tjetër e tyre. Ky është edhe modeli më i thjeshtë dhe që përdoret nga shumica e algoritmeve ekzistues. Anomalitë kontekstuale janë ato ku rekordi ka sjellje dhe attribute kontekstual. Të njëjtët attribute mund të konsiderohen normal për një kontekst dhe jo normal për një kontekst tjetër. Ndërsa anomalitë kolektive janë ato ku një grup rekordesh të ngjashëm mes tyre devijojnë nga pjesa tjetër e datasetit. Kjo mund të ndodhë vetëm në set të dhënash ku rekordet janë të lidhur mes tyre. Ndërkaq anomalitë kontekstuale mund të konvertohen në vlera fikse duke i agreguar ato sipas kontekstit.

Kategoritë kryesore të realizimit të procesit të identifikimit të anomalive në bazat e të dhënave grupohen sipas natyrës, në ato të bazuara në klasifikim, ato të bazuar në vlerat e observimeve më të afërta (nearest-neighbor), ato që bazohen në ndarjen në klasa si dhe kategoritë e bazuara në analiza statistikore. Algoritmet e bazuar në klasifikim quhen ndryshe algoritme të mbikqyrur dhe pretendojnë se dallimi mes vlerave jo normale dhe normale mund të bëhet për një pjesë të caktuar të atributit. Algoritmet nearest-neighbor pretendojnë që anomalitë janë të shpërndara në dataset dhe larg vlerave më të afërta të një observimi. Këto algoritme quhen ndryshe algoritme të pa survejuar. Ato të bazuar në ndarjen e observimeve në klasa funksionojnë duke grupuar rekorde të ngjashme në klasa dhe duke pretenduar që anomalitë nuk do jenë pjesë e së njëjtës klasë ose do ndodhen larg qendrave të klasave, ose që u përkasin klasave më të vogla dhe më të shpërndara. Ndërsa algoritmet e bazuar në analizat statistikore i detektojnë anomalitë duke i parë ato të devijuara nga modeli klasik.

Metodat e përmendura më lart të detektimit të anomalive janë mjaft të përdorura për gjetjen e transaksioneve të dyshimta që mund të lidhen me mashtrime në institucione financiare.

### **3.4 Teknikat data mining që përdoren në sistemet e inteligjencës së biznesit BI**

BI (Business Intelligence) i referohet një set-i mjetesh ose programesh që përdoren për analiza multidimensionale të bazës së të dhënave, me qëllim lehtësimin e marrjes së vendimeve në biznes. Një prej komponenteve më të rëndësishëm në BI është OLAP. Baza e OLAP është data kubi, që përbën një model multidimensional të bazës së të dhënave, ky i fundit i kombinuar me teknika të ndryshme ka shfaqur një performancë shumë të lartë në shpejtësinë e analizës dhe përpunimit të sasive të mëdha të të dhënave.

Implementime të ndryshme të OLAP janë ROLAP, MOLAP dhe HOLAP të cilët kanë karakteristika dalluese nga njëri tjetri në lidhje me performancën dhe saktësinë. Në krahasime dhe simulime të ndryshme të teknologjisë ROLAP që bazohet në ekzekutimin e disa kërkesave në një depositor të madh të dhënash me HOLAP që përdor kubat inteligjent, kjo e fundit spikat në performancën totale të sistemit, koha e përgjigjes reduktohet në mënyrë të ndjeshme. Gjithashtu zënë një hapësirë më të vogël të memories për sa kohë kubat ruhen në server. Benefit tjetër i kësaj teknologjie është gjithashtu dhe rritja e efijencës dhe performancës në raportistikë.

Konkludojmë duke nënvizuar faktin që OLAP është një mjet i fuqishëm në ekstraktimin e të dhënave nga sistemet BI duke performuar mirë në kohë dhe në performancë në ekzekutimin e kërkesave në datase të shumë të mëdha [18]. Kjo teknologji e pajis përdoruesin me një informacion multidimensional duke e bërë raportimin një proces më fleksibël dhe më eficient, pavarësisht se për organizata më të vogla me sasi të kufizuara të dhënash, kapacitetet e kësaj teknologjie mund të jenë të tepërta, pra aplikimi i tyre është i përshtatshëm dhe më i frytshëm në sasi shumë të mëdha të dhënash. Aplikimet OLAP janë mjaft të përdorura nga teknikat e Data Mining. Në bazat e të dhënave OLAP janë ruajtura dhe agreguara të dhëna historike, në formën e skemave multi-dimensionale (kryesisht të tipit yll). Skemat yll në datase të mëdha rrisin performancën si rezultat i numrit të vogël të lidhjeve që duhet të bëjnë për të marrë një raport. Punime të ndryshme të mëtejshme në këtë fushë provuan se ishte e një interesi dhe përfitueshmërie të veçantë kombinimi i këtyre teknologjive bashkë OLAP dhe data mining duke krijuar kështu një degëzim të ri të quajtur Online Analytical Mining (OLAM). Termi OLAM u prezantua si fillim nga Han dhe u analizua më tej nga HAN, Chee and Chinag. Qëllimi i integritimit të OLAP me data mining ishte cilësia e mirë e bazës së të dhënave në depozitorët e mëdhenj të të dhënave, infrastruktura në përpunim që ofron një data ëarehouse, analizat në eksplorim që ofron OLAP si dhe selektimi on-line i funksioneve të ndryshme data mining. Një arkitekturë që integron OLAP dhe OLAM është propozuar në këtë studim.




Figura 3-2 Arkitektura OLAM

Hua [29] propozoi dhe zhvilloi një integrim interesant mes teknologjisë OLAP dhe teknikës së asociimit në data mining që çoi në krijimin e një rregulli asociimi në mining shumë fleksibël dhe multidimensional. Dzeroski [30] kombinoi OLAP dhe data mining në një mënyrë tjetër me qëllim zbulimin e sjelljeve të ndryshme në një databazë pacientësh. Ai përdori teknikën e ndarjes në klasa si dhe atë të pemës së vendimeve.



### 3.5 Hapat e DATA-MINING

#### 3.5.1 Cilësia e të dhënave

Të dhënat kanë kualitet nëse përmbushin kërkesat e paravendosura për përdorimin e tyre. Ka shumë faktorë që ndikojnë në cilësinë e të dhënave, përfshirë saktësinë, plotësinë, konsistencën, koherencën, besueshmërinë dhe interpretueshmëria. Marrim rastin se kemi një menaxher dege në Coin dhe është ngarkuar me analizimin e të dhënave të kompanisë, duke u nisur nga shitjet e degës që kanë në ngarkim. Që në momentin e parë do të analizonte bazën e të dhënave dhe magazinën e të dhënave dhe do të zgjidhte atributet apo dimensionet (psh. artikull, cmim dhe njësi të shitura) që do të përfshihen në analizën e tij. Do të vërë re se një pjesë e attributeve për të dhëna të ndryshme, nuk kanë vlerë të regjistruar. Për analizën e tij, do të donte të përfshinte informacionin nëse të gjithë artikujt e shitur janë marketuar dhe etiketuar si “në shitje” por ky informacion nuk është regjistruar. Për më tepër, përdoruesit e bazës së të dhënave kanë raportuar gabime, vlera te pazakonta dhe inkonsistenca në të dhënat e regjistruara për disa transaksione. Në fjalë të tjera, të dhënat që do të analizojë me teknikat e data mining janë të paplota (mungojnë vlera te attributeve ose mungojnë attribute që i interesojnë, ose përmbajnë vetëm vlera të agreguara); të pasakta ose me zhurma (përmbajnë gabime ose vlera që devijojnë nga pritshmëria); dhe të paqëndrueshme (përmbajnë mos përputhje në kodet e departamenteve që përdoren për kategorizimin e artikujve).

Ky skenar ilustron tre elementë që përcaktojnë cilësinë e të dhënave: saktësia, plotësia dhe konsistenca. Të dhënat e pasakta, të paplota dhe të paqëndrueshme janë vecori të zakonshme të bazave të mëdha të të dhënave apo magazinave të mëdha të të dhënave. Ka shumë arsye të mundshme për pasaktësinë e të dhënave (psh. të pasurit e attributeve të gabuara). Instrumentat që përdoren për mbledhjen e të dhënave mund të jenë të gabuar. Mund të kenë ndodhur gabime njerëzore apo procesimi në hedhjen e të dhënave. Përdoruesit mund të vendosin qëllimisht të dhëna të gabuara për fusha të detyrueshme, kur nuk duan të përfshijnë informacion personal (psh duke vendosur një datë cfarëdo në vend të ditës së lindjes apo një adresë te pasaktë). Ky fenomen njihet si fshehje e qëllimshme e informacionit. Mund të ndodhin edhe gabime në transmetimin e të dhënave. Mund të ketë limitime të teknologjisë si hapë sirë e limituar e bufferit, që shërben për koordinimin dhe sinkronizimin e transmetimit të të dhënave. Gjithashtu, mund të kemi të dhëna të pasakta nga përdorimi i konvencioneve të ndryshme në emertim apo kodim për të njëjtat të dhëna ose nga përdorimi i formateve të gabuara për fushat (psh numër aty ku pritet datë). Një tjetër fenomen mund të jetë duplikimi i të dhënave, i cili ka nevojë për pastrim.

Të dhënat e paplota mund të ndodhin për një sërë arsyesh. Atributet e interesit mund të mos jenë disponibël në çdo kohë, si rasti i kodit të klientit në transaksionet e shitjes. Të dhënat e tjera nuk përshihen pasi nuk janë konsideruar të rëndësishme në momentin e hedhjes. Të dhëna të tjera të rëndësishme mund të mungojnë për shkak të keqkuptimeve apo keqfunksionimeve të pajisjeve. Përdoruesit mund të kenë fshirë të dhëna që kanë qënë jo konsistente me të dhënat e tjera të regjistruara. Për më tepër, regjistrimi i logeve për ndryshimet e të dhënave mund të mos jetë aktivizuar. Mungesa e të dhënave, veçanërisht për të dhënat që kanë mungesa për disa attribute mund të ketë nevojë të përcaktohet.

Duhet marrë parasysh se cilësia e të dhënave varet nga qëllimi i përdorimit të tyre. Dy përdorues të ndryshëm mund të kenë dy vlerësime të ndryshme për cilësinë e një baze të dhënash. Për shëmbull, një analist marketingu mund të dojë të aksesojë bazën e të dhënave që analizuam më sipër për të marrë adresat e klientëve. Disa nga adresat mund të jenë të pasakta

apo të vjetra por në total, rreth 80% e tyre janë të sakta. Analisti i marketingut është i kënaqur me cilësinë e të dhënave të cilat do ti përdorë për marketing të targetuar, pavarësisht se menaxheri i shitjeve që morrëm në shqyrtim më sipër i konsideron të dhënat e pasakta.

Koherenca afekton, gjithashtu cilësinë e të dhënave. Supozojmë se menaxheri i shitjeve po kontrollon shpërndarjen e bonuseve mbi shitjet për asistentët më të suksesshëm në shitjen e Coin. Një problem mund të jetë se disa asistentë në shitje nuk i deklarojnë shitjet e tyre në kohë në fund të muajit. Gjithashtu, mund të aplikohen saktësime dhe sisteme pas përfundimit të muajit. Për një periudhë kohe pas çdo fund-muaji, të dhënat e ruajtura në bazën e të dhënave janë te paplota. Megjithatë, kur të gjithë të dhënat hidhen në bazën e të dhënave, ato bëhen korrekte. Fakti që të dhënat e fund-muajit nuk hidhen në kohe reale, ka një impakt negativ në cilësinë e të dhënave.

Dy faktorë të tjerë që ndikojnë në cilësinë e të dhënave janë besueshmëria dhe interpretueshmëria. Besueshmëria reflekton se sa besohen të dhënat nga përdoruesit, ndërsa interpretueshmëria reflekton se sa e vështirë është të kuptohen të dhënat. Supozojmë se një bazë të dhënash në një moment të caktuar, ka disa gabime por që janë korrigjuar më vonë. Megjithatë, të dhënat e gabuara u kanë shkaktuar shumë probleme përdoruesve të departamentit të shitjeve dhe si rrjedhim ata nuk i besojnë më të dhënat. Të dhënat gjithashtu përdorin shumë kode kontabiliteti, të cilat departamenti i shitjeve nuk di si ti interpretojë. Edhe pse baza e të dhënave, tashmë është e saktë, konsistente dhe koherente, përdoruesit e departamentit të shitjeve mund ta cilësojnë atë me cilësi të ulët për shkak të besueshmërisë së ulët dhe interpretueshmërisë së dobët.

### 3.5.2 Hapat kryesore për paraproçesimin e të dhënave

Në këtë paragraf do të shohim hapat kryesore të procesit të paraproçesimit të të dhënave, përkatësisht: pastrimi i të dhënave, integrimi i të dhënave, reduktimi i të dhënave dhe transformimi i të dhënave [31].

Pastrimi i të dhënave konsiston në punën që kryhet për pastrimin e të dhënave duke vendosur të dhënat që mungojnë, sistemimit të të dhënave të paqarta, identifikimi dhe heqja e anomalive dhe zgjidhja e paqëndrueshmërisë së të dhënave. Nëse përdoruesit besojnë se të dhënat janë të papastra, ata nuk do ti besojnë rezultatet e proceseve të data mining që janë aplikuar në to. Për më tepër, të dhënat e papastra mund të shkaktojnë konfuzion për procedurën e data mining, duke rezultuar në të dhëna në dalje të cilat janë jo të besueshme. Pavarësisht se shumica e proceseve DM kanë procedurë për të trajtuar të dhënat e paplota apo të paqarta, ato nuk janë gjithmonë robuste. Përkundrazi këto procedurë mund të përqendrohen në mënjanimin e vendosjes së të dhënave në funksionin që po modelohet. Si rrjedhim, një hap preprocesimi i nevojshëm është kalimi i të dhënave në disa procedurë pastrimi.

Duke ju rikthyer shëmbullit të Coin më sipër, në të cilin përfshihen të dhëna nga burime të ndryshme në analizën tonë, do të na duhet të integrojmë shumë baza të dhënash, kuba të dhënash ose skedarë. Megjithatë, disa attribute që përfaqësojnë një koncept të caktuar mund të kenë emra të ndryshëm në baza të ndryshme të dhënash duke na shkaktuar paqëndrueshmëri apo teprica. Për shëmbull, një atribut për identifikimin e klientit mund të referohet si “*client*” në bazën e të dhënave të sistemit CRM dhe si “*codclient*” në bazën e të dhënave të sistemit POS. Mund të kemi paqëndrueshmëri në emërtim dhe në vlerat e attributeve. Përshembull, i njëjti emër mund të regjistrohët si Genti në një bazë të dhënash, Gent në një tjetër dhe G në një të tretë. Gjithashtu disa të dhëna mund të vijjnë si rrjedhojë e të dhënave të tjera (psh stoku

mujor). Të pasurit e një sasive të madhe të dhënash të tepërta mund të ngadalesojë ose konfuzojë procesin e zbulimit të njohurive (KDD). Qartësisht, përveç pastrimit të të dhënave duhet të merren masa për parandalimin e tepricave gjatë integritit të të dhënave. Zakonisht pastrimi dhe integrimi i të dhënave janë një hap preprocesimi gjatë përgatitjes të të dhënave për tu kaluar në magazinën e të dhënave. Një proces suplementar i pastrimit të të dhënave mund të kryhet për të hequr tepricat që rezultojnë nga integrimi i të dhënave.

Një tjetër faktor që duhet marrë parasysh është sasia e të dhënave. Nëse sasia e të dhënave është shumë e madhe atëherë procesi i data mining mund të ngadalësohet. Duhet të gjejmë një mënyrë për të reduktuar sasinë e të dhënave pa rrezikuar rezultatin e teknikave DM.

Reduktimi i të dhënave na jep një prezantim më të reduktuar të setit të të dhënave që është më i vogël në volum, por përsëri prodhon të njëjtin (pothuajse të njëjtin) rezultat analitik. Teknikat e reduktimit të të dhënave përfshijnë reduktimin e dimensioneve dhe reduktimin e numerik.

Në teknikën e reduktimit të dimensioneve, aplikohen skema enkodimi të të dhënave për të marrë një version të reduktuar apo të kompresuar të të dhënave fillestare. Një shëmbull do të ishte transformimet wavelet dhe analiza e komponenteve principale, zgjedhja e nënseteve të attributeve (psh heqja e attributeve të panevojshëm), dhe ndërtimi i attributeve ku një set më i vogël dhe më i dobishëm i attributeve derivohet nga seti original [31].


Në reduktimin numerik, të dhënat zëvendësohen nga prezantime më të vogla duke përdorur modelet parametrike (psh modeli i regresit dhe modeli log linear) ose modele jo parametrike (psh. histogramat, klasterat, kampionimi apo agregimi i të dhënave). Nëse marrim në konsideratë shëmbullin më sipër dhe duam të përdorim një algoritëm DM të bazuar te distanca siç janë: rrjetat neurale, klasifikuesit sipas fqinjët më të afërt apo Klastering. Këto algoritma na japin rezultate më të mira nëse të dhënat që do të analizohen normalizohen, që do të thotë përshkallëzohen në diapazone më të vegjël si [0. 0. 1. 0]. Marrim në konsideratë një klient për të cilin ruajmë 2 të dhëna: moshën dhe vlerën totale të blerjeve vjetore. Në përgjithësi vlera e ruajtur e blerjeve vjetore do të jetë më e madhe se vlera e ruajtur në fushën e moshës. Rrjedhimisht, nëse atributet nuk normalizohen, matjet e distancës që do të kryhen në fushën e blerjeve vjetore, përgjithësisht, do të kenë peshë më të madhe se matjet e distancës në fushën e moshës. Në rastet kur vlerat e të dhënave për atributet zëvendësohen nga diapazone ose nivele konceptuale, është e nevojshme teknika e diskretizimit ose gjenerimi i hierarkisë konceptuale. Për shembull, vlerat e vendosura në fushën e moshës mund të zëvendësohen me koncepte të nivelit më të lartë si "adoleshent", "i ri", "i moshuar".

Konceptet e diskretizimit dhe të gjenerimit të hierarkisë janë mjete të fuqishme për data mining pasi lejojnë Data Mining në nivele të shumta abstragimi. Normalizimi, diskretizimi i të dhënave dhe gjenerimi i hierarkisë së koncepteve janë forma të ndryshme të transformimit të të dhënave. Duhet të kuptojmë se këto operacione të transformimit të të dhënave bëjnë pjesë të procedurat e paraprocesimit të të dhënave të cilat kontribuojnë në suksesin e proceseve DM.

Figura 3.5 paraqet një përmbledhje të hapave të paraprocesimit të të dhënave të shpjeguara më sipër. Duhet të theksojmë se kategorizimi i mësipërm nuk është ekskluziv. Përshembull, heqja e tepricave të të dhënave, mund të shihet si një formë e pastrimit të të dhënave por edhe si një formë e reduktimit të të dhënave [31].

Si përfundim, të dhënat reale, përgjithësisht janë të papastra, të paplota dhe të paqëndrueshme. Teknikat e paraprocesimit të të dhënave mund të rrisin cilësinë e të dhënave dhe në këtë mënyrë ndihmojnë në rritjen e saktësisë dhe efikasitetit të proceseve DM në vazhdim. Paraprocesimi i

të dhënave është një hap i rëndësishëm në procesin KDD, pasi vendimet cilësore duhet të bazohen në të dhëna cilësore. Detektimi i anomalive të të dhënave, sistemimi i tyre shpejt dhe reduktimi i të dhënave që duhet të analizohen mund të sjellin shumë avantazhe në procesin e vendimmarrjes.



**Tranformimi i të dhënave**

-2, 32, 100, 59, 48      →      -0.02, 0.32, 1.00, 0.59, 0.48

**Reduktimi i të dhënave**




Figura 3-3 Hapat e paraproçesimit të të dhënave

### 3.6 Konkluzione

Ne këtë kapitull u krye një studim i teknikave të Data Mining (DM). Fillimisht u krye një analizë e modeleve kryesore të DM, përkatesisht: modelit përshkrues dhe modelit parashikues. Algoritmat kryesore të secilit model u listuan dhe analizuan. Gjithashtu u shpjegua sesi kryhet integrimi i DM me sistemet e inteligjencës në biznes dhe statusi aktual i këtyre integrimeve. Së fundmi hapat kryesorë që duhet të ndërmerren gjatë implementimit të DM me fokus në paraproçesimin e të dhënave u shpjeguan dhe analizuan. Rëndësia kritike e këtij hapi u ilustrua dhe shpjegua.

## KAPITULLI 4

### 4. TEKNIKAT DM TË MARRA NË SHQYRTIM

#### 4.1 Metoda e Ndarjes/Particionimit në Klastera

Versioni më i thjeshtë dhe më themelor i analizës së klaster-ave është ndarja, e cila organizon objektet e një grupi në disa grupe specifike. Për të mbajtur sa më të saktë specifikimin e problemit, mund të supozojmë se numri i klastera-ve është dhënë si një element i njohur. Ky parametër është pikënisja fillestare për metodat e ndarjes. Duke pasur parasysh një grup të dhënash  $D$ , të  $n$  objekteve dhe  $k$  numrin e klasterave për t'u formuar, algoritmi i ndarjes organizon objektet në  $k$  particione ( $k \leq n$ ), ku secila ndarje paraqet një klaster.

Grupimet formohen për të optimizuar një ndarje me një kriter sa më objektiv, të tillë si një funksion i pangjashmërisë bazuar në distancë, kështu që objektet brenda një grupimi mund të jenë "të ngjashme" me njëra-tjetrën dhe "jo të ngjashme" me objektet në grupe të tjera për sa i përket termave të attributeve të bashkësisë së të dhënave.

Në këtë seksion do të trajtohet si metoda  $k$ -means (në seksionin 4.1.1) dhe  $k$ -medoids (në seksionin 4.1.2). Ne gjithashtu do të shpjegojmë disa variacione të këtyre ndarjeve dhe se si ato mund të shkallëzohen për të trajtuar grupe të mëdha të të dhënave.

##### 4.1.1 Algoritmi K-Means

Supozojmë se kemi një grup të të dhënave të cilën e shënojmë me  $D$ , i cili përmban  $n$  objekte në hapësirën euklidiane. Metodat e ndarjes shpërndajnë objektet në  $D$  në  $k$  klastera, nga  $C_1$  deri në  $C_k$ , për çdo  $C_i$  që përfshihet në  $D$  dhe prerja e  $C_j$  me  $D$  jep një bashkësi boshe. Një funksion objektiv përdoret për të vlerësuar cilësinë e ndarjes në mënyrë që objektet brenda një klasteri janë të ngjashëm me njëri-tjetrin por jo të ngjashëm me objektet në klastera të tjera. Ky funksion objektiv synon ngjashmëri të lartë në tipologjitë intra-klaster dhe ngjashmëri më të ulët në tipologjitë inter-klaster [32].

Një teknikë ndarëse e bazuar në centroid përdor centroidin e një grupi, për të përfaqësuar atë klaster. Për ta kuptuar, centroidi i një klasteri është pika e tij qendrore. Centroidi mundet të përcaktohet në mënyra të ndryshme si p.sh. nga mesatarja ose medoidi i objekteve (ose pointerave) të caktuar në grup. Distanca midis një objekti  $p \in C_i$  dhe  $c_i$ , përfaqësuesit të klaster-it, matet me  $\text{dist}(p, c_i)$ , ku  $\text{dist}(x, y)$  është distanca euklidiane midis dy pikave  $x$  dhe  $y$ . Cilësia e klasterit  $C_i$  mund të matet me variacionin, e cila është shuma e gabimit në katror midis të gjitha objekteve në  $C_i$  dhe centroidit  $c_i$ , e përcaktuar si:

$$E = \sum_{i=1}^k \sum_{p \in C_i} \text{dist}(p, c_i)^2 \quad (4-1)$$

ku  $E$  është shuma e gabimit në katror për të gjitha objektet në grupin e të dhënave;  $p$  është pika në hapësirë që përfaqëson një objekt të caktuar; dhe  $c_i$  është centroidi i klasterit  $C_i$  ( $p$  dhe  $c_i$  janë shumëdimensionale). Domethënë, për secilin objekt në secilin klaster, distanca nga objekti me qendrën e grupit (klasterit) ngrihen në katror dhe distancat mblidhen.

Ky funksion objektiv përpiqet të bëjë që k-klasterat që rezultojnë, të jenë sa më kompakte dhe sa më të ndara. Optimizimi i variacionit brenda klasterit është sfidues nga pikëpamja kompjuterike. Në rastin më të keq, do të na duhet të numërojmë një numër ndarjesh të mundshme që janë eksponenciale në lidhje me numrin e grupeve.

Nëse numri i klasterave  $k$  dhe dimensionin e hapësirës arrijnë të fiksohen, problemi mund të zgjidhet në kohën  $O(n^{dk+1} + \log n)$ , ku  $n$  është numri i objekteve. Për të kapërcyer koston frenuese të llogaritjes për zgjidhjen e saktë, qasje të ndryshme shpesh përdoren në praktikë. Një shembull kryesor është algoritmi k-means, i cili është i thjeshtë dhe është i përdorshëm në ditët e sotme.

"Si funksionon algoritmi k-means?" Algoritmi k-means përcakton centroidin e një klasteri si vlerë mesatare të pikave brenda klasterit. Së pari, zgjedh rastësisht  $k$  nga objektet në  $D$ , secili prej të cilëve fillimisht përfaqëson një mesatare të klasterit. Secili nga objektet e mbetura, i caktohet klaster-it në të cilin është më afër, bazuar në distancën euklidiane midis objektit dhe qendrës së klasterit. Ky algoritëm përmirëson në mënyrë iterative ndryshimin brenda klasterit. Për secilin klaster, ai llogarit mesataren e re duke përdorur objektet e caktuara në klasterin në iteracionet e mëparshme. Përsëritjet vazhdojnë derisa caktimi të jetë i qëndrueshëm, domethënë klasterat e formuara në raundin aktual janë të njëjta me ato të formuara në raundin e mëparshëm. Metoda k-means është përmbledhur në figurën 4.1 [32].




Figura 4-1 Klasterizimi i një seti objektësh që përdorin algoritmin k-means; (b) azhurnimi e qendrave të klasterave dhe rivendosja e objekteve në përputhje me gjendjet (mesatarja e secilit klaster shënohet me +).

**Algoritmi:  $k$ -means:** Algoritmi  $k$ -means, është algoritmi i ndarjes ku çdo qendër e klasterave përfaqësohet nga vlera mesatare e objekteve në klaster.

**Input:**

- $k$ : numri i klasterave,
- $D$ : seti i të dhënave i cili përmban  $n$  objekte.

**Output:** Një set me  $k$ -klastera.

**Metoda:**

- (1) në mënyrë arbitrare zgjidhen  $k$  objekte nga  $D$  si qendrat fillestare të klasterave;
- (2) përsëritet;
- (3) (ri)caktimi i secilit objekt në klasterin me të cilin objekti është më i ngjashëm, bazuar në vlerën mesatare të objekteve në grup;
- (4) update-im i klaster-means, përlogaritja e vlerës të objektit për secilin klaster
- (5) derisa të mos ndryshojë;

Ilustrojmë me shembullim në vijim. Proçesi i klasterizimit me anë të algoritmit  $k$ -means. Konsiderojmë një grup objektesh të vendosura në hapësirë 2-D, siç përshkruhet në Figurën 4.1 (a). Le të jetë  $k=3$ , domethënë, përdoruesi do të dëshironte që objektet të ishin të ndara në tre grupe. Bazuar në algoritmin e sipërmendur, zgjedhim në mënyrë arbitrare tre objekte si tre qendrat fillestare të klasterave, ku qendrat e grupeve shënohen nga një C. Secili objekt i është caktuar një grupi bazuar në qendrën e grupeve në të cilën është më e afërta.

Qendrat e grupeve azhurnohen. Kjo është, vlera mesatare e secilës klaster ku është rillogaritur dhe bazuar në objektet aktuale në set. Duke përdorur qendrat e reja të klasterave, objektet rishpërndahen në grupe bazuar te qendra më e afërt e grupeve. Një rishpërndarje e tillë formon silueta të reja të rrethuara nga kthesa të ndërprera, siç tregohet në Figura 4.1(b). Ky proçes përsëritet, duke çuar në figurën 4.1(c). Caktimi i proçeseve iterative për objektet e grupeve është për të përmirësuar ndarjen. Proçesi vazhdon derisa nuk ndodh asnjë rivendosje e objekteve në ndonjë klaster.

Rezultatet e algoritmit  $k$ -means mund të varen nga zgjedhja fillestare e rastësishme të qendrave të klasterave. Për të marrë rezultate të mira në praktikë, është e rekomandueshme të ekzekutohet shumë herë me qendra të ndryshme fillestare të klasterave [32].

Kompleksiteti kohor i algoritmit  $k$ -means është  $O(nkt)$ , ku  $n$  është numri i përgjithshëm i objekteve,  $k$  është numri i grupeve, dhe  $t$  është numri i përsëritjeve. Normalisht,  $k \ll n$  dhe  $t \ll n$ . Prandaj, metoda është relativisht e shkallëzuar dhe efikase në përpunimin e të dhënave të mëdha (big data). Ekzistojnë shumë variante të algoritmit  $k$ -means. Këto mund të ndryshojnë në përzgjedhjen dhe inicializimin e  $k$  dhe strategjitë për llogaritjen e klasterit.



Algoritmi k-means mund të zbatohet vetëm kur përcaktohet mesatarja e një grupi objektsh. Ky mund të mos jetë rasti në disa aplikime si p.sh. kur të dhëna me attribute nominale janë përfshirë. Algoritmi k-modes është një variant i k-means. Ky algoritëm përdor masa të reja të ngjashmërisë për t'u marrë me objektet nominale dhe një metodë e bazuar në frekuencë për të azhurnuar mënyrat e grupeve. Algoritmat k-means dhe k-modes mund të integrohen për të grumbulluar të dhëna me vlera të përziera numerike dhe nominale. Nevoja që përdoruesit të specifikojnë k, numrin e grupeve, paraprakisht mund të shihet si një disavantazh. Ka pasur studime se si të kapërcehet kjo vështirësi, të tilla si duke siguruar një gamë të përafërt të vlerave k dhe pastaj duke përdorur një teknikë analitike për të përcaktuar k-në më të mire, duke krahasuar rezultatet e klasterizimit të marra për vlerat k-të e ndryshme. Në studimin tonë do të përdorim metodën e bërrylit (Elbows) në të cilën ndërtojmë një grafik të gabimit në katror kundrejt numrit të klasterave. Në pikën ku kemi thyerjen e grafikut (berrylin) mund të themi se kemi numrin optimal të klasterave. Metoda k-means është e ndjeshme ndaj zhurmës dhe të dhënave të jashtme sepse një numër i vogël i të dhënave të tilla mund të ndikojnë thelbësisht në vlerën mesatare.

Një qasje për të bërë metodën k-means më efikase në grupe të mëdha të të dhënave është përdorimi i një grupi me të madh të elementetëve në klaster. Një qasje tjetër, është ideja e mikroklasterit, e cila së pari grupon objektet afër në "mikroklastera" dhe më pas kryhet klasterizimi nëpërmjet algoritmit.

#### 4.1.2 Algoritmi k-Medoids

Algoritmi k-means është një algoritëm i ndjeshëm ndaj skajeve, sepse objektet që janë shumë larg nga shumica e të dhënave, kur i caktohen një klasteri, mund të ndryshojnë në mënyrë drastike vlerën mesatare të tij. Kjo padashur ndikon në caktimin e objekteve të tjera të grupeve. Ky efekt përkeqësohet veçanërisht për shkak të përdorimit të gabimit në katror në formulën (4.1). Në vijim të punimit ne do të shohim shembullin e mësipërm [32].

"Si mund ta modifikojmë algoritmin k-means për të zvogëluar ndjeshmërinë e tillë ndaj skajeve?" Në vend që të marrim vlerën mesatare të objekteve në një grup si pikë referimi, ne kemi mundësi të zgjedhim objektet aktuale për të përfaqësuar klasterat, duke përdorur një objekt përfaqësues për secilin klaster. Metoda e ndarjes kryhet më pas bazuar në parimin e minimizimit të shumës së dallimeve midis secilit objekt p dhe objektit përfaqësues. Ky quhet kriteri i gabimit absolut dhe përcaktohet si:

$$E = \sum_{i=1}^k \sum_{p \in C_i} \text{dist}(p, o_i)^2 \quad (4-2)$$

ku E është shuma e gabimit absolut për të gjitha objektet p, dhe  $o_i$  është objekti përfaqësues i  $C_i$ . Kjo është baza e algoritmit K-Medoids, i cili i grupon objektet në klastera duke minimizuar gabimin absolut (Formula 4-2)

Kur  $k=1$ , mund të gjejmë te mesmen e saktë në  $O(n^2)$  (ku kompleksiteti i algoritmit shprehet në kohë). Sidoqoftë, kur k është një numër përgjithshëm pozitiv, problemi k-medoid është i vështirë.

Algoritmi i ndarjes rreth Medoids (PAM) është një realizim i njohur i klasterizimit të k-medoidsave. Ai trajton problemin në një mënyrë përsëritëse. Ashtu si algoritmi i k-means, objektet fillestare përfaqësuese (të njohura ndryshe si seeds) zgjidhen në mënyrë arbitrare. Të gjitha zëvendësimet e mundshme janë provuar. Procesi përsëritës i zëvendësimit të objekteve

përfaqësuese nga objekte të tjera vazhdon derisa cilësia e klasterit që rezulton nuk mund të përmirësohet nga ndonjë zëvendësim. Kjo cilësi matet me një funksion të kostos së pangjashmërisë mesatare midis një objekti dhe objektit përfaqësues të grupit të tij.

Specifikisht le të kemi  $o_1, \dots, o_k$  setin aktual të objekteve (medoid-save). Për të përcaktuar nëse një objekt  $O_{\text{random}}$ , është një zëvendësim i mirë për një medoid  $o_j$  ( $1 < j \leq k$ ), llogarisim distancën nga secili objekt  $p$  në objektin më të afërt në set-in  $\{o_1, \dots, o_{j-1}, O_{\text{random}}, o_{j+1}, \dots, o_k\}$  dhe përdorim distancën për të azhurnuar funksionin e kostos. Rivendosjet e objekteve në  $\{o_1, \dots, o_{j-1}, O_{\text{random}}, o_{j+1}, \dots, o_k\}$  janë të thjeshta. Supozojmë se objekti  $p$  i është caktuar aktualisht një klaster i përfaqësuar nga  $o_j$  medoid (Figura 4.2 a ose b). Nëse  $o_j$  zëvendësohet nga  $O_{\text{random}}$ , objekti  $p$  duhet të caktohet te  $O_{\text{random}}$  ose ndonjë klaster tjetër i përfaqësuar nga  $o_i$  ( $i \neq j$ ), cilado që është më e afërta. Për shëmbull, në Figurën 4.2 (a),  $p$  është më afër  $o_i$  dhe prandaj është rivendosur në  $o_i$ . Në figurën 4.2(b), megjithatë,  $p$  është më afër  $O_{\text{random}}$  dhe kështu është rivendosur në  $O_{\text{random}}$ . [32].

Po nëse, në vend të kësaj,  $p$  i është caktuar aktualisht një klasteri të përfaqësuar nga ndonjë objekt tjetër  $o_i$ , ( $i \neq j$ )?




Figura 4-2 Katër rastet e funksionit të kostos për klasterizimin k-medoids

Dual Lagranzh varet vetëm nga produkti i pikave ndërmjet dy vektorëve në hapësirën e transformuar  $\phi(\mathbf{x}_i)^T \phi(\mathbf{x}_j) = K(\mathbf{x}_i, \mathbf{x}_j)$ , kështu ne mund të zgjidhim problemin e optimizimit duke përdorur matricën e bërthamës  $\mathbf{K} = \{K(\mathbf{x}_i, \mathbf{x}_j)\}$   $i, j = 1, \dots, n$  [33].

## Humbja Kuadratike

Funksioni i humbjes kuadratike është matematikisht më i gjurmueshëm se sa funksionet e tjera të humbjes për shkak të vetive të mospërputhjeve, si dhe faktit që është simetrik: një gabim mbi target shkakton të njëjtën humbje me të njëjtën madhësi gabimi nën target. Nëse objektivi është  $t$ , atëherë një funksion i humbjes kuadratike është  $\lambda(x) = C(t-x)^2$ , për një konstante  $C$ , ku vlera e konstantes nuk bën shumë diferencë dhe mund ta caktojmë edhe 1. Për humbjen kuadratike, dual Lagrangian i korrespondon një ndryshimi në bërthamë. Përcaktojmë një funksion të ri të bërthames  $K_q$ , si më poshtë:

$$K_q(\mathbf{x}_i, \mathbf{x}_j) = \mathbf{x}_i^T \mathbf{x}_j + 1/2C \lambda_{ij} = K(\mathbf{x}_i, \mathbf{x}_j) + 1/2C \delta_{ij}$$

e cila prek vetëm hyrjet diagonale të matricës së bërthamës  $\mathbf{K}$ , si  $\delta_{ij} = 1$ , nëse  $i = j$  dhe në rast të kundërt është  $i = 0$ .

Kështu, funksioni i dual Lagrangian është si më poshtë:

$$\max_{\alpha} L_{dual} = \sum_{i=1}^n \alpha_i - \frac{1}{2} \sum_{i=1}^n \sum_{j=1}^n \alpha_i \alpha_j y_i y_j K_q(\mathbf{x}_i, \mathbf{x}_j) \quad (4.56)$$

Duke respektuar kufizimet që  $\alpha_i \geq 0$ , dhe  $\sum \alpha_i y_i = 0$ .

Optimizimi i mësipërm mund të zgjidhet duke përdorur të njëjtën qasje edhe me funksionin Hinge Humbja, me një ndryshim të thjeshtë të bërthamës [33].

### Vektori i peshës dhe Bias

Peshat dhe bias janë koncepti më i rëndësishëm në rrjetat neurale. Kur inputet transmetohen përmes neuroneve, janë peshat ato që i atashohen inputit dhe i kalohen funksionit final të aktivizimit bashkë me bias.

Ne mund të përcaktojmë në hapësirën e re të përfutur peshën  $\mathbf{w}$  si më poshtë:

$$\mathbf{w} = \sum_{\alpha_i > 0} \alpha_i y_i \phi(\mathbf{x}_i)$$

Duke qënë që  $\mathbf{w}$  përdor direkt  $\phi(\mathbf{x}_i)$ , përgjithësisht është e vështirë të paracaktohet qartësisht peshat  $\mathbf{w}$ , pavarësisht se në vijim do shohim që nuk është edhe shumë e nevojshme përcaktimi i qartë i peshës  $\mathbf{w}$ . Le të shohim se si të llogarisim **bias** duke përdorur operacionet bërthame për hinge humbja. Ajo llogaritet si mesatare mbi support vectors që janë në marzhin, ku  $\mathbf{0} < \alpha_i < C$ , dhe  $\xi_i = \mathbf{0}$ :

$$b = \text{avg}_{0 < \alpha_i < C} \{b_i\} = \text{avg}_{0 < \alpha_i < C} \{y_i - \mathbf{w}^T \phi(\mathbf{x}_i)\}$$

Në humbjen kuadratike, bias është mesatarja mbi të gjithë support vectors me  $\alpha_i > 0$ .

Më tej duke zëvendësuar  $\mathbf{w}$ , përftojme një shprehje të re për  $b_i$  si:

$$\begin{aligned} b_i &= y_i - \sum_{\alpha_j > 0} \alpha_j y_j \phi(\mathbf{x}_j)^T \phi(\mathbf{x}_i) \\ &= y_i - \sum_{\alpha_j > 0} \alpha_j y_j K(\mathbf{x}_j, \mathbf{x}_i) \end{aligned} \quad (4.57)$$

Ku  $b_i$  është një funksion prodhimi i pikave mes dy vektorëve në hapësirën e re të transformuar dhe mund të llogaritet kështu përmes funksionit bërthame në datasetin input.

### Klasifikuesi SVM Bërthame

Ne mund të parashikojmë klasën për një pikë të re  $\mathbf{z}$  si më poshtë:

$$\begin{aligned} \hat{y} &= \text{sign}(\mathbf{w}^T \phi(\mathbf{z}) + b) = \text{sign}\left(\sum_{\alpha_i > 0} \alpha_i y_i \phi(\mathbf{x}_i)^T \phi(\mathbf{z}) + b\right) = \\ &= \text{sign}\left(\sum_{\alpha_i > 0} \alpha_i y_i K(\mathbf{x}_i, \mathbf{z}) + b\right) \end{aligned} \quad (4.58)$$

Sërisht shikojmë që  $y$  përdor vetëm prodhimin e pikave në hapësirën e re të transformuar.

Bazuar në derivativët më lart, shikojmë që për të ndërtuar dhe për të testuar klasifikuesin SVM, pikat e mapuara  $\phi(\mathbf{x}_i)$  nuk nevojiten asnjëherë që të izoloohen. Si zëvendësim të gjitha operacionet mund të mbarten nga funksioni bërthame më poshtë:  $\mathbf{K}(\mathbf{x}_i, \mathbf{x}_j) = \phi(\mathbf{x}_i)^T \phi(\mathbf{x}_j)$ .

Kështu çdo funksion bërthame jo-linear mund të përdoret për të bërë klasifikime jo-lineare në hapësirën input. Shembuj të bërthamave të këtilla jo-lineare janë bërthama polinomiale dhe bërthama gaussiane[33].

#### 4.6 Klasifikuesi i K fqinjëve më të afërt (KNN)

Në këtë seksion do të analizohet një teknikë jo-parametrike, e cila nuk bën supozim rreth funksionit të densitetit të probabilitetit të përbashkët. Metoda përdor në mënyrë direkte kampionet e të dhënave për të vlerësuar densitetin.

Shënojmë me  $\mathbf{D}$  datasetin e trajnuar i cili përfshin  $n$  pikat  $\mathbf{x}_i \in R^d$  dhe me  $\mathbf{D}_i$  shënojmë nënbashkësinë e pikave të  $\mathbf{D}$  të etiketuara me klasën  $c_i$ , ku  $n_i = |\mathbf{D}_i|$ . Për një pikë test  $\mathbf{x} \in R^d$  dhe  $K$ , numri i fqinjëve të tij, shënojmë me  $r$  distancën nga pika  $\mathbf{x}$  në  $K$  fqinjët më të afërt në  $\mathbf{D}$ . Duke marrë në konsideratë hiper-sferën me rreze  $r$  rreth pikës së testimit  $\mathbf{x}$ , si në formulën:

$$B_d(\mathbf{x}, r) = \{\mathbf{x}_i \in \mathbf{D} \mid \|\mathbf{x} - \mathbf{x}_i\| \leq r\}$$

Ku  $\|\mathbf{x} - \mathbf{x}_i\|$  është distanca Euklidiane ndërmjet pikave  $\mathbf{x}$  dhe  $\mathbf{x}_i$ . Supozojmë se  $|B_d(\mathbf{x}, r)| = K$ .

Shënojmë me  $K_i$  numrim e pikave përgjatë  $K$  fqinjëve më të afërt të  $\mathbf{x}$  të etiketuara me klasën  $c_i$ , që plotësojnë relacionin:

$$K_i = \{\mathbf{x}_j \in B_d(\mathbf{x}, r) \mid y_j = c_i\}$$

Densiteti i probabilitetit të kushtëzuar në pikën  $\mathbf{x}$  mund të vlerësohet si fraksioni i pikës ng klasa  $c_i$ , e cila ndodhe brenda hipersferës pjesëtuar në volumnin e saj, si në formulë [33]:

$$\hat{f}(\mathbf{x} | c_i) = \frac{K_i / n_i}{V} = \frac{K_i}{n_i V}$$

Ku  $V = \text{vol}(B_d(\mathbf{x}, r))$  është volumni i hipersferës. Probabiliteti posterior mund të vlerësohet si:

$$P(c_i | \mathbf{x}) = \frac{\hat{f}(\mathbf{x} | c_i) \hat{P}(c_i)}{\sum_{j=1}^k \hat{f}(\mathbf{x} | c_j) \hat{P}(c_j)}$$

Meqënëse  $\hat{P}(c_i) = \frac{n_i}{n}$  përftojme:

$$\hat{f}(x|c_i) \hat{P}(c_i) = \frac{K_i}{n_i V} \cdot \frac{n_i}{n} = \frac{K_i}{nV}$$

Probabiliteti posterior jepet në formulën:

$$P(c_i|x) = \frac{\frac{K_i}{nV}}{\sum_{j=1}^K \frac{K_j}{nV}} = \frac{K_i}{K} \quad (4.59)$$

Klasa e parashikuar për pikën  $\mathbf{x}$  është:

$$\hat{y} = \operatorname{argmax}_{c_i} \{P(c_i|x)\} = \operatorname{argmax}_{c_i} \left\{ \frac{K_i}{K} \right\} = \operatorname{argmax}_{c_i} \{K_i\} \quad (4.60)$$

Meqënëse  $K$  është numër fiks, klasifikuesi KNN parashikon klasën e  $x$  si klasa mazhorance ndërmjet  $K$  fqinjëve më të afërt.

## 4.7 Algoritmi Prophet

Prophet [38] është një model parashikues i cili punon me karakteristikat kryesore të serive kohore të biznesit duke i rregulluar parametrat pa informacion paraprak të modelit [36]. Tre komponente të modelit implementohen: trendi, sezonaliteti dhe ditët festive si në ekuacionin më poshtë:

$$y(t) = g(t) + s(t) + h(t) + \epsilon_t \quad (4.61)$$

ku  $g(t)$  implementon funksionin e trendit si ndryshime jo periodike të vlerave të serive kohore,  $s(t)$  implementon ndryshimet periodike dhe  $h(t)$  implementon efektin e ditëve festive dhe termi i gabimit përfaqson ndryshimet idiosinkratike, zakonisht si një vlerë me një shpërndarje normale [37].

Parashikimi konsiderohet si një problem përshtatjes së kurbës duke marrë parasysh strukturën e varësisë kohore të të dhënave. Sistemi është fleksibël, çka do të thotë që periudha të shumta të sezonalitetit përfshihen lehtësisht, matjet nuk kanë nevojë të behen rregullisht, aplikimi është shumë i shpejtë dhe përdoruesit mund të manipulojnë në mënyrë interaktive shumë parametra të modelit ose të përfshijnë komponentë të rinj [36]

### 4.7.1 Modeli i Trendit

Përdorimet më të zakonshme të modelit të trendit janë 2, modeli i rritjes së saturuar dhe modeli linear [36]. Modeli i rritjes së saturuar jepet në ekuacionin më poshtë:

$$g(t) = \frac{c}{1 + \exp(-k(t-m))} \quad (4.62)$$

ku  $c$  është kapaciteti i mbartur,  $k$  është parametri i rritjes dhe  $m$  është parametri i offset.



Në bazë të analizës së ekuacionit më sipër, mund të themi se  $C$  dhe  $k$ , nuk janë zakonisht parametra konstante. I pari zëvendësohet nga  $C(t)$ . Në të dytin përfshihen pikat e ndryshimit ku rendi i rritjes lejohet të ndryshojë. Duke shënuar pikat e ndryshimit me  $s_j$ , ku  $j=1\dots S$ , përlllogaritet një vektor sistemimesh  $\delta \in R^S$  nga parametri bazë  $k$  dhe sistemimet deri në këtë pikë si në ekuacionin më poshtë:

$$t = k + \mathbf{a}(t)^T \boldsymbol{\delta}$$

ku:

$$a_j(t) = \begin{cases} 1, & \text{if } t \geq s_j \\ 0, & \text{ne te kundert} \end{cases}$$

Parametri i offset  $m$ , duhet të rregullohet sipas parametrin  $k$  në mënyrë që të lidhen pikat fundore të segmenteve [39]. Sistemimet në pikat fundore tregohen më poshtë:

$$\gamma_j = \left( s_j - m - \sum_{l < j} \gamma_l \right) \left( 1 - \frac{k + \sum_{l < j} \delta_l}{k + \sum_{l \leq j} \delta_l} \right)$$

Modeli i rritjes së saturuar si më poshtë:

$$g(t) = \frac{c(t)}{1 + \exp\left(-\left(k + \mathbf{a}(t)^T \boldsymbol{\delta}\right)\left(t - \left(m + \mathbf{a}(t)^T \boldsymbol{\gamma}\right)\right)\right)} \quad (4.63)$$

Ne rastet kur parashikimi nuk e kënaq modelin e saturuar të rritjes, përdoret rendi konstant i rritjes. Modeli i trendit shndërrohet në:

$$g(t) = \left(k + \mathbf{a}(t)^T \boldsymbol{\delta}\right)t + \left(m + \mathbf{a}(t)^T \boldsymbol{\gamma}\right) \quad (4.64)$$

ku:

$$\gamma_j = -s_j \delta_j.$$

#### 4.7.2 Modeli i sezonalitetit

Periudhat e shumëfishta të sezonalitetit shfaqen vazhdimisht në seritë kohore të biznesit. Modelet e sezonalitetit duhet të specifikohen si funksione periodike në lidhje me  $t$ . Seritë Fourier përdoren për të ofruar fleksibilitet për modelet periodike. Efekti sezonal tregohet në ekuacionin më poshtë:

$$s(t) = \sum_{n=1}^N \left( a_n \cos\left(\frac{2\pi n t}{P}\right) + b_n \sin\left(\frac{2\pi n t}{P}\right) \right) \quad (4.65)$$

ku  $P$  është perioda e serive kohore.  $2N$  parametra,  $\beta = [a_1, b_1, \dots, a_N, b_N]^T$  përcaktohen për sezonalitetin. Matrica e sezonalitetit ndërtohet nga çdo vlerë e  $t$  në të shkuarën dhe të ardhmen [40]. Komponentja e sezonalitetit tregohet si më poshtë:

$$S(t) = X(t) \beta$$

### 4.7.3 Ditët Festive

Ditët festive dhe eventet, zakonisht nuk janë periodike dhe shkaktojnë shumë ndryshime të parashikueshme në seritë kohore të biznesit. Duke qënë se ato ndodhin çdo vit, është e rëndësishme ti përfshijmë në parashikim [41]. Duke supozuar se efekti i tyre është i pavaruar, një listë e ditëve festive vendoset në sistem. Një funksion përcakton nëse një kohë t është pergjatë ditëve festive  $i$ , duke alokuar parametrin  $k_i$  si pikë ndryshimi në parashikim. Së fundmi krijohet një matricë për regresorët:

$$Z(t) = [\mathbf{1}(t \in D_1), \dots, \mathbf{1}(t \in D_L)] \quad (4.66)$$

Dhe  $h(t) = Z(t)k$ . Gjithashtu mund të përcaktohen parametra të tjera për ditët para dhe pas ditëve festive.

### 4.7.4 Metrikat e gabimit

Saktësia në parashikim mund të vlerësohet nëpërmjet vlerës mesatare të gabimit absolut në parashikim, MAE (Mean Average Error) ose vlerës mesatare të gabimit absolut në përqindje MAPE (Mean Absolute Percentage Error). Formulatat për secilin gabim jepen në ekuacionet 4.67 dhe 4.68:

$$MAE = \frac{1}{n} \sum_{j=1}^n |y_j - \bar{y}_j| \quad (4.67)$$

$$MAPE = \frac{1}{n} \sum_{j=1}^n \left| \frac{y_j - \bar{y}_j}{y_j} \right| \times 100\% \quad (4.68)$$

#### 4.1 Konkluzione

Në këtë kapitull u analizuan teknikat dhe algoritmat që u implementuan dhe modifikuan gjatë pjesës eksperimentale. Fillimisht u studiuuan algoritmat e klasterizimit dhe veçanërisht algoritmat K-Means, K-Medoids dhe algoritmat hierarkike. Aparati matematikor i secilit algoritëm u shpjegua dhe ilustrua me shëmbuj dhe skema. Më pas u studiuuan teknikat e klasifikimit. Në këtë pjesë u studiuuan nga ana teorike algoritmat KNN (Klasifikuesi i K-fqinjëve më të afërt), algoritmi SVM dhe rrjetat neurale.

Aparati matematikor i secilit algoritëm u shpjegua dhe analizua.

Vlen për tu theksuar se ju dha një fokus më i madh rrjetave neurale (NN) duke qënë se besojmë se janë teknikat më premtuese të klasifikimit dhe regresit. Arkitekturat kryesore të rrjetave NN u shpjeguan dhe fazat e përparme dhe të pas-shpërndarjes u shtjelluan. Gjithashtu u analizuan funksionet e ndryshme të aktivizimit dhe të gabimit që përdorën. Të gjitha këto funksione do të implementohen në modelin e krijuar në pjesën eksperimentale. Duhet të theksojmë se analiza teorike e teknikave të klasifikimit dhe e rrjetave neurale bazohet thelbësisht në librin “*Data Mining and Machine Learning Fundamental Concepts and Algorithms by Mohammed J. Zaki, Wagner Meira Jr, Cambridge University Press, 2020*” të referuar me numrin 33 duke i besuar cilesisë shumë të lartë të analizës që kryhet në të.

## KAPITULLI 5

### 5. PUNA EKSPERIMENTALE

Pjesa eksperimentale do të ndahet në 3 pjesë kryesore. Në pjesën e parë do të analizohen modelet grupuese në klastera dhe do të grupohen klientët në klasetrat kryesorë. Në pjesën e dytë do të analizojmë dhe propozojmë modelet parashikuese. Në pjesën e tretë do të analizojmë dhe propozojmë modelet e serive kohore me fokus në algoritmin Prophet. Baza e të dhënave do të ndahet në 3 pjesë kryesore të cilat do të përdoren për 3 seksionet e ndryshme të analizës. Në bazën e parë të të dhënave do të agregojmë nga baza e të dhënave transaksionale blerjet për vitin 2019 të klientëve të qendrës tregtare. Në këtë bazë të dhënash do të kemi 9931 rreshta. Kjo bazë të dhënash do të përdoret për të implementuar modelet e klasterizimit. Në bazën e dytë të të dhënave do të kemi 3797 rreshta të blerjeve të klientëve për 3-mujorin e parë të 2020 dhe kjo bazë të dhënash do të përdoret për të implementuar modelet parashikues me qëllim parashikimin e klasës së klientëve në fund të vitit. Baza e tretë e të dhënave konsiston te të gjitha shitjet ditore nga viti 2011-2019 dhe kjo bazë e dhënash do të përdoret me qëllim aplikimin e modelit Prophet të serive kohore. Qëllimi do të jete parashikimi i shitjeve për vitin 2020 për të gjithë qendrën.

Teknikat e analizuara në pjesen teorike do të përdoren për të krijuar disa modele të cilat do të përdoren për grupimin dhe klasifikimin e klientëve të qendrës tregtare. Në pjesën e parë do të aplikohen modelet e klasterizimit të të dhënave dhe do të analizohet performanca e tyre. Të gjitha algoritmat kryesore të klasterizimit do të përdoren si, K-Means, K-Medoids, klasterat hierarkike dhe dbscan [42]. Në pjesën e dytë do analizojmë dhe implementojmë modelet e klasifikimit. Do të krijojmë 3 modele parashikues. Modeli i parë do të bazohet në algoritmin KNN (K-Nearest Neighbours). Modeli do të parametrizohet dhe modifikohet për të arritur rezultatet më të mira. Modeli i dytë do të bazohet në SVM (Support Vector Machines) dhe do të modifikohet dhe parametrizohet për të arritur rezultatet maksimale. Për modelin e tretë do të ndërtojmë një rrjet neural i cili do të parametrizohet në mënyrë që të arrijmë rezultatet maksimale. Në pjesën e tretë do të analizohet dhe propozohet një model i bazuar te seritë kohore dhe në veçanti në algoritmin Prophet. Do të kryhen modifikime të modelit bazë dhe do të krahasohet performanca e modeleve.

Analiza do të kryhet duke përdorur SQL për agregimin e të dhënave dhe Python dhe Pytorch për ndërtimin e modeleve të klasterizimit apo parashikimit. Kodet e përdorura do të bashkangjiten punimit si anekse.

#### 5.1 Teknikat e Klasterizimit

##### 5.1.1 Eksplorimi i bazës së të dhënave

Baza e të dhënave që do të përdoret do të merret duke agreguar me SQL blerjet e klienteve për vitin 2019. Blerjet do të grupohen në 3 kategori kryesore si: Veshje, Aksesorë dhe Të tjera. Në grupin e veshjeve përfshihen blerjet e veshjeve të të gjitha llojeve në të gjitha dyqanet e qendrës

tregtare. Në grupin aksesorë përfshihen aksesorët e ndryshëm si bizhuteritë, kozmetika, kancelaria dhe pajisjet për shtëpi. Në grupimin e tretë, të tjera do të grupohen të gjitha shitjet e dyqaneve të tjera që vendosen në qendrën tregtare por që stoku i tyre nuk është pronë e qendrës tregtare. Këto blerje janë përfshirë në analizën tonë në mënyrë që të analizojmë korrleacionin e tyre me kategoritë e tjera nëse ka. Në atributet e bazës së të dhënave përfshihen gjithashtu, moshë, seksi dhe qyteti i lindjes së klientit. Këto tre attribute do të na ndihmojnë gjithashtu në grupimin e klientëve. Duhet të theksojmë se atributi qytet nuk do të përdoret pasi sipas analizës mbi 90% e klienteve kishin Tiranën të deklaruar si qytet. Për këtë arsye nuk e kemi marrë në konsideratë këtë atribut.

### 5.1.2 Para-proçesimi i të dhënave

Siç e kemi theksuar disa herë gjatë analizës teorike, një nga pjesët më të rëndësishme në Data Mining (DM) është para-proçesimi i të dhënave. Fillimisht ne analizojmë të dhënat tona për të kuptuar nëse kemi mungesë të dhënash për ndonjë atribut specifik. Më poshtë po paraqesim një pasqyrë përmbledhëse të të dhënave tona dhe një printim të 5 rreshtave të para të bazës së të dhënave.

```
<class 'pandas.core.frame.DataFrame'>
RangeIndex: 9931 entries, 0 to 9930
Data columns (total 7 columns):
#   Column      Non-Null Count  Dtype
---  ---
0   CLIENTE    9931 non-null   int64
1   SESSO      9931 non-null   object
2   CITTA      9931 non-null   object
3   AGE        7603 non-null   float64
4   Clothes    7527 non-null   float64
5   Acc        4997 non-null   float64
6   Others     2932 non-null   float64
dtypes: float64(4), int64(1), object(2)
memory usage: 543.2+ KB
```

Table 5-1 Përmbledhëse e datasetit dhe 5 rreshtat e parë

	KLIENTI	GJINIA	QYTETI	MOSHA	Clothes	Acc	Others
0	27176	F	TIRANE	40	37243	0	0
1	28569	F	ABCD	44	26033	0	0
2	19383	M	TIRANE	37	1199	0	0
3	25150	F	ABC	39	1905	0	0
4	33536	M	TIRANE	39	48345	0	0

Siç e shohim nga raporti, kemi mungesë të dhënash në atributet e moshës dhe te grupet e ndryshme të blerjeve. Në rastin e moshës do të zëvendësojmë rreshtat bosh me të mesmen e moshës së klientëve në bazën e të dhënave. Ky është një vendim strategjik i yni ,pasi në këtë mënyrë nuk do të na impaktojë analizën. Në rastin e grupeve të blerjeve, një rresht bosh nënkupton mungesë blerjesh për atë klient në atë kategori. Për këtë arsye i zëvendësojmë rreshtat bosh me 0. Pasi kryejmë ndryshimet e mësipërme shohim që nuk kemi më reshta bosh

në bazën tonë të të dhënave. Hapi final është normalizimi i të dhënave në mënyrë që të shmangim impaktin më të madh të attributeve me vlera më të mëdha në modelet tona. Të dhënat standartizohen duke përdorur funksionin `StandardScaler()` të libraries `sklearn`. Në këtë mënyrë të gjitha atributet do të trajtohen me të njëjtën peshë.

### 5.1.3 Korrelimi midis attributeve

Së pari do të analizojmë korrelimin midis attributeve që do të përdorim për klasterizim. Tabelën e korrelimit e marrim duke përdorur funksionin `sns.heatmap` të librarisë `seaborn`. Rezultatet paraqiten në figurën 1.




Figure 5-1 Korrelimi midis attributeve

Nga tabela e korrelacionit, rezulton se kemi një korrelacion të fortë midis blerjes së aksesorëve dhe blerjes së veshjeve me një vlerë 0.6. Kjo shpjegohet me faktin se vendodhja e aksesorëve nuk është e diferencuar nga vendodhja e veshjeve. Kjo na tregon se gjithashtu klientët që blejnë më shumë veshje, gjithashtu blejnë edhe aksesorë. Një lidhje interesante është korrelacioni më i lartë midis aksesorëve dhe të tjerave (others). Kjo shpjegohet me faktin se të gjitha dyqanet e tjera janë të vendosura në katin e parë ku kemi vetëm aksesorë dhe jo veshje. Pra klientët të cilët blejnë në dyqanet e tjera, blejnë më shumë aksesorë pasi e kanë më afër fizikisht. Kjo na tregon një lidhje të rëndësishme të ekspozimit fizik të mallit me blerjen e tij.

#### 5.1.4 Klasterizimi me K-Means

Fillimisht do të përdorim algoritmin K-Means për të klasifikuar klientët. Hapi i parë është të përcaktojmë numrin optimal të klasterave dhe për këtë qëllim do të përdorim tekniken Elbow të shpjeguar në pjesën teorike. Sipas teknikës Elbow do të vendosim në një grafik vlerën e inercisë, e cila është shuma e distancës euklidiane në katror të të dhënave nga qendrat e klasterave, përkundrejt numrit të klasterave. Më poshtë paraqesim grafikun e përfutur.




Figura 5-2 Metoda Elbow

Nga grafiku, vëme re se bërryli(elbow) vjen në numrin e klasterave të barabartë me 4. Në vazhdim të studimit tonë do të përdorim numrin 4 si numrin optimal të klasterave.

Në algoritmin K-Means, qendrat fillestare të klasterave zgjidhen në mënyre rastësore dhe më pas në mënyre iterative zgjidhet qendra e re cila bazohet në mesataren e distancës euklidiane në katror të pikave nga qendra aktuale. Ky proces vazhdon derisa sa konvergjojmë në qendrat optimale. Kemi dy faktorë të rëndësishëm në algoritmin K-means që mund të impaktojnë përzgjedhjen e Klasterave. Faktori i parë është përzgjedhja e qendrave fillestare i cili ka impakt direkt në konvergjencë dhe faktori i dytë është ndikimi i pikave të të dhënave periferike (outliers) në percaktimin e klasterave. Ne do të analizojmë vetëm impaktin e të dhënave periferike pasi ajo ka rëndësi për studimin tonë. Në vazhdim apikojmë algoritimin K-Means në bazën tonë të të dhënave dhe paraqesim rezultatet në një grafik në figurën me poshtë.




Figura 5-3 Klasterat e klienteve K-Means

Për ta bërë më të qartë vizualisht analizën kemi bërë një vizualizim në 2D të të dhënave. Çdo ngjyrë paraqet një klaster të caktuar të klientëve.

Në figurë dallojmë 4 klastera të ndryshëm por ajo që bën përshtypje më shumë është pika e të dhënave djathtas sipër. Ajo pikë është qartësisht një pikë periferike (outlier) por për algoritmin tonë është një klaster specifik. Pra kuptojmë se K-Means ndikohet nga të dhënat periferike duke alokuar qendra klasterash për to. Kjo është e kuptueshme nëse marrim në konsideratë faktin që algoritmi përdor mesataren euklidiane për të përcaktuar qendrën e klasterave dhe siç e kemi shpjeguar dhe në materialin teorik, mesatarja euklidiane është e ndikuar nga të dhënat periferike.

Një tjetër detaj që vëmë re është se grupimi është linear dhe nuk na jep shumë informacion për ndarjen sipas kategorive. Një anë positive e algoritmit është efikasiteti në kohë pasi na u deshën vetëm pak milisekonda për të aplikuar atë në bazën tonë të të dhënave.

### 5.1.5 Klasterizimi me K-Medoids

Në menyrë që të zgjidhim problematikat e sipërpërmendura do të përdorim një tjetër algoritëm, i cili nuk përdor distancën euklidiane nga qendra e të gjitha pikave por distancën në çift midis pikave. Ky proces ka një dizavantazh të dukshëm në lidhje me efikasitetin në kohë që do e analizojmë më poshtë por ka avantazhe të dukshme në lidhje me ndikimin nga të dhënat periferike. Algoritmi aplikohet në bazën tonë të të dhënave dhe rezultatet paraqiten në figurën më poshtë.






Figura 5-4 Klasterat e klienteve K-Medeoids

Siç e shohim dhe në figurë, rezultatet që marrim nga aplikimi I K-Medeoids janë më të mira se rezultatet e përfuara kur aplikojmë K-Means pasi në këtë rast ndikimi nga të dhënat periferike anulohet. Gjithashtu vëmë re se grupimi i klienteve bazohet më shumë në kategoritë e blerjeve se sa në rastin e K-Means dhe kjo është një veçori e dëshiruar nga ne. Këto avantazhe vijnë në këmbim të një kompleksiteti më të lartë në kohë.

#### 5.1.6 Klasterizimi me DBSCAN

Tani do të aplikojmë algoritmin dbscan i cili bazohet në dëndësinë e të dhenave. Algoritmi merr si parametra të tij rrezën eps dhe numrin minimal të pikave në fqinjësi min\_eps. Ne do të provojmë vlera të ndryshme të këtyre parametrave për të arritur në rezultate të kënaqshme. Më poshtë paraqesim grafikët me vlera të ndryshme të parametrave. Siç e shohim nga rezultatet e marra, në të gjitha rastet grupimet nuk janë shumë efikase.




Figura 5-5: DBSCAN Min\_pts=7 eps=0.3




Figura 5-6 DBSCAN Min\_pts=7 ,eps=2




Figura 5-7 DBSCAN Min\_pts=7 ,eps=0.05

Siç e shohim, me rritjen e rrezes pikat grupohen në një klaster të vetëm, duke lënë jashtë vetëm pikat periferike (Figura 5-6). Me uljen e rrezes numri i klasterave rritet (Figura 5-7). Në figurën e parë kur kemi: Min\_pts=7 eps=0.3, kemi një numër klasterash të barabartë me 4 (marrim parasysh të dhënat periferike me label -1). Por në të gjitha rastet grupimet nuk janë efikase. Kjo shpjegohet me faktin se densiteti i të dhënave në bazën tonë është i ngjashëm, çka e bën jo efektive këtë algoritëm [44].

### 5.1.7 Algoritmi Hierarkik Aglomerativ

Së fundmi do të aplikojmë klusterizimin aglomerativ duke prodhuar një dendogram. Në klusterizimin aglomerativ dy klastera të afërt me njëri tjetrin bashkohen duke u nisur nga poshtë lart deri sa të gjitha të dhënat grupohen në një klaster. Numri i klasterave mund të dallohet në mënyrë intuitive duke ju referuar dendogramit por nuk mund të bazohemi 100% në të. Më poshtë paraqesim një dendogram të bazës sonë të të dhënave. Siç mund të vëmë re nga rezultatet është shumë e vështirë të deduktojmë rezultate nga dendogrami në rastin tonë duke qënë se numri i klientëve është i lartë.

Gjithashtu mund të themi se algoritmi hierarkik aglomerativ prodhon rezultate të ngjashme me algoritmin K-Means duke vuajtur të njëjtat probleme.




Figura 5-8 Dendogrami i të dhënave

#### 5.1.8 Rezultate të Klasterizimit

Siç pamë nga rezultatet më sipër rezultatet më të mira u morrën në rastin kur përdorëm K-medeoide. Në atë rast të dhënat tona nuk u ndikuan nga të dhënat periferike por edhe grupimi ishte sipas kategorive të blerjeve. Pamë se K-Means ndikohet nga të dhënat periferike dhe ndarja është lineare ndërmjet të gjitha kategorive të blerjeve. Algoritmi DBSCAN i cili bazohet te dendësia e të dhënave nuk është i përshtatshëm për të dhënat tona që kanë dendësi uniforme. Gjithashtu pamë se algoritmi hierarkik aglomerativ dhe në veçanti dendogrami nuk është shumë i përshtatshëm për bazën tonë të të dhënave. Në lidhje me kompleksitetin në kohë, rezultatet i kemi paraqitur në tabelën më poshtë. Siç shohim, algoritmi K-Means dhe DBSCAN janë më eficientë në kohë ndërsa K-Medeoide dhe algoritmi aglomerativ kanë kompleksitet më të lartë në kohë. Nga kjo deduktojmë se në raste kur baza e të dhënave është e madhe, K-Means është më i përshtatshëm për përdorim. Për të shmangur efektin e të dhënave periferike në këto raste, një zgjidhje do të ishte pastrimi i bazës së të dhënave nga këto pika. Në rastin e bazave të të dhënave jo sh të mëdha, mund të përdoret K-Medeoide i cili jep rezultate të kënaqshme si në rastin tonë.

Tabela 5-2 Performanca në kohë e modeleve të klasterizimit

Algoritmi	Numri i iterimeve	Koha në Sekonda
K-Means	10	3.34
K-Medeoide	10	190
Dendrogram/Agglomerative	1	1440
DBSCAN	10	7.41

Nga ana funksionale rezultatet e marra nga klasterizimi u dërguan në departamentin e Marketing. Për të ilustruar disa aspekte interesante të studimit më poshtë një grafik i cili tregon

se si janë të ndara blerjet për grupe klientësh. Mund të shohim se 31% të blerjeve të klientëve të regjistruar kryhen nga vetëm 2% e klientëve dhe 65% e tyre kryejnë vetëm 12% të blerjeve.



Figura 5-9 Rezultatet e ndarjes në klastera

## 5.2 Modelet e klasifikimit

### 5.2.1 Eksplorimi i bazës së të dhënave

Baza e të dhënave përbehet nga 3797 rekorde të cilat përshijnë blerjet për tre-mujorin e parë të vitit 2020 të klientëve të regjistruar në qendrën tregtare.



Figura 5-10 Ndarja e klientëve në klasa

.Atributet që do të përdoren për parashikim janë: seksi, mosha, vlera totale e blerjeve tremujore, kategoria e preferuar, sasia dhe blerjet e vitit të kaluar për klientet e përsëritur (kjo vlerë është 0 në rastin e klientëve të rinj). Klientët janë të grupuar në 3 klasa, klasa 0–vlerë totale blerjesh vjetore për vitin 2020 deri në 500 USD, klasa 1- vlerë totale blerjesh vjetore nga 500 deri në 1000 USD dhe klasa 2- vlerë totale blerjesh vjetore mbi 1000 USD. Së pari ne do të krijojmë një histogram të klientëve në mënyrë që të kuptojmë se si është ndarja në klasa.

Nga grafiku me figurën 5-10, kuptojmë se kemi një mosbalancë të moderuar të klasave duke qënë se klasa 1 përbën 64% të klientëve. Por gjithsesi në këtë studim nuk do të kryejmë teknika balancimi të të dhënave. Këto teknika do të kryhen në punët në vazhdim.

### 5.2.2 Para-proçesimi i të dhënave

Si në rastin e klasterizimit, para se të aplikojmë modelet e klasifikimit do të bëjmë para-proçesimin e të dhënave.

```
<class 'pandas.core.frame.DataFrame'>
RangeIndex: 3797 entries, 0 to 3796
Data columns (total 9 columns):
#   Column      Non-Null Count  Dtype
---  -
0   CLIENTE    3797 non-null   int64
1   SESSO      3797 non-null   object
2   CITTA      3797 non-null   object
3   CAT        3797 non-null   int64
4   AGE        2878 non-null   float64
5   Val        3797 non-null   int64
6   Sasi       3797 non-null   int64
7   Prev       3002 non-null   int64
8   Label      3797 non-null   int64
dtypes: float64(1), int64(6), object(2)
memory usage: 267.1+ KB
```

Tabela 5-3: Përmbledhëse e datasetit dhe 5 rreshtat e parë

	Klienti	Gjinia	Qyteti	KAT	MOSHA	Val	Sasi	Prev	Label	Gjinia
0	232	F	TIRANE	950	40.0	162	5	5765	3	0
1	246	F	TIRANE	980	47.0	211	2	495	3	0
2	254	F	TIRANE	930	42.0	565	18	869	3	0
3	309	M	TIRANË	940	31.0	1771	19	10122	3	1
4	368	M	TIRANE	980	62.0	187	6	497	2	1

Nga përmbledhja e të dhënave shohim se kemi mungesë të dhënash për moshën dhe vitin para-ardhës në disa rreshta. Për moshën, do të përdorim të njëjtën teknike që kemi përdorur në rastin e klasterizimit duke zëvendësuar vlerat bosh me të mesmen e moshës në bazën e të dhënave. Për vlerën e vitit para-ardhës do ta zëvendësojmë vlerën bosh me 0 pasi vlera bosh nënkupton një klient të ri. Duke qënë se modelet që do të aplikojmë veprojnë mbi të dhënat numerike dhe atributi i seksit përmban shkronja, do të bëjmë enkodimin e atributit duke përdorur funksionin

`preprocessing.LabelEncoder()` te librarisë sklearn.Shkronja F(femër) do të kthehet në 0 dhe shkronja M(Mashkull) do të kthehet në numrin 1.

Baza e të dhënave do të ndahet në 80% që do të përdoret për trajnimin e modelit dhe 20% për testimin e modelit të klasifikimit.Ndarja kryhet duke përdorur funksionin `train_test_split` të librarisë sklearn.

### 5.2.3 Modeli KNN

Modeli KNN (K-Nearest Neighbour) përdor kampionimin e të dhënave për të vlerësuar densitetin duke përdorur vlerësimin e densitetit sipas fqinjëve më të afërt. Modeli merr si parametër numrin e fqinjëve.Ne do të eksperimentojmë me numra të ndryshëm fqinjësh deri sa të arrijmë në rezultatet optimale.Elementi mbi të cilin do të vleresohet performanca e modelit do të jetë saktësia (accuracy). Gjatë fazës së parë modeli do të trajnohet me 80% të të dhënave të marra nga baza e të dhënave dhe më pas do të testohet në 20% e mbetur. Saktësia gjendet duke krahasuar klasën e përcaktuar nga modeli i trajnuar me klasën reale të marrë nga 20% test i të dhënave.Më poshtë do të paraqesim saktësinë për numër të ndryshëm fqinjësh për të gjetur numrin optimal të fqinjëve.




Figura 5-11: Saktësia për numer te ndryshem fqinjesh

Siç mund të dallohet nga grafiku, ne arrijmë vlerën më të lartë të saktësisë për numrin e fqinjëve të barabarte me 15. Saktësia për këtë numër fqinjësh është 0.7856 . Në mënyrë që të kuptojmë rezultatet tona janë të vlefshme duhet të kryejmë procesin e cross-validation duke përdorur funksionin `KFold`, `cross_val_score`. Proçesi i Cross Validation e ndan databazën e testimit në disa pjesë , kryhen testime të ndryshme mbi to dhe rezultatet përdoren për të kuptuar vlefshmërinë e vlerës se përftuar të saktësisë. Ne do të përdorim në rastin tonë 5 pjesë të ndryshme ndarjeje.

Tabela 5-4 Saktësia pas Cross Validation

Numri i ndarjeve të databazës së testit	Saktësia
1	0.751
2	0.777
3	0.779
4	0.771
5	0.799

Siç vëme re nga tabela, rezultatet janë të ngjashme me saktësinë tonë duke na i konfirmuar vlerën e përfituar të saktësisë. Së fundmi duhet të prodhojmë një matricë të saktësisë (confusion matrix) për të kuptuar saktësinë për klasat e ndryshme të klientëve tanë. Për të realizuar këtë përdorim funksionin *plot\_confusion\_matrix*. Më poshtë parqesim matricën dhe interpretojmë rezultatet.




Figura 5-12 Matrica e Saktësisë

Siç vëmë re nga matrica e saktësisë dhe siç pritej kemi një saktësi të lartë për klasat 1 dhe 3 por vuajmë në saktësinë e klasës së ndërmjetme 2. Besojmë se kjo performancë e dobët në parashikimin e klasës së ndërmjetme vjen nga rangi i vogël dhe numri më i vogël i klientëve në atë klasë. Por pavarisht kësaj mund të themi se rezultat e përftuara janë të kënaqëshme duke u nisur nga baza e të dhënave e vogël që ne kemi.

#### 5.2.4 Support Vector Machines

Support Vector Machines (SVMs) është një metodë klasifikimi e bazuar në maksimumin marxhinal të diskriminuesve linear, që ka si qëllim kryesor gjetjen e planit maksimal që

maksimizon largësinë ose marzhin mes klasave. Modeli i dytë parashikues që do të krijojme është një model që bazohet në SVM.

### 5.2.5 Eksplorimi i të dhënave dhe para-procesimi

Baza e të dhënave e përdorur dhe elementet e paraprocesimit janë të njëjta me rastin e KNN.

### 5.2.6 Modeli SVM

Pas realizimit të analizave më lart, aplikohet algoritmi i SVM. Në fillim aplikohet modeli pa bërë shkallëzimin e të dhënave me qëllim theksimin e rëndësisë së standartizimit të të dhënave në aplikime SVM. 80% e të dhënave janë përdorur për datasetin e zhvillimit, ndërsa 20% e tyre janë përdorur për qëllime testimi. SVM përdoret së pari me një bërthamë lineare për të cilën regjistrohet saktësia.

Mund të vërehet se koha e ekzekutimit është jashtëzakonisht e afektuar dhe u deshën afërsisht 29 minuta për të aplikuar modelin. Në të dhënat e panormalizuara kemi një saktësi prej 76,71%. Më tej, bëhet normalizimi i të dhënave duke përdorur funksionin Standart Scaler dhe ri-aplikojmë algoritmin. Në këtë moment marrim një saktësi prej 80.79% dhe koha e ekzekutimit është pothuajse e menjëhershme.

Tabela 5-5 Saktësia në varësi të normalizimit të të dhënave

	Saktësia	Koha e ekzekutimit
<b>Të dhëna të pastandardizuara</b>	76.71%	28min 38s
<b>Të dhëna të standartizuara</b>	80.79%	250 ms

Në mënyrë që të vërtetojmë rezultatet tona, ne kryejmë cross validation në model me 10 pjesë. Rezultatet janë përshkruar në tabelën 5-6 dhe mund të shihet se ato janë mjaft në përputhje me vlerën tonë, kështu që mund ta konsiderojmë të validuar ose vërtetuar modelin.

Tabela 5-6 Cross-Validation në SVM

Pjesa	Saktësia
Pjesa 1	0.7730263
Pjesa 2	0.7796053
Pjesa 3	0.8026316
Pjesa 4	0.8026316
Pjesa 5	0.7960526
Pjesa 6	0.7960526
Pjesa 7	0.7927632
Pjesa 8	0.7788779
Pjesa 9	0.7821782
Pjesa 10	0.7887789
Mesatarja	0.7892598



Pas validimit të modelit bëjmë kontroll të matricës së saktësisë, për të kuptuar se si performon modeli për secilën klasë në veçanti.




Figura 5-13 Matrica e saktësisë për SVM

Ashtu sikurse pritej, modeli ynë punon më mirë në kategorinë e parë dhe të tretë si dhe çalon më shumë në pjesën e mesme të tij. Ne mundemi të parashikojmë një klasë “2” të saktë 13 herë. Modeli na ofron një precizion të lartë prej 82% në parashikimin e klasës së parë dhe të tretë. Vlen të anaizojmë modelin tonë dhe për bërthama(kernels) të ndryshme. Në këtë mënyrë do të validojmë ose jo bërthamën lineare që përdorëm. Më poshtë është paraqitur kontrolli i bërë për saktësinë bazuar në tipe të ndryshme bërthamash (kernels).




Figura 5-14 Saktësia për tipe të ndryshme bërthamash

Si përfundim, mund të themi që ne marrim rezultate më të mira nëse përdorim tipin e bërthamës lineare në datasetin tonë. Në këtë seksion, ndërtuam një model të bazuar në SVM për të

parashikuar blerjet e klientëve. Edhe pse madhësia e të dhënave ishte e kufizuar, saktësia e parashikimit rezultoi mjaft e mirë. Është vërejtur se shkallëzimi i të dhënave është mjaft i rëndësishëm para aplikimit të algoritmit SVM, duke rezultuar në një kohë ekzekutimi jashtëzakonisht të shkurtër dhe saktësi më të mirë. Gjithashtu testuam modelin tonë për lloje të ndryshme të bërthamave dhe morëm rezultatet më të mira për bërthamën lineare. U hasën disa vështirësi në parashikimin e klasave të mesme. Në të ardhmen, studimi do të kryhet për grupe më të mëdha të të dhënave dhe do të zgjerohet në dimensionet e ndryshme. Gjithashtu, teknikat si marrja e kampioneve ose SMOTE do të aplikohen për të zvogëluar efektin e çekuilibrit mes klasave [45].

### 5.2.7 Rrjetat Neurale

Modeli i tretë parashikues që do të krijojmë, është një model që bazohet në rrjetat neurale. Rrjetat neurale janë algoritmat që përdoren më së tepërmi në vitet e fundit për shkak të performancës së tyre të lartë. Rrjetat neurale mund të përshkruhen nëpërmjet një grafi të peshuar të drejtuar  $graph=(V,E)$ , ku çdo nyje  $v_i \in V$  përfaqëson një neuron, dhe çdo degë  $(v_i, v_j) \in E$  përfaqëson një lidhje sinaptike nga  $v_i$  në  $v_j$ . Peshat e çdo dege  $w_{ij}$  përfaqëson fuqinë sinaptike. Rrjetat neurale karakterizohen nga lloji i funksionit të aktivizimit që përdoret për të gjeneruar rezultatin në dalje dhe nga arkitektura e rrjetit që përcakton mënyrën se si lidhen nyjet. Ne do të krijojmë një model i cili do të ketë parametrat si në tabelën 5-7. Modeli ynë do të ketë 6 nyje në shtresën e hyrjes që përfaqësojnë 6 atributet parashikues. Gjithashtu do të kemi vetëm një shtresë të ndërmjetme, por do të variojmë numrin e nyjeve në këtë shtresë për të arritur rezultate optimale. Numri i nyjeve në shtresën e jashtme do të jetë 4, pasi kemi 3 klasa (1,2,3). Arsyeja përse e vendosim në 4 numrin e shtresave në dalje është pasi python numëron nga 0 dhe nëse duam të paraqesim klasat nga 0 deri në 3 në dalje na duhen 4 nyje. Nëse do të emërtonim klasat tona nga 0 deri në 2, do të kishim nevojë vetëm për 3 nyje në dalje. Përcaktojmë një *learning rate* të barabartë me 0.01. Kujtojmë se *learning rate* është parametri që përcakton se sa shpejt do të levizim në rastin e përhapjes së prapme kur përdorim SGD (Stochastic Gradient Descent) për optimizimin e humbjeve. Do të përdorim një numër iterimesh (epochs) nga 20000 deri në 500000. Lloji i humbjes që do të përdorim është humbja Cross Entropy. Do të përdorim disa funksione aktivizimi dhe do të analizojmë performancën e gjithësecilit. Për optimizimin e modelit do të përdorim SGD. Modeli do të ndërtohet me Pytorch. Teknikat e paraprosesimit që përdoren janë të njëjtat që përdoren në rastin e modelit në KNN.

Tabela 5-7 Parametrat e modelit NN

Numri i nyjeve në shtresën e hyrjes= <b>6</b>
Numri i nyjeve në shtresën e ndërmjetme= <b>[5:100]</b>
Numri i nyjeve në shtresën e jashtme= <b>4</b>
Learning Rate = <b>0.01</b>
num_epoch = <b>20000:50000</b>
Funksioni i Humbjes : <b>Cross Entropy Humbja</b>
Funksioni I Aktivizimit: <b>Sigmoid</b>
Model Optimizer : <b>SGD</b>

Fillimisht do të eksperimentojmë me numrin e nyjeve në shtresën e ndërmjetme. Duhet të kemi parasysh që mund të përdorim edhe më shumë se një shtresë të ndërmjetme por gjykojmë se për parashikimin tonë mjafton një shtresë dhe mund të alternojmë numrin e nyjeve në të. Rezultatet e humbjeve dhe saktësisë për numër të ndryshëm nyjesh në shtresën e ndërmjetme i paraqesim më poshtë.




Figura 5-15 Humbja Cross Entropy për numër të ndryshëm nyjesh në shtresën e ndërmjetme




Figura 5-16 Saktësia për numër të ndryshëm nyjesh në shtresën e ndërmjetme

Siç mund të shohim, rezultatin më të mirë të saktësisë 79.864 e arrijmë për numrin 20 të nyjeve në shtresën e ndërmjetme. Gjithashtu vlera e humbjeve për këtë numër nyjesh është e ulët. Pra

do të zgjedhim numrin 20 për numrin e nyjeve oln ne modelin tonë. Gjithashtu nga eksperimentet përcaktojmë vlerën e learning rate 0.01 si vlerën optimale të lr. Modeli konvergjon pas 50000 iterimesh, pra nuk kemi nevojë ta testojmë për një num\_epochs më të madh .Pasi kryejmë procesin e cross validation si në rastin e KNN, vlerat e marra e konfirmojnë saktësinë e modelit tonë. Së fundmi duhet të përcaktojmë nëse funksioni i aktivizimit që zgjedhëm, në këtë rast Sigmoid është funksioni optimal apo jo. Për të verifikuar këtë do të ndryshojmë funksionin e aktivizimit dhe do të eksperimentojmë me 2 funksione të tjera përkatesisht ReLU dhe TanH. Analizën teorike të tyre e kemi kryer në kapitujt pararendës. Në grafikët më poshtë paqraesim grafikët përmbledhës të rezultateve.




Figura 5-17 Humbja për funksione të ndryshme aktivizimi




Figure 5-18 Saktësia për funksione të ndryshme aktivizimi

Sic mund te shohim nga rezultatet ,funksioni i aktivizimit Sigmoid performon më mirë se të dy funksionet e tjerë si në terma humbjeje, edhe në terma saktësie të parashikimit.

Hapi final do te jetë të prodhojmë matricën e saktësisë (confusion matrix) për modelin.

Matrica si më poshtë:

$$\begin{pmatrix} [480, 25, 5], \\ [60, 18, 16], \\ [25, 13, 118] \end{pmatrix}$$

Si edhe në rastin e KNN,kemi rezultate më të mira për klasat 1 dhe 3 dhe rezultate jo shumë të mira për klasën e mesit 2.Siç mund të dallojmë nga rezultatet,ne do të marrim rezultatet më te mira kur përzgjedhim Sigmoid si funksion aktivizimi, pra e konfirmojmë modelin tonë.Rezultatet e marra nga modeli i bazuar te rrjetat neurale jep rezultate lehtësisht më të mira se në rastin e KNN.Kjo i atribuohet edhe numrit të vogël të rekordeve në bazen tonë të të dhënave pasi kemi parasysh që fuqia reale e rrjetave neurale vjen kur kemi baze të gjërë të dhënash.Por duke u nisur nga madhësia e bazes sone te te dhenave ,rezultatet jane te kenaqshme.

## 5.3 Analiza e serive kohore

### 5.3.1 Modeli Prophet

Etapa e tretë e studimit tonë do të bazohet në propozimin e një modeli të modifikuar Prophet për parashikimin e shitjeve të qendrës tregtare. Në ndryshim nga seksioni i dytë, në të cilën kryem parashikimin për klientët duke u nisur nga shitjet 3-mujore, në këtë rast do të parashikojmë shitjet totale të qendrës tregtare duke marrë në konsideratë elementin kohë. Modeli do të bazohet në seritë kohore dhe veçanërisht në algortimin Prophet,te analizuar ne pjesen teorike.Performanca e modelit bazë dhe atij të modifikuar do të matet në bazë të gabimit absolut mesatar në parashikim MAE .Performanca e modelit të modifikuar do të matet në parashikime 6 mujore nëpërmjet gabimit absolut mesatar në përqindje MAPE. Të dyja metrikat janë shpjeguar në pjesën teorike.

### 5.3.2 Eksplorimi i te dhenave

Për këtë studim baza jonë e të dhënave do të konsistojë në 3271 rreshta që përmbajnë shitjet në qendrën tregtare nga viti 2011 në vitin 2019. Të dhënat i kemi agreguar nëpërmjet skripteve në SQL(Aneks 1) për të përftuar një dataset final i cili përmban vetëm 2 kolona: datën dhe vlerën. Printojmë një përmbledhje të bazës së të dhënave për të kuptuar atributetet.

```
<class 'pandas.core.frame.DataFrame'>
RangeIndex: 3271 entries, 0 to 3270
Data columns (total 2 columns):
#   Column  Non-Null Count  Dtype
---  -
0   0       3271 non-null    object
1   1       3271 non-null    int64
dtypes: int64(1), object(1)
memory usage: 51.2+ KB
```

Siç mund të shohim kemi vetëm 2 kolona, përkatësisht datën dhe shitjet totale në USD për atë datë. Po printojmë dhe 5 kolonat e para të bazës së të dhënave për qartësi.

Tabela 5-8 5 rreshtat e parë të bazës së të dhënave

	ds	y
0	1/3/2011	25456
1	1/4/2011	36109
2	1/5/2011	46267
3	1/6/2011	46600
4	1/7/2011	45780

Gjithashtu kemi krijuar një bazë të dhënash me festat zyrtare të këtyre 9 vjetëve të cilën do ta importojmë më pas në model. Importimi i të dhënave të festave është i rëndësishëm pasi në ato data specifike ne do të kemi ndryshime të menjëhershme të shitjeve ditore.

Tabela 5-9 5 rreshtat e parë të databazës së festave

	holiday	ds	lower_window	upper_window
0	holiday season	12/25/2019	-1	0
1	holiday season	11/28/2019	-1	0
2	holiday season	3/7/2019	-1	0
3	holiday season	2/14/2019	-1	0
4	holiday season	12/25/2018	-1	0

